

FGJH

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS



9/2024

Botohet për herë të parë në dhjetor 2019

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

E-mail: redaksia_fgjh@fgjh.edu.al; redaksia.fgjh@gmail.com

©Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ISSN2664-7346

BORDI EDITORIAL

Drejtor i Përgjithshëm

Prof. Dr. Saverina PASHO (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Kryeredaktore

Dr. Viola ADHAMI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore shkencore

Prof. Asoc. Dr. Mirela PAPA (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore

Dr. Orges SELMANI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Dr. Viola BITI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

BORDI SHKENCOR

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Saverina PASHO

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Viktor RISTANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Lorena DEDJA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Klodeta Dibra

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Brikena KADZADEJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Jonida BUSHI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Irena LAMA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Adriatik DERJAJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Xhemile ABDIU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Anastasi PRODANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Sofia DELIJORGJI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Daniela HASA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Daniela TAMO

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Lindita SEJDIU RUGOVA

(Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Prof. Freiderikos VALETOPOULOS

(Université de Poitiers, Francë)

Prof. Enrico LUSSO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Marco NOVARINO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Dr. Ahmet GÜNŞEN

(Fakulteti i Letërsisë, Universiteti Trakya, Turqi)

Prof. Dr. Giorgos KENTROTIS

(Departamenti i Gjuhëve të Huja, Universiteti Ionian, Greqi)

Shtypur në Triptik

PËRMBAJTJA

ARTIKUJ

5

CLIL në klasën e anglishtes së biznesit: nga mësimi
i gjuhës te zhvillimi i aftësive profesionale
të gjuhës së biznesit te studentët shqiptarë

*Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali
Doktorante Tiziana Leka*

27

Përdorimi i mjeteve teknologjike
gjatë pandemisë Covid-19 në Shqipëri

Doktorante Kleida Pira

37

Emocionaliteti në gjuhën e gazetave sportive.
Studim krahasues midis shqipes dhe gjermanishtes.

*Doktorante Anxhela Belkovi
Prof. Asoc. Dr. Sonila Sadikaj*

53

Legjislacioni european për të drejtat gjuhësore të pakicave dhe
kuadri ligjor i arsimit në minoritetin etnik grek pas viteve 1990

*Doktorante Donika Boboli
Prof. Asoc. Dr. Eda Shehu*

64

Huazimet nga italishtja në gjuhën e gazetave:
leksiku dhe sintaksa

Dr. Elda Katorri

74

Rëndësia e studimit të latinishtes në ditët e sotme

Prof. Asoc. Dr. Leonard xhamani

RECENSA

82

Letërsia, Mësimdhënia, Përkthimi

86

AKTIVITETE SHKENCORE NË FGJH

CLIL NË KLASËN E ANGLISHTES SË BIZNESIT: NGA MËSIMI I GJUHËS TE ZHVILLIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË GJUHËS SË BIZNESIT TE STUDENTËT SHQIPTARË

Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali

Departamenti i Gjuhës Italiane

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: aida.gjinali@unitir.edu.al

Doktorante Tiziana Leka

Departamenti i Gjuhës Italiane

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: tiziana.leka@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Punimi në fjalë analizon përdorimin e metodologjisë CLIL në orët mësimore ku mësohet Anglishtja e Biznesit, me synimin për të vëzhguar se si kjo metodologji mund të aplikohet dhe për të vlerësuar efektivitetin e saj në cilësinë e përvetësimit të përmbajtjeve jogjuhësore në gjuhë të huaj nga studentët. Për këtë punim, u zhvillua një eksperiment për të zbatuar këtë metodologji dhe më pas u hartua një pyetësor me shkallë Likert me 32 studentë të Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, ndër studentët e degës Financë dhe Administrim Biznesi, në nivelin Bachelor, ashtu edhe në atë Master në Administrim Biznesi dhe Kontabilitet, në lëndën Anglisht për Biznes. Gjetjet e studimit tregojnë se CLIL luan një rol të rëndësishëm duke promovuar të nxënit në dy drejtime: mësimin e përgjithshëm të gjuhës angleze dhe anglishten për qëllime specifike brenda kontekstit të biznesit, për të arritur formimin e nevojshëm që u duhet studentëve për të përballuar sfidat e tyre të ardhshme profesionale. Gjithashtu, kjo metodologji rrit ndërgjegjësimin kulturor dhe përfshin studentët në mjedisin global të biznesit, duke i përgatitur ata për një komunikim efektiv në një ambient profesional ku kuptimi i praktikave ndërkombëtare është thelbësor. Përmes aktiviteteve si studime rasti, simulime dhe diskutime mbi tema si marketingu dhe financa, mësuesit mund të zbatojnë në mënyrë efikase metodologjinë CLIL, duke siguruar që studentët të fitojnë jo vetëm aftësi gjuhësore, por edhe njohuri praktike në fushën e biznesit. Fjalët çelës: Anglishtja Biznesi, CLIL, përmbajtje jogjuhësore, studentë.

ABSTRACT

The research explores the application of CLIL methodology in Business English classes, aiming to evaluate its effectiveness in enhancing students' language acquisition. For this research, an experiment utilizing the CLIL approach was conducted followed by the administration of a Likert-scale questionnaire to 32 students from the Faculty of

Economics, University of Tirana. The participants included both Bachelor's and Master's students specializing in Finance, Business Administration, and Accounting. The findings of the study indicate that CLIL plays a significant role by promoting learning in two directions: general English language acquisition and English for Specific Purposes (ESP) within a business context. This dual focus equips students with the skills needed to meet future professional demands. Additionally, CLIL enhances cultural awareness and engages students in the global business environment, preparing them for effective communication in a professional setting where understanding international practices is crucial. Through activities such as case studies, simulations, and discussions on topics like marketing and finance, instructors can successfully implement CLIL, to ensure that students develop both linguistic proficiency and practical business knowledge.

Key words: Business English, content, CLIL, students.

1. Hyrje

1.1 Konteksti dhe problemi

Punimi në fjalë synon të sjellë përdorimin e metodologjisë CLIL në klasat e Anglishtes së Biznesit, me fokus përmbajtjet lëndore të Anglishtes së Biznesit tek studentët shqiptarë të FE/UT, dega Financë, dega Administrim Biznesi Bachelor, Master Administrim Biznes dhe Master Kontabilitet, viti akademik 2024- 2025, dhe sjell rezultatet e përdorimin të saj në terren nisur nga përshtypjet e studentëve dhe vëzhgimet tona personale.

Arsyeja që nxiti këtë kërkim, lidhet drejtpërsëdrejti me kontekstin mësimdhënës në klasat tona ku nga përvoja jonë personale, vëmë re në mënyrë të vazhdueshme që studentët paraqesin vështirësi në nxënien e përmbajtjeve lëndore në gjuhë të huaj, pavarësisht se sa të zotë janë ata në atë gjuhë të huaj. Mësimi i këtyre përmbajtjeve has vështirësi sidomos në të kuptuarit e saktë kontekstual të tyre dhe përdorimin praktik të këtyre përmbajtjeve në kontekste specifike siç është në rastin tonë anglishtja e biznesit.

Nisur nga këto vëzhgime dhe problematika të hasura në vijimësi të punës tonë, menduam që të realizonim këtë punim bazuar në një eksperimentim vijuar ky nga një sondazh, duke u përpjekur të shkëputemi nga mësimi tradicional dhe duke implementuar metodologjinë CLIL në mësimin e anglishtes së biznesit, metodologji kjo që ofron avantazhe të dukshme dhe të njohura tashmë në glotodidaktikën botërore.

Ajo me çfarë kemi konstatuar deri më tani është që ka fare pak studime në terrenin shqiptar në këtë kuadër, ama ka shkolla sidomos ato private si

në arsimin AML ashtu edhe atë universitar që deklarojnë përdorimin dhe implementimin vetëm disa shkolla në AML e kanë implementuar atë, duke na çuar të mendojmë që kjo metodologji njihet deri diku në kontekstin shqiptar dhe po aq implementohet në të.

Gjithsesi këto vitet e fundit vihet re një përdorim më i gjerë i tij ndikuar kjo nga politikat evropiane¹ si dhe politikat arsimore vendore². Nëse do t'i referohemi një dokumenti të këtyre të fundit, thuhet gjithsesi që “Investimi i Shqipërisë në seksionet dygjuhëshe të shkollave të mesme dhe në mësimdhënien e integruar (CLIL) ngre pyetjen: Me sa efektivitet i përdor dhe i ndërton më tej arsimi i lartë kompetencat në gjuhë të huaj të zhvilluara në shkollë?”. Pyetje kjo e shtruar në këtë dokument që me sa duket nuk ka marrë një përgjigje shteruese duke lënë të supozohet që këto kompetenca paraqesin problematika në vijim.

Ndaj nisur nga sa më sipër ku punim kërkon, që bazuar në eksperimentimin në terren të modeleve mësimore të bazuara në CLIL, në sistemin universitar, si dhe rezultatet e vjela nga kërkimi vijues, interpretimi e analiza e dhënave të vjela, të ofrojë një ndihmesë modeste për palët e interesit që operojnë në këtë fushë.

1.1.1 Qëllimi dhe objektivat

Punimi në fjalë ka si qëllim të sjellë një përvojë konkrete lidhur me përdorimin e kësaj metodologjie në mësimdhënie, si dhe mënyrën se ajo perceptohet nga studentët si dhe impakti dhe efikasiteti që ka implementimi i kësaj metodologjie tek studentët në lëndën Anglishten e Biznesit.

1.1.2 Objektivat

Punimi ka si objektiva kryesorë:

1. Aplikimin e metodologjisë CLIL në klasat e FE/UT;
2. Rritjen e efikasitetit nxënës të përmbajtjeve në GJH, në klasat ku mësohet Anglishtja e Biznesit;

¹ Commissione europea, Direzione generale dell'Istruzione, della gioventù, dello sport e della cultura & Eurydice. (2006). *Apprendimento integrato di lingua e contenuto (Content and Language Integrated Learning – CLIL) nella scuola in Europa*. Ufficio delle pubblicazioni dell'Unione europea.

² Profili i Politikës Arsimore Gjuhësore Shqipëria 2015-2017, <https://rm.coe.int/profili-i-politikes-arsimore-gjuhesore-shqiperia/168075acb0>

1.1.3 Pyetjet Kërkimore

- Sa ndikon CLIL te aftësitë gjuhësore dhe profesionale te studentët e FE/UT?
- Sa ndikon përdorimi i metodologjisë CLIL në lëndën e Anglishtes së Biznesit?

1.1.4 Palët e interesit:

Lidhur me palët e interesit mund të themi që ky punim i drejtohet të gjithë atyre që operojnë në sektorin e mësimdhënies së gjuhës së huaj për sektorë profesionalë specifikë si në rastin tonë Anglishtja e Biznesit.

2. Shqyrtimi i literaturës

2.1 Përkufizimi i CLIL

CLIL ose Content and Language Integrated Learning, është termi i përdorur për të fokusuar disa udhëzime të metodologjisë së përvetësimit gjuhësor, në radhë të parë nevojën që mësimi i disiplinës dhe i GJH, ose gjuhës së dytë, të zhvillohet përmes një procesi të integruar.

Termi CLIL është përdorur për herë të parë nga Marsh³, i cili ka pasur në mendje përcaktimin e një parakushti të natyrës shkencore: *lidhjen e padiskutueshme që duhet të ekzistojë mes gjuhës dhe lëndës jogjuhësore*. Ndoshta më shumë se kurrë, në këtë term është e qartë që mësimi i gjuhës së huaj, nuk duhet të jetë një “*mësim i gjuhës i maskuar si disiplinë*”, por duhet të sigurojë për studentët, përveç përmirësimit të gjuhës edhe mësimin e përmbytjeve të lëndës.

Sipas Garoti⁴, termi CLIL në njëfarë mënyre vendos një pikë të qartë në ndryshueshmërinë e mundshme të modeleve, duke afirmuar fokusin në përmirësimin e aftësive gjuhësore, por në të njëjtën kohë arrijen e një kompetence të caktuar lëndore. Kështu, ky parakusht gjithashtu qartëson, jo vetëm në aspektin terminologjik, disa dallime shkencore që kërkojnë nevojën për të integruar informacionin gjuhësor-lëndor dhe për të proceduar gjithmonë pa ndarje, të një pjese nga tjetra dhe pa implikuar avantazhe të një aspekti mbi tjetrin.

³ MARSH, D., et al. (1996). Teaching content through a foreign language in Finland. In G. Fruhauf et al. (Eds.), *Teaching content in a foreign language*. European Platform for Dutch Education.

⁴ RICCI GAROTTI, F. (2006). *Il futuro si chiama CLIL: Una ricerca interregionale sull'insegnamento veicolare* [The future is called CLIL: An interregional research on vehicular teaching]. Editore Provincia Autonoma di Trento - IPRASE del Trentino.

2.2 Arsytet pse duhet të përdorim CLIL në mësimdhënien e anglishtes së biznesit

Të përdorësh CLIL në mësimdhënien e anglishtes së biznesit, ofron disa përparësi që mund të përmirësojnë ndjeshëm përvojën e të mësuarit. Në vijim disa avantazhe lidhur me këtë përdorim:

- a) *Konteksti* - CLIL ofron mësimi kontekstual duke e vënë fokusin tek rëndësia e botës reale⁵ dhe si vijim ajo u ofron studentëve mundësinë për të zhvilluar aftësitë gjuhësore në kontekstin e biznesit të botës reale, duke e bërë procesin e të mësuarit më të përshtatshëm dhe më praktik.
- b) *Ndërveprimi*-CLIL përdor gjerësisht ndërveprimin e punës në grup ku çdo anëtar ofron kontributin e tij në produktin final në bazë të njohurive, kompetencave dhe interesave.⁶⁷ Qëllimi është përforcimi i aftësive konjitive dhe sociale që realizohet ndërmjet ndërvarësisë pozitive dhe përgjegjësisë individuale dhe grupit.⁸
- c) *Përmbajtja* – CLIL ofron përmbajtje kuptimplote, kjo duke integruar përmbajtjen e biznesit, studentët shohin aplikimin e menjëhershëm të aftësive gjuhësore në karrierën e tyre të ardhshme, duke rritur motivimin dhe angazhimin.⁹
- d) *Fokusi i dyfishtë* – CLIL ofron mundësinë e zotërimit të gjuhës dhe të përmbajtjes, kjo i mundëson studentëve zhvillimin e njëkohësishëm të aftësive gjuhësore dhe njohurive të biznesit, duke përmbushur kështu dy objektiva në të njëjtën kohë dhe duke mundësuar kështu mësimin dhe

⁵ DALTON-PUFFER Ch. (2011). Content-and-Language Integrated Learning: From Practice to Principles?. *Annual Review of Applied Linguistics*, Vol. 31, fq. 182-204, Doi: <https://doi.org/10.1017/S0267190511000092> (Konsultuar më 10.06.2024)

⁶ MAYER, R. E. (1988). Learning Strategies: An Overview, tek C. E. Weinstein, E. T. Goetz, & P. A. Alexander (Eds.), *Learning and Study Strategies: Issues in Assessment, Instruction, and Evaluation* (fq. 11-22). New York: Academic Press, Doi: <https://doi.org/10.1016/B978-0-12-742460-6.50008-6>. (konsultuar më 02. 03.2024).

⁷ DAVIES W. M. (2009), Groupwork as a Form of Assessment: Common Problems and Recommended Solution, *Higher Education*, Vol. 58, Nr. 4, fq. 563- 584.Do: <https://doi.org/10.1007/s10734-009-9216-y>, (konsultuar më 02.04.2024).

⁸ OXFORD R. L. (1997), Cooperative Learning, Collaborative Learning, and Interaction: Three Communicative Strands in the Language Classroom, *The modern Language Journal*, Vol. 81, Nr. 4., fq 439- 592. <https://doi.org/10.1111/j.1540-4781.1997.tb05510.x>(konsultuar më 05. 03.2024).

⁹ PINNER, R. (2021). Authenticity and Motivation in CLIL: Creating a Meaningful Purpose by Experiencing the Language in Use. In: Hemmi, C., Banegas, D.L. (eds) *International Perspectives on CLIL. International Perspectives on English Language Teaching*. Palgrave Macmillan, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-030-70095-9_2(Konsultuar më 15.09.2024)

kuptimin më të mirë të gjuhës dhe lëndës.¹⁰

e) *Motivimi* – CLIL mundëson një motivim më të madh¹¹, kjo pasi studentët arrijnë të kuptojnë dhe të mësojnë pa u ngritur barrierat e filtrit afektiv¹² për faktin që mësimi i gjuhës së biznesit është i vështirë sidomos në përdorimin real- praktik të saj.

f) *Angazhimi personal*–CLIL mundëson një angazhim individual më të madh, kjo pasi të mësuarit përmes përmbajtjeve përkatëse¹³ të biznesit i bën mësimet më interesante dhe më tërheqëse për studentët, të cilët mund të shohin përfitimet e drejtpërdrejta të studimeve të tyre.

g) *Mësimi si qëllim instrumental*–CLIL i mundëson studentëve një formim qëllimor të caktuar dhe si rrjedhim ata kanë më shumë gjasa të motivohen, kur kuptojnë se si aftësitë gjuhësore të mësuara mund të zbatohen në jetën e tyre të ardhshme profesionale.¹⁴

h) *Zhvillimi i integruar i aftësive gjuhësore në kontekste reale*- CLIL inkurajon përdorimin e të katër aftësive gjuhësore në një mënyrë të integruar, duke reflektuar se si ato përdoren në kontekste reale¹⁵ të biznesit ndaj kjo i ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi praktike të komunikimit të nevojshme në botën e biznesit.

i) *Ndërgjegjësimi kulturor*:CLIL mundëson njohje kontekstesh kulturore

¹⁰ MONTOYA, O. I. R. (2022). Aprendizagem integrada de conteúdos e línguas estrangeiras (clil) para desenvolver habilidades de escrita em inglês. In scielo preprints. <https://doi.org/10.1590/SciELOPreprints.5155> (Konsultuar më 02.02.2025)

¹¹ Somers, T., & Llinares, A. (2018). Students' motivation for content and language integrated learning and the role of programme intensity. *International Journal of Bilingual Education and Bilingualism*, 24(6), 839–854. <https://doi.org/10.1080/13670050.2018.1517722> (Konsultuar më 3.07.2024)

¹² BALBONI P. E. (2016). Didattica dell'Italiano a Stranieri. Roma: Bonacci editore. Fq. 55

¹³ Rodrigues J.B. (2012), Content and Language Integrated Learning (CLIL) Considerations in the Colombian Context, *Gist: Education and Learning Research Journal*, Vol. 6, fq. 177-189.

¹⁴ DOIZ A., Lasagabaster D., Sierra J., (2014). CLIL and motivation: The effect of individual and contextual variables. *The Language Learning Journal*, Vol. 42, Nr. 2, fq. 209-224, Doi: <https://doi.org/10.1080/09571736.2014.889508>, (Konsultuar më 4.07.2024).

¹⁵ BOWER K, Cross R, Coyle D. (2020) *CLIL in Multilingual and English-Background Contexts: Expanding the Potential of Content and Language Integrated Pedagogies for Mainstream Learning*. In: Bower K, Coyle D, Cross R, CHAMBERS GN, eds. *Curriculum Integrated Language Teaching: CLIL in Practice*, Cambridge University Press, fq 3-21.

të reja.¹⁶ Studimi i përmbajtjes së biznesit në anglisht shpesh përfshin të mësuarit rreth tregjeve dhe praktikave ndërkombëtare, gjë që rrit ndërgjegjësimin kulturor të studentëve dhe i përgatit ata për mjediset globale të biznesit, për të punuar në kompani shumëkombëshe dhe ekipe të ndryshme.

j) *Mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve*- CLIL me përmbajtjen e biznesit kërkon që studentët të analizojnë të dhënat, të vlerësojnë strategjitë dhe të zgjidhin problemet, duke promovuar aftësitë e të menduarit kritik. CLIL i ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi profesionale gjuhësore, duke përfshirë shkrimin e raporteve, prezantimet dhe negociatat.¹⁷

Për sa më lart mund të themi që CLIL kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në fushën e Anglishtes së Biznesit duke integruar mësimin e gjuhës me përmbajtjen e lëndore që kanë të bëjnë me fushën e biznesit. CLIL inkurajon mësimin e Anglishtes së biznesit përmes konteksteve të vërteta biznesi, si studime rasti, negociata dhe prezantime, duke përmirësuar profesionalizmin e gjuhës dhe kuptimin e aplikimit praktik të Anglishtes në ambientet e biznesit. Kjo qasje gjithashtu nxit aftësi ndërdisiplinore duke kombinuar konceptet e biznesit me aftësitë gjuhësore, përmirëson vetëdijen kulturore duke ekspozuar në materiale të vërteta biznesi dhe rrit motivimin dhe angazhimin midis nxënësve, të cilat trajtohen në këtë punim. Zbatimi i CLIL në klasat ku mësohet Anglishtja e Biznesit jo vetëm që mbështet zhvillimin profesional për mësuesit por gjithashtu informon dizajnin e kurrikulës për të përmbushur nevojat e nxënësve që përgatiten për mjediset globale të biznesit. Si përfundim, ky punim kontribuon në përdorimin e CLIL në Anglishten e Biznesit e cila mund të konsiderohet si risi në vendin tonë dhe mund të përforcojë konkurrueshmërinë ndërkombëtare të Shqipërisë duke e pajisur nxënësit me aftësitë themelore të gjuhës dhe biznesit për komunikim efektiv global. Përfshirja e CLIL në mësimdhënien e anglishtes së biznesit ofron një qasje gjithëpërfshirëse që jo vetëm përmirëson aftësinë gjuhësore, por gjithashtu pajis studentët me njohuri dhe aftësi thelbësore të biznesit. Kjo metodologji i përgatit studentët për sfidat

¹⁶ WOLFF, D. (2002), *On the importance of CLIL in the context of the debate on plurilingual education in the European Union*. In D. Marsh (ed.), *CLIL/aEMILE. The European dimension. Actions, trends, and foresight potential* (Jyväskylä: University of Jyväskylä, fq. 47-48).

¹⁷ DI PARDO L. H. D (2015), *Special Issue on CLIL CLIL in the Business English Classroom: From Language Learning to the Development of Professional Communication and Metacognitive Skills*, ELTWorldOnline.com, <http://blog.nus.edu.sg/eltwo/?p=4850>(Konsultuar më 12.04.2025)

e botës reale, duke i bërë ata më konkurrues në tregun global të punës.

Jo vetëm në kontekstin evropian, por edhe në kontekstin e një bote globale, mësimi i gjuhëve të huaja (FLL) është tani më i rëndësishëm se kurrë më parë, prandaj, gjetja e qasjeve metodologjike të përshtatshme dhe mjediseve efikase për fitimin e gjuhës është një shqetësim shoqëror¹⁸, sidomos kur duket të ketë një hendek mes atij që ofrohet si edukim në gjuhë të huaja dhe rezultateve në kompetencën e gjuhës së nxënësve brenda Bashkimit Evropian (BE) (Marsh, 2002).¹⁹ Në fakt, ka shumë nxënës që përfundojnë arsimin e detyruar me aftësi shumë të limituara për të komunikuar në një gjuhë të huaj.²⁰ Për më tepër, sipas Marsh²¹, është e pranuar gjerësisht se gjuhët e huaja nuk mësohen ose nuk mësohen mjaftueshëm në shkolla dhe, si rrjedhojë, nevojitet një investim i konsiderueshëm në këtë fushë.

3. Metodologjia

3.1 Eksperimenti, hulumtimi, popullata dhe procedura e mbledhjes së të dhënave

3.1.1 Eksperimenti

Metoda përfshin rrugët, mënyrat, rregullat, procedurat bazë për realizimin e qëllimit studimor ²². Punimi është sasior dhe cilësor, duke i kushtuar kështu vëmendje objektivitetit të përdorimit të CLIL në klasat ku mësohet lënda e Anglishtes së Biznesit, te Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Studimi është zhvilluar në 2024- 2025.

Kërkimi për këtë punim u nda në tre faza:

1- *Eksperimenti* që konsistoi në përdorimin e disa modeleve mësimore

¹⁸ GARAU J., (2008), Contexto y contacto en el aprendizaje de lenguas extranjeras. Revista Electrónica d' Investigació i Innovació Educativa i Socioeducativa, Vol. 1, fq. 47-66. http://www.in.uib.cat/pags/volumenes/vol1_num0/maria_garau/index.html (konsultuar më 10.02.24)

¹⁹ MARSH, D., (2002). *CLIL/EMILE: The European dimension. Actions, trends and foresight potential*. University of Jyväskylä.

²⁰ LASAGABASTER, D. (2008). Foreign language competence in content and language integrated courses. *The Open Applied Linguistics Journal*, Vol.1, fq. 31-42. <http://www.bentham.org/open/toalj/openaccess2.htm>

²¹ Marsh (2002), Op. Cit.

²² SOKOLI, L. (2016). *Metodat e kërkimit shkencor*, Methods of scientific research, (bot. 5). Bukinist, fq 43.

të ndërtuara posaçërisht për këtë kategori studentësh dhe për këtë program studimi për të parë efikasitetin e aplikimit të CLIL. U punua me tre modele: 1) Marketing Strategies; 2) Marketing Campaign Project; 3) Teaching Marketing Concepts in English, ku më poshtë po sjellim një prej tyre.

- 2- *Testimi i njohurive*. Në fund të çdo modeli mësimor të përdorur janë zhvilluar teste të ndërtuara mbi bazën e njohurive lëndore dhe gjuhësore që duhet të zotëronte çdo student në përfundim të atij modeli.
- 3- *Pyetësori* që u ndërtua dhe u aplikua pas implementimit të modeleve mësimore bazuar në CLIL, për të vjelë perceptimet e studentëve lidhur me përdorimin e kësaj metodologjie.

3.1.2 Eksperimenti, Modeli mësimor

Modeli mësimor i mëposhtëm është një prej modeleve të përdorur me studentët e FE/UT, si në vijim:

Tema: Strategjitë e Marketingut	
Studentët	FE/UT
Niveli i gjuhës	Intermediate
Kohëzgjatja	6-7 orë mësimore
Materiale:	- Prezantime në PowerPoint - Materialet e studimit të rastit - Lista e fjalorit - Fletët e punës për aktivitetet në grup - Shembull i modelit të planit të marketingu, p.sh.: https://www.sbdc.uh.edu/images/sbdc/UH%20SBDC%20Marketing%20Plan%20Template.pdf
Objektivat:	- Njohuri rreth strategjive të ndryshme të marketingut. - Zhvillimi ifjalorit dhe aftësive gjuhësore në lidhje me marketingun.

Përmbajtjet:	Llojet e strategjive të marketingut (p.sh., marketing digjital, marketing gueril, marketing i përmbajtjes). - Raste studimore të fushatave të suksesshme të marketingut: Nike – “Winning Isn’t for Everyone” (2024) ¹ ; Coca-Cola – “Y3000” dhe “New Guy” (2024–2025) ² ; Dove – “Real Beauty AI” (2025); Gillette – “The Best Men Can Be” (2020) ³ ;
Aftësitë gjuhësore:	Dëgjimi: Listening audio of different startups or small brands strategies of marketing’s Leximi: Teksteve lidhur marketing strategies Të folurit: Presenting marketing strategies. Shkrimi dhe prezantimi: Creating a marketing plan.
Objektivat gjuhësorë	Fjalori: audienca e synuar, brand awareness, conversion rate, ROI (Return on Investment), SEO (Search Engine Optimization), etj. Gramatika: përsëritje e Present simple for facts, present continuous for actions happening now.
Planifikimi mësimor	
1. Hyrje	- Aktiviteti: Fillohet me një diskutim mbi atë që studentët dinë rreth marketingut. (Spidergrams) - Fokusi gjuhësor: Përdoret një seksion idesh për të nxjerrë në pah termat dhe konceptet kryesore të marketingut. (Brainstorming)
2. Prezantimi dhe njohja me materialin e ri	- Përmbajtja: Prezantohen lloje të ndryshme të strategjive të marketingut duke përdorur një prezantim në PowerPoint apo nga ueb- e të ndryshëm në internet me shembuj konkretë. - Fokusi gjuhësor: Theksohet dhe shpjegohet fjalorin kryesor. Sillen shembuj dhe përdoren pamje vizuale për të ndihmuar të kuptuarit. Përdorimi i teknologjive të rastit. https://www.youtube.com/watch?v=WUniTVTi_Jk Zhvillohen ushtrime të llojit me përgjigje të mbyllura/ apo alternativa: për kuptimin e përgjithshëm dhe atë të detajuar.

11. Analiza e Studimit të Rastit	- Përmbajtja: Paraqitja një rast studimi të një fushate të suksesshme marketingu. - Aktiviteti: Ndahen nxënësit në grupe për të analizuar rastin studimor. - Fokusi gjuhësor: Secili grup diskuton strategjinë e fushatës, audiencën e synuar dhe rezultatet duke përdorur fjalor të ri.
12. Analiza gjuhësore	Referuar: Leksikut, strukturave morfologjike- sintaksore, elementeve semantikorë, etj. pragmatikë
4. Aktivitete në grup	- Përmbajtja: Secili grup krijon strategjinë e tij të marketingut për një produkt të caktuar (produkt që mund të përcaktohet nga pedagogu apo studenti) - Veprimtaria: Pas Grupet prezantojnë strategjitë e tyre para klasës. - Fokusi gjuhësor: I vihet theksi një gjuhë e qartë, bindëse dhe përdorimin e saktë të fjalorit. I ofrohen studentëve fillime fjalish dhe fraza për të mbështetur prezantimet.
5. Detyrë me shkrim	- Përmbajtja: Secili student shkruan një plan të shkurtër marketingu për një produkt hipotetik. - Fokusi gjuhësor: Fokusimi në strukturë (hyrje, pjesa kryesore, përfundimi), përdorimi i termave kyç dhe gramatika e saktë
6. Rishikim dhe komente	- Veprimtaria: Rishikimi i pikave kyçe të mësimi. Ofrohen komente lidhur me prezantimet e grupeve dhe detyrat me shkrim. - Fokusi gjuhësor: Korrigjoni gabimet e zakonshme dhe përforconi përdorimin e saktë të fjalorit të ri.
7. Testimi	Në fund të Modelit mësimor, për të verifikuar arritjet e nxënësve
Vlerësimi Ai bazohet tek: • Pjesëmarrja në diskutime dhe aktivitete; • Cilësia e prezantimeve në grup; • Plan - marketingu i shkruar dhe prezantimi: ideimi, materialet, hartimi, interpretimi, prezantimi • Vlerësimi ndërmjet grupeve • Vetëvlerësimi • Testimi	

3.1.3 Testimi

Hartimi i testeve për çdo model mësimor të ofruar synonte verifikimin e njohurive të marra studentëve në përfundim të tyre.

Testimi bazohej në 4 aftësitë bazë dhe ato të integruara. Testimi qe 60 pikësh, pasi përveç vlerësimit të vazhduar bazuar në aktivizimin, pjesëmarrjen aktive, punën individuale dhe në grupe, një numër pikësh përftohej nga projektet e realizuara gjatë nga studentët.

Më poshtë po sjellim të shkurtuar testin që u përdor për këtë model mësimor. Testimi synonte kryesisht:

Të kuptuarit e teksteve dëgjimore me plotësimin e alternativave; një audio të shkurtër rreth një start-up që përdor strategjinë *freemium* për të hyrë në treg. (https://www.ivoox.com/en/freemium-and-subscription-business-model-audios-mp3_rf_63215528_1.html)

1. What is the main business model of the startup?

a) Subscription only b) Freemium c) Ad-based d) Licensing

✓ Leximin e teksteve specifike me plotësimin me alternativa: një tekst të shkurtër rreth kompanisë Patagonia²³ dhe strategjisë së saj të qëndrueshmërisë në marketing:

• Patagonia's marketing focuses mostly on:

a) Luxury branding b) Low-cost advantage c) Environmental responsibility d) Trendy fashion

✓ Leksikun specifik përkatës: ushtrime me kombinime, lidhje, bashkime, renditje, përkthime

1. Zgjidhni fjalën e duhur:

• The company aims to increase its *market* _____.

a) reach b) scream c) hold d) bend

✓ Kompetenca gjuhësore, morfosintaksore;

1. Zgjidhni formën e saktë të foljes ose strukturës gramatikore në një kontekst profesional:

• Our clients expect that the service _____ within 24 hours.

a) delivers b) is delivered c) delivered d) was delivering

✓ Hartimin e një mini – planinë bazë të një teme të caktuar.

Shkruani një mini-plan për promovimin e një produkti të ri, duke përdorur terma specifikë të biznesit (rreth 150–180 fjalë). Udhëzime: përshkruaj
²³ PEREIRA D. (2025), Patagonia Marketing Strategy, <https://businessmodelanalyst.com/patagonia-marketing-strategy/> (konsultuar 30 mars)

produktin, klientët e mundshëm, strategjitë si social media, events, email marketing.

3.1.4 Hulumtimi / Pyetësi

Hartimit i pyetësit vjen në vijim të eksperimentit të kryer me studentët të cilët punuan me tre modele mësimore CLIL: 1) Marketing Strategies; 2) Marketing Campaign Project; 3) Teaching Marketing Concepts in English.

Pyetësi i hartuar u shpërnda me anë të Linkut të Google Forms, tek 32 studentë, pas mësimit në një semestër me përdorim periodik të CLIL.

➤ *Pyetësi është i ndarë në dy seksione:*

1. *Seksioni i parë* synon të marrë të dhëna demografike mbi kampionin, si moshë si dhe ciklin e studimeve në FE/UT (Bachelor apo Master)

2. *Seksioni i dytë* ndahet në 10 variabla, ku secila ka nga 2 pyetje dhe për secilën pyetje, paraqitet në shkallëzimin Likert nga 1 deri në 5 ku renditen 1. Aspak; 2. Dakord; 3. Mjaftueshëm; 4. Neutral; 5. Dakord; 6. Plotësisht dakord.

Pyetësi i përdorur është sasior me shkallëzimin Likert. Zgjedhja për të përdorur shkallë Likert u bazua në faktin që kjo lloj shkalle kërkon nga i pyeturi që të tregojë një masë aprovimi apo mosaprovimi për secilën nga seritë e thënies në lidhje me objektin stimul.

Gjuha e përdorur në pyetësor është e nivelit të kuptueshëm nga studentët e FE/UT.

4. Rezultatet, analiza dhe diskutimi

Përdorimi i 3 modeleve të përdorura për këtë studim, bazuar në shënimet tona si dhe në post-testet tregojnë përmirësime të dukshme rezultatet e të nxënësve të studentëve, tregoi që përdorimi i kësaj metodologjie ka efektivitet dhe ndihmon në nxënie të qëndrueshme të njohurive si lëndore ashtu edhe gjuhësore.

Pyetjet e para të pyetësit synonin të grumbullonin të dhëna demografike mbi studentët, nëse ato janë studentë të Bachelorit apo të Masterit në FE/UT, ku në total ishin 32 studentë, rezultoi që 87.5% e atyre që plotësuan pyetësin janë studentë të ciklit Bachelor në FE/UT dhe 12,5% janë studentë Masteri. Në nivelet Bachelor dhe Master, mësimi i Anglishtes së Biznesit nëpërmjet

metodës CLIL dallon në mënyrë të rëndësishme, duke reflektuar fazat e ndryshme të zhvillimit akademik dhe profesional. Në nivelin Bachelor, fokusi është në vendosjen e njohurive themelore në konceptet e biznesit dhe aftësitë e gjuhës angleze. Studentët njihen me parimet bazë të biznesit të integruara me objektivat e mësimit të gjuhës. Vëmendja vendoset në ndërtimin e fjalorit dhe aftësive komunikuese specifike për kontekste biznesi.

Siç e kemi thënë më lart grafikët janë të shkallës linkert nga 1 deri në 5, ku: Aspak Dakord; Mjaftueshëm; Neutral; Dakord; Plotësisht dakord dhe ky rend është i njëjtë për të gjithë grafikët vijues.

Bazuar në fig.1 lidhur me pyetjen rreth përmirësimit të aftësive gjuhësore rezultojnë në përqindje që studentët janë Dakord me 34% dhe Plotësisht Dakord (PD) me 44%, kjo sepse mësimdhënia e lëndës me metodën CLIL ka përmirësuar aftësitë gjuhësore mbi kuptueshmërinë e teksteve dhe konteksteve si dhe fjalorin e biznesit. Gjithashtu 38% e tyre janë PD, sepse metoda CLIL ka përmirësuar aftësitë e tyre gjuhësore në komunikimin e gjuhës së biznesit.

Totali i të kënaqurve (PD + D) është **78%**, që tregon një **nivel të lartë të perceptimit pozitiv** të studentëve për përmirësimin gjuhësor nëpërmjet CLIL.




Fig. 1

Lidhur me Fig. 2 bazuar në pyetjen e cila mat përvetësimin e njohurive lëndore mbi biznesin, rezultojnë që 35% janë PD²⁴. Ata mendojnë se kanë mësuar më shumë me metodologjinë CLIL sesa me mësimdhënien tradicionale mbi lëndën, ku gjithashtu 41% e tyre janë D (Dakord) se CLIL i ka ndihmuar të

²⁴ Plotësisht dakord

kuptojnë konceptet mbi biznesin.

Totali i përgjigjeve pozitive: 76%, që nënkupton një efikasitet të dukshëm të CLIL në transmetimin e njohurive lëndore në fushën e biznesit.

■ 2.1 Mendoj se kam mësuar më shumë rreth koncepteve dhe praktikave të biznesit përmes Anglishtes Biznesi me metodën CLIL krahasuar me mësimdhëniet tradicionale bazuar në gjuhë.




Fig. 2

■ Përmbajtja në Anglishten e Biznesit me metodën CLIL është e rëndësishme për përgjegjësitë dhe industrinë tite të punës.




Fig. 3

Bazuar në fig. 3 e cila lidhet me pyetjen me punën, duke synuar kështu matjen e përmbajtjes lëndore CLIL dhe punën rezultojnë që 35% e studentëve të FE/UT pohojnë se përmbajtja lëndore e Anglishtes së Biznesit është e rëndësishme për përgjegjësitë dhe punën, edhe pse 28% e tyre janë neutral. Gjithashtu ato mendojnë se mësimi i përmbajtjes lëndore lidhet drejtpërdrejt me detyrat profesionale ku 34% janë Dakord, ndërsa 32% e tyre janë Neutral.

Një tendencë pozitive, por me një prani të lartë të neutralëve (28–32%), që sugjerojnë hapësirë për përmirësim në lidhjen më të qartë mes përmbajtjes dhe praktikës profesionale.

■ CLIL ka përmirësuar aftësitë e mia për të shkruar në biznes në gjuhën angleze.

■ Jam më i sigurt në prezantime dhe negociata në anglisht pas pjesëmarrjes në mësimet e Anglishtes Biznesi me metodën CLIL.




Fig. 4

■ Mësuesi i Anglishtes Biznesi me metodën CLIL integron efektivisht mësimin e gjuhës me përmbajtjen e biznesit.

■ Mësuesi i CLIL ofron shembuj praktik dhe studime rastesh që përmirësojnë kuptimin tim për konceptet e biznesit në gjuhën angleze.




Fig. 5

Bazuar në fig. 4 e cila lidhet me zhvillimin e aftësive gjuhësore, rezultojnë që 38% janë PD se CLIL ka përmirësuar aftësitë gjuhësore në të shkruar dhe shumica, apo 38% po PD pohuan se janë të sigurtë në prezantime që lidhen me

Anglishten e Biznesit.

Ky rezultat sinjalizon një besim të lartë në zhvillimin e aftësive produktive të gjuhës, sidomos në të shkruar dhe të folur në kontekst profesional.

Bazuar në fig. 5 e cila lidhet me efektshmërinë e lektorit të Anglishtes, 44% janë Dakord që lektori ofronte shembuj praktik dhe studime rastesh që përmirësonin kuptimin e koncepteve dhe përmbajtjes lëndore rezultojnë dhe gjithashtu 50% janë Dakord se lektori integron në mënyrë efektive mësimin e gjuhës angleze me përmbajtjen lëndore.

Rezultoni kështu një vlerësim pozitiv për rolin e lektorit, me gjysmën e studentëve që ndihen të kënaqur me integrimin efektiv të CLIL nga mësuesi, gjë që lë vend për përmirësim për të rishikuar strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies.

Në fig. 6 e cila lidhet me ndërgjegjësimin kulturor rezultoni që 31% janë Dakord se Anglishtja e Biznesit me metodën CLIL i ka ndihmuar shumë për të kuptuar nuancat kulturore në botën e biznesit anglishtfolës dhe 38% janë Dakord se ndjehen më të ndërgjegjshëm në praktikatat globale mbi biznesin. Kjo i mundëson atyre që duke qenë më të vetëdijshëm për kulturën të kuptojnë ngjyrimet e ndryshme gjuhësore që merr fjala në kontekste të caktuara dhe të përdorin gjuhën në mënyrë të përshtatshme në kontekste të ndryshme.

Rezultati na tregon një ndikim të modest deri mesatar të CLIL në aspektin kulturor, por sërish me prani të qartë pozitive. Gjithsesi ka vend për përmirësime në këtë aspekt. Mësuesi duhet të sjellë në klasë modele mësimore ku përfshirja e aspekteve kulturore të jetë e tillë që t'i ofrojë studentit informacionet e duhura të nevojshme në këtë këndvështrim.




Fig. 6




Fig. 7

Nëse do t'i referohemi fig. 7 lidhur me bashkëpunimin rezultoni që ku 38% e

tyre janë dakord se CLIL inkurajon bashkëpunimin midis studentëve në klasë, si dhe ka përmirësuar aftësitë e tyre të të punuarit në ekip sipas 44% e tyre janë Dakord.

Përqindjet sugjerojnë se CLIL ka ndikuar pozitivisht në punën bashkëpunuese, një komponent i rëndësishëm në mjedisin e biznesit.

Një ambient mësimor ku nxënësit bashkëpunojnë nxit motivimin dhe angazhimin. Duke parë përpjekjet e shokëve të tyre, ata mund të ndihen të shtyrë të përmirësojnë veten dhe të krijojnë një kulturë mësimore të ndihmës reciproke. Gjithsesi në këtë pikë ka vend për përmirësime të mëtejshme.

Në vijim në fig. 8 lidhur me mendimin kritik rezulton që rreth 35% e tyre janë Dakord se CLIL inkurajon mendimin kritik si dhe 34% e tyre janë Dakord sepse ndihen më të sfiduar për të analizuar dhe vlerësuar informacionet mbi lëndën, edhe pse në të dyja rastet 25% janë Neutral. Mësimi i një GJH përfshin sfida si struktura të panjohura gramatikore, fjalor i ri, ose sintaksa. Mendimi kritik ndihmon nxënësit të përballen me këto sfida në mënyrë logjike, t'i shkëpusin ato në pjesë të menaxhueshme dhe të gjejnë zgjidhje duke përdorur arsyetim dhe deduksion.

Rezultatet tregojnë një shpërndarje e ekuilibruar, gjë që tregon një impakt të mirë por jo maksimal, dhe nevojë për thellim të qasjeve që stimulojnë reflektimin kritik.




Fig. 8




Fig. 9

Lidhur me rritjen profesionale të studentëve në FE/UT, fig. 9, të cilët kanë punuar me CLIL rezulton që 34% e tyre pohojnë se kanë pasur më shumë besim mbi përdorimin e Anglishtes së Biznesit në takime dhe diskutime profesionale, por gjithsesi 34% mbeten Neutral lidhur me pyetjen nëse metodologjia CLIL ka zgjeruar kuptimin mbi sfidat globale në fushën e biznesit.

Duke parë rezultatet konstatohet që përgjigjet janë të ndara, gjë që sinjalizon

potencial të pjesshëm të shfrytëzuar për zhvillimin profesional përmes CLIL.

Së fundmi, studentët e FE/UT, fig. 10 kur u pyetën nëse kanë qenë të kënaqur me përvojën e tyre me mësimin e Anglishtes së Biznesit në FE/UT dhe shumica apo 43% e tyre kanë pohuar se janë D si dhe shumica apo 47% e tyre janë PD që do ta rekomandonin metodologjinë CLIL në klasat e Anglishtes së Biznesit.

Rezultatet tregojnë që këto janë përqindjet më të larta në të gjithë grafikët, duke dëshmuar pranim të gjerë dhe vlerësim të fortë për metodologjinë CLIL.




Figura 10

Kjo do të thotë që studentët e këtij eksperimenti patën një përvojë mësimore pozitive mesatarisht të lartë duke u mundësuar atyre nxënien efikase të përmbajtjeve, motivimin, rritjen e vetëvlerësimit si dhe duke na konfirmuar edhe njëherë faktin që CLIL është një metodologji efikase e cila sjell përfitime të dukshme tek studentët në mësimin e përmbajtjeve në gjuhë të huaj.

4.1 Përmbledhje e interpretimeve

Bazuar në fig. 11. përqindjet e larta (34%–50%) në shumicën e grafikëve tregojnë impakt të rëndësishëm të metodologjisë CLIL në zhvillimin e aftësive gjuhësore, lëndore dhe bashkëpunuese.

Prania e përqindjeve neutrale në disa fusha (deri në 34%) sugjeron nevojën për qartësim më të madh të lidhjeve midis përmbajtjes dhe konteksteve reale profesionale.

Niveli më i lartë i aprovim/rekomandimit (47% PD) i atribuohet përvojës së përgjithshme, që e konsideron CLIL një metodë të suksesshme dhe të rekomandueshme në mësimdhënien e Anglishtes së Biznesit.

Figura	Plotësisht Dakord (%)	Dakord (%)	Neutral (%)
Fig. 1 - Aftësi gjuhësore	44	34	0
Fig. 2 - Njohuri lëndore	35	41	0
Fig. 3 - Lidhja me punën	0	35	28
Fig. 4 - Të shkruarit & prezantime	38	38	0
Fig. 5 - Efektiviteti i lektorit	0	44	0
Fig. 6 - Ndërgjegjësim kulturor	0	31	0
Fig. 7 – Bashkëpunimi	0	38	0
Fig. 8 - Mendimi kritik	0	35	25
Fig. 9 - Rritja profesionale	0	34	34
Fig. 10 - Kënaqësia & rekomandimi	47	43	0

5. Përfundime

Bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi konfirmojnë qartazi se zbatimi i metodologjisë CLIL në mësimdhënien e Anglishtes së Biznesit ka pasur ndikim pozitiv dhe të shumanshëm tek studentët e grupit të studentëve me të cilët u implementua kjo metodologji. Përmes përdorimit të modeleve mësimore të strukturuar dhe integritit të përmbajtjes lëndore me zhvillimin e aftësive gjuhësore, studentët rezultojnë të kenë perceptime pozitive lidhur me kompetencat e tyre gjuhësore, profesionale dhe kulturore të përfutuara.

Analiza e të dhënave nga pyetësi, i ndarë sipas shkallës së Likert, tregon se shumica dërrmuese e studentëve shprehën nivel të lartë kënaqësie dhe përfitimi nga kjo qasje metodologjike. Ata vlerësuan përmirësimin e aftësive të të kuptuarit dhe të shprehurit në anglishten e biznesit, kuptimin më të thellë të koncepteve lidhur me biznesin, rritjen e ndërgjegjësimit kulturor edhe pse kjo rezulton deri diku si e tillë dhe ka vend për përmirësime, si dhe përgatitjen më të mirë për sfidat e mjedisit profesional global.

Gjithashtu, rezultatet nënvizojnë rolin e rëndësishëm të lektorit si udhëheqës i procesit të integruar të mësimdhënies dhe nxënies, duke përdorur teknika ndërvepruese dhe materiale autentike që favorizojnë angazhimin aktiv të

studentëve. CLIL ka nxitur gjithashtu zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit dhe mendimit kritik, elementë thelbësorë në formimin e profesionistëve të rinj në fushën e biznesit.

Në përfundim, ky studim dëshmon efikasitetin e metodologjisë CLIL në kontekstin universitar dhe nevojën për t'u përdorur më gjerësisht e më efikasitet në mësimin e përmbajtjeve lëndore në gjuhë të huaja.

Modestish do të sugjeronim që të mundësoheshin trajnime për formime më të thelluara të mësimdhënësve me përdorimin e kësaj metodologjie, hartimin e moduleve integrale CLIL, përfshirje sistematike të CLIL në kurrikula për të lidhur më ngushtë kompetencat gjuhësore me ato profesionale. të tilla që t'i ofrojnë kujt do që operojnë në mësimdhënien e përmbajtjeve në gjuhë të huaj lehtësimin e procesit të mësimdhënien dhe të mësimnxënies.

BIBLIOGRAFIA

- AZEMI B. &BUJARI R. (2013), *Bazat e Kërkimit në Edukim*, Basics of Research in Education, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- BALBONI P. E. (2016). *Didattica dell'Italiano a Stranieri*. Roma: Bonacci editore.
- BOWER K. &CROSS R. &COYLE D. (2020), *CLIL in Multilingual and English-Background Contexts: Expanding the Potential of Content and Language Integrated Pedagogies for Mainstream Learning*. In: Bower K, Coyle D, Cross R, Chambers GN, eds. *Curriculum Integrated Language Teaching: CLIL in Practice*, Cambridge University Press, fq. 3-21.
- Commissione europea, Direzione generale dell'Istruzione, della gioventù, dello sport e della cultura & Eurydice. (2006). *Apprendimento integrato di lingua e contenuto (Content and Language Integrated Learning – CLIL) nella scuola in Europa*. Ufficio delle pubblicazioni dell'Unione europea.
- COONAN C. M. (1998), *Content and Language Integrated Learning (CLIL) in Italy: Present situation and possible developments*, tek D. Marsh et al., *Future scenarios in content and language integrated learning*. University of Jyväskylä.
- COONAN C. M. (1999), *Nuovi orientamenti nell'educazione bilingue in Europa*, tek P. Balboni, *Educazione bilingue*, Guerra-Soleil.
- COONAN C. M. (1999), *Priorities for investment in the development of CLIL*. In

- D. Marsh & D. Marsland (Eds.), *CLIL initiatives for the millennium: Report on the CEILINK Think Tank*, University of Jyväskylä.
- DALTON-PUFFER Ch. (2011), Content-and-Language Integrated Learning: From Practice to Principles?. *Annual Review of Applied Linguistics*, Vol. 31, fq. 182 -204, Doi: <https://doi.org/10.1017/S0267190511000092>.
- DAVIES W. M. (2009), Groupwork as a Form of Assessment: Common Problems and Recommended Solution, *Higher Education*, Vol. 58, Nr. 4, fq. 563- 584, Doi: <https://doi.org/10.1007/s10734-009-9216-y>.
- DI PARDO L. H. D. (2015), Special Issue on CLIL CLIL in the Business English Classroom: From Language Learning to the Development of Professional Communication and Metacognitive Skills, *ELTWorldOnline.com*, <http://blog.nus.edu.sg/eltwo/?p=4850>
- DOIZ A. & LASAGABASTER D. & SIERRA J., (2014), CLIL and motivation: The effect of individual and contextual variables. *The Language Learning Journal*, Vol. 42, Nr. 2, fq. 209-224, Doi: <https://doi.org/10.1080/09571736.2014.889508>.
- FRANCESCHINI R., (2011), Multilingualism and multi-competence: A conceptual view. *The Modern Language Journal*, Vol. 95, Nr. 3, fq. 344-355; <https://doi.org/10.1080/13670050.2018.1517722>.
- LASAGABASTER D. (2008), Foreign Language Competence in Content and Language Integrated Courses, *The Open Applied Linguistics Journal* Vol.1, Nr. 1, fq. 30-41, Doi: 10.2174/1874913500801010030.
- MARSH D. et al. (1996), Teaching content through a foreign language in Finland. In G. Fruhauf et al. (Eds.), *Teaching content in a foreign language*. European Platform for Dutch Education.
- MARSH D. (2002), *CLIL/EMILE: The European dimension. Actions, trends and foresight potential*. University of Jyväskylä.
- MARSH D. (2002), Main features of CLIL, tek G. Langè (Ed.), *Tie-CLIL professional development course*, Grafica L. Monti.
- MARSH D. (2003), Réaliser l'objectif 1+2 en Europe : la voie du CLIL/EMILE. *Bulletin d'information du Conseil Européen pour les Langues*, Vol. 9, <http://userpage.fu-berlin.de/~elc/bulletin/9/fr/marsh.html>.
- MARSHALL G. (2009), *A dictionary of sociology* (bot 4), Oxford University Press.
- MAYER R. E. (1988), Learning Strategies: An Overview. In C. E. Ėinstein, E. T. Goetz, & P. A. Alexander (Eds.), *Learning and Study Strategies: Issues in Assessment, Instruction, and Evaluation* New York: Academic Press, fq. 11-22; <https://doi.org/10.1016/B978-0-12-742460-6.50008-6>
- MONTROYA O. I. R. (2022), Aprendizagem integrada de conteúdos e línguas estrangeiras (clil) para desenvolver habilidades de escrita em inglês. In SciELO Preprints. <https://doi.org/10.1590/SciELOPreprints.5155>
- OXFORD R. L. (1997), Cooperative Learning, Collaborative Learning, and Interaction: Three Communicative Strands in the Language Classroom, *The modern Language Journal*, Vol. 81, Nr. 4, fq. 439- 592; <https://doi.org/10.1111/j.1540-4781.1997.tb05510.x>
- PEREIRA D. (2025), Patagonia Marketing Strategy, <https://businessmodelanalyst.com/>

patagonia-marketing-strategy/ (konsultuar 30 mars)

PINNER R. (2021), Authenticity and Motivation in CLIL: Creating a Meaningful Purpose by Experiencing the Language in Use. In: Hemmi, C., Banegas, D.L. (eds) International Perspectives on CLIL. International Perspectives on English Language Teaching. Palgrave Macmillan, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-030-70095-9_2

Profili i Politikës Arsimore Gjuhësore Shqipëria 2015- 2017, <https://rm.coe.int/profili-i-politikes-arsimore-gjuhesore-shqiperia/168075acb0>

RICCI G. F. (2006), *Il futuro si chiama CLIL: Una ricerca interregionale sull'insegnamento veicolare*, The future is called CLIL: An interregional research on vehicular teaching, Editore Provincia Autonoma di Trento - IPRASE del Trentino; <https://www.iprase.tn.it/documents/20178/264352/Il+futuro+si+chiama+CLIL/51817688-2d2a-4dab-b842-2b5a195ba0c4>

RODRIGUES J.B. (2012), Content and Language Integrated Learning (CLIL). Considerations in the Colombian Context, *Gist: Education and Learning Research Journal*, Vol. 6, fq. 177-189. <https://eric.ed.gov/?id=EJ1062605>

SOKOLI L. (2016), *Metodat e kërkimit shkencor*, Methods of scientific research, (Bot. 5). Bukinist.

SOMERS T. & LLINARES A. (2018). Students' motivation for content and language integrated learning and the role of programme intensity. *International Journal of Bilingual Education and Bilingualism*, 24(6), 839–854. <https://doi.org/10.1080/13670050.2018.1517722> (Konsultuar më 3.07.2024)

SOMERS T. & LLINARES A., (2018), Students' motivation for content and language integrated learning and the role of programme intensity. *International Journal of Bilingual Education and Bilingualism*, Vol. 24, nr. 6, fq. 839–854.

WOLFF D. (1997), Content-based bilingual education or using foreign languages as working languages in the classroom tek Marsh D., et al., *Aspects of implementing plurilingual education: Seminar and field notes*, University of Jyväskylä.

https://www.hotspoteffect.com/blog/11-companies-that-are-killing-it-with-their-digital-marketing-campaigns-in-2024?utm_

<https://www.marketingweek.com/best-marketing-campaigns-2024-1/>

https://www.youtube.com/watch?v=UYaY2Kb_PKI

<https://www.sbdc.uh.edu/images/sbdc/UH%20SBDC%20Marketing%20Plan%20Template.pdf>

https://www.ivoox.com/en/freemium-and-subscription-business-model-audios-mp3_rf_63215528_1.html

https://www.hotspoteffect.com/blog/11-companies-that-are-killing-it-with-their-digital-marketing-campaigns-in-2024?utm_

<https://www.marketingweek.com/best-marketing-campaigns-2024-1/>

https://www.youtube.com/watch?v=UYaY2Kb_PKI

PËRDORIMI I MJETEVE TEKNOLOGJIKE GJATË PANDEMISË COVID-19 NË SHQIPËRI

Doktorante Kleida Pira

Departamenti i Gjuhës Frënge

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: kleida.pira.fgjhdr@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Pandemia e COVID-19 parashtrori sfida të rëndësishme për shoqërinë shqiptare, sikurse për shoqëritë në mbarë botën, duke i detyruar vendet që të përshtaten me shpejtësi të madhe me teknologjitë e reja në një përpjekje për të ruajtur aktivitetet arsimore, profesionale dhe sociale. Në Shqipëri, si shumë vende të tjera, nevoja për zgjidhje digjitale u bë e domosdoshme për vazhdimësinë e arsimit dhe të punës gjatë masave të izolimit dhe distancimit social. Mes tjerash, Covid-19 ndërtoi një narrativë të re për mënyrën e të bërit mësim duke marrë parasysh ndryshimet e shkaktuara në të gjithë nivelet arsimore. Ky artikull eksploron ndikimin e pandemisë COVID-19 në peizazhin teknologjik të Shqipërisë, duke ekzaminuar rolin e mjeteve digjitale në arsim, si dhe sfidat, me të cilat përballlet adoptimi i këtyre mjeteve. Gjithashtu, ky artikull vlerëson mundësitë e krijuara nga kalimi i përsheptuar drejt digjitalizimit dhe efektet e mundshme afatgjata në shoqërinë shqiptare.

Fjalët çelës: COVID-19, edukimi në Shqipëri, literatura digjitale, mësimi online, teknologjia në edukim, trajnimi i mësuesve, transformimi digjital.

ABSTRACT

The COVID-19 pandemic posed unprecedented challenges for societies worldwide, including Albania, forcing rapid adaptation to digital technologies in education, work, and social interaction. In Albania, the shift to online learning exposed significant digital gaps, particularly in rural and economically disadvantaged areas. This article explores the impact of the pandemic on the digital landscape of Albanian education, focusing on the adoption and use of digital tools during the crisis. It examines how platforms like Google Classroom, Zoom, and Microsoft Teams became central to the continuation of teaching and learning, while also highlighting the difficulties caused by limited access to technology and insufficient digital literacy among both teachers and students. Government-led initiatives, such as the “Digital Education” project, are evaluated in terms of their effectiveness in improving digital competencies. The article also discusses the long-term opportunities created by this accelerated digital transition, such as the potential for hybrid learning models and enhanced student engagement. Finally, it proposes key strategies for a successful digital transformation in education, emphasizing the importance of a clear vision, appropriate investment, continuous training, and fostering a culture of innovation to ensure a more inclusive and resilient educational system in Albania.

Keywords: COVID-19, digital transformation, digital literacy, education in Albania, educational technology, online learning, teacher training.

1. Hyrje

Pandemia e COVID-19 preku pothuajse çdo aspekt të jetës në të gjithë globin, duke i detyruar qeveritë, bizneset dhe individët të përshtaten me realitetet e reja. Në Shqipëri, një vend me një infrastrukturë digjitale në zhvillim, por që ende përballlet me sfida në lidhje me aksesin në internet dhe literaturën digjitale (shkrim-leximin digjital), pandemia nxori në pah mundësitë dhe kufizimet e mjeteve teknologjike në ruajtjen e aktiviteteve sociale dhe ekonomike. Ndërsa kalimi i shpejtë në platformat digjitale ishte i nevojshëm, ai gjithashtu ekspozoi boshllëqe të rëndësishme në aksesin në teknologji, burimet arsimore dhe aftësitë digjitale, veçanërisht në zonat rurale dhe të pafavorizuara ekonomikisht. Ky artikull ofron një analizë të adoptimit dhe të përdorimit të mjeteve teknologjike gjatë pandemisë në Shqipëri, duke u fokusuar në rolin e këtyre mjeteve në arsim, në vendin e punës dhe në sistemet e kujdesit shëndetësor. Po cili është përkufizimi i termit literaturë digjitale? Sipas Unesco-s, «*Literatura digjitale (DL) është: Shkrim-leximi digjital, i cili përfshin përdorimin e sigurt dhe kritik të një game të plotë teknologjish digjitale për informacion, komunikim dhe zgjidhjen e problemeve themelore në të gjitha aspektet e jetës. Ai mbështetet nga aftësitë bazë në TIK: përdorimi i kompjuterave për të tërhequr, vlerësuar, ruajtur, prodhuar, paraqitur dhe shkëmbyer informacion, dhe për të komunikuar dhe marrë pjesë në rrjetet bashkëpunuese nëpërmjet internetit.*»¹

2. Mjetet teknologjike në mësimdhënie

2.1. Kalimi në mësimdhënien online

Në Shqipëri, mbyllja e shkollave dhe e universiteteve në mars 2020 e detyroi vendin të kthehej drejt zgjidhjeve të mësimin në distancë. Platformat digjitale si Google Classroom, Zoom dhe Microsoft Teams u bënë mjetet kryesore për dhënien e mësimave, kryerjen e provimeve dhe ruajtjen e komunikimit midis studentëve dhe mësuesve. Për institucionet e arsimit të lartë, tranzicioni ishte relativisht i shpejtë, me shumë universitete që tashmë vazhdojnë t'i përdorin mjetet online për mësimin e përzier. Sipas Ministrisë Shqiptare të Arsimit, kalimi në arsimin online në ditët e para të pandemisë zbuloi pabarazi të konsiderueshme në aksesin në mjetet digjitale dhe internetin.

¹ Burimi i përkufizimit: <https://tcg.uis.unesco.org/wp-content/uploads/sites/4/2021/08/Metadata-4.4.2.pdf>

Një përqindje e madhe e studentëve, veçanërisht atyre në zonat rurale, nuk kishin akses në teknologjinë e nevojshme, si kompjuterat apo lidhjet e qëndrueshme të internetit. Si përgjigje, qeveria dhe sektorët privatë bënë përpjekje për të shpërndarë pajisje digjitale dhe për të rritur aksesin në internet, por shumë sfida mbetën gjatë gjithë kohës së pandemisë.

Pandemia e COVID-19 shkaktoi një kalim të paprecedentë në mësimin online, duke ndikuar ndjeshëm edhe në peizazhin e arsimit të lartë. Përveç punës për angazhimin e studentëve, fakulteti tani ishte në një pozicion të ri i cili kërkonte një ekspertizë të re për të menaxhuar ndërveprimet në internet, të cilat ishin të ndryshme nga përvojat e tyre në klasat tradicionale. Ofrimi efektiv i klasave në internet kërkoj planifikim të kujdesshëm, përdorimin e teknologjive të avancuara mësimore dhe krijimin e një mjedisi mësimor gjithëpërfshirës dhe ndërveprues. Fakulteti duhet gjithashtu t'i përshtaste në mënyrë të menjëhershme strategjitë e tyre të mësimdhënies për të përballuar sfidat unike të mësimdhënies në internet.

2.2. Kalimi në digjital dhe trajnimi i mësuesve

Përveç barrierave teknike, aftësia e mësuesve dhe pedagogëve për të përdorur në mënyrë efektive platformat online ishte një tjetër sfidë e rëndësishme. Megjithatë disa mësues kishin përvojë të mëparshme me mjetet digjitale, shumë prej tyre nuk ishin të njohur me platformat dhe iu desh të kalonin trajnime të shpejta. Kjo krijoi një situatë ku jo të gjithë mësuesit dhe pedagogët ishin të pajisur me aftësitë e nevojshme për të lehtësuar mësimin e angazhuar dhe efektiv në internet. “Arsimimi digjital” po identifikohet gjithnjë e më shumë si një qëllim arsimor. Ndërsa përkufizimet kryesore ndryshojnë në detaje, qëllimi dhe kuptimi i literaturës digjitale nuk po shihen si problematikë.²

Për të adresuar këtë boshllëk, qeveria shqiptare nisi disa iniciativa, si projekti “**Edukimi Digjital**”, i cili kishte për qëllim përmirësimin e literaturës digjitale (shkrim-leximit) mes mësuesve dhe nxënësve. Projekti përfshinte programe trajnimi online për mësuesit se si të përdorin mjetet digjitale në mënyrë efektive, të krijojnë burime në internet dhe të nxisin angazhimin në klasa virtuale. Ndërsa këto nisma ishin të dobishme, ato theksuan nevojën për investime afatgjata në zhvillimin profesional të mësuesve dhe infrastrukturën

² LANKSHEAR, C., & Knobel, M. (2015). Digital Literacy and Digital Literacies: Policy, Pedagogy and Research Considerations for Education. Nordic Journal of Digital Literacy, f. 8-20.

e arsimit. Sipas Sondazhit të Mësimit Online 1 të kryer nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, mësimi online në kushtet e shtëpisë, me gjithë vështirësitë, ka krijuar mundësi që mësuesit të përdorin më shumë burime digjitale alternative për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e kërkuara nga kurrikula me kompetenca. Nga te anketuarit e Sondazhit, 74.1% e mësuesve shprehen dakord që, u pëlqen shumë ndërveprimi në formë elektronike, madje 88.7% e mësuesve përdorin video-selfie për të përcaktuar përmbajtjet mësimore. Nga rezultatet e grumbulluara nga ky sondazh 84.1% e mësuesve shprehen se kanë shpërndarë me nxënësit dhe me kolegët e tyre video, PowerPoint etj. Ministria e Arsimit ka nisur trajnimin e mësuesve sipas një programi ku përfshihen më shumë se 4000 mësues nga e gjithë Shqipëria. Ky program mbështetet nga 7 universitete publike të njohura për ekselencën në formimin e mësuesve, duke përfshirë Universitetin e Tiranës. Këto institucione ofrojnë trajnime të specializuara në Matematikë, Shkencë, Gjuhë, dhe për Arsimin Fillor, duke përgatitur mësuesit për sfidat e mësimdhënies në epokën digjitale.³ Pedagogë dhe trajnerë të zgjedhur për ekspertizën e tyre japin një mbështetje të vazhdueshme dhe të personalizuar për mësuesit, duke garantuar një zhvillim cilësor dhe të orientuar drejt praktikës. Ky program synon të revolucionarizojë sistemin arsimor përmes përgatitjes së mësuesve me metodologji inovative të mësimdhënies dhe teknologji të avancuara dhe nxit një ndryshim thelbësor në mënyrën se si mësohet dhe sesi mësimdhënia duhet të praktikohet.

3. Mjetet teknologjike në mësimdhënie

3.1. Mësimi në distancë dhe bashkëpunimi digjital

Vitet e fundit, roli i mjeteve teknologjike në arsim është rritur ndjeshëm, duke i transformuar mjediset tradicionale të të mësuarit në hapësira më fleksibël dhe më të aksesueshme. Me zhvendosje globale drejt arsimit digjital të përshpejtuar nga pandemia COVID-19, sektori arsimor i Shqipërisë është kthyer gjithnjë e më shumë drejt teknologjisë për të lehtësuar mësimin, për të përmirësuar bashkëpunimin dhe për të kapërcyer barrierat logjistike. Mësimi në distancë, i shoqëruar me bashkëpunimin digjital, është bërë një gur themeli i praktikave

³ Sondazhi i Ascaph, Sonazhi i mesimit online 1 & 2 - <https://www.ascaph.edu.al/sondazhi-i-mesimit-online-2/>

moderne arsimore në mbarë botën. Pandemia theksoi nevojën që sistemet arsimore të adoptojnë dhe integrojnë mjete digjitale për të siguruar vazhdimësi dhe barazi në arsim. Shqipëria, një vend me një infrastrukturë digjitale në zhvillim të shpejtë, ka dëshmuar një rritje të përdorimit të platformave online dhe të mjeteve të bashkëpunimit digjital për të lehtësuar arsimin.

Përveç mësimin në distancë, mjetet e bashkëpunimit digjital janë bërë integrale për krijimin e përvojave të të mësuarit ndërveprues, me në qendër studentin. Këto mjete mundësojnë komunikimin në kohë reale, bashkëpunimin në projekte dhe ndarjen e burimeve, duke i bërë ato jetike për nxitjen e të menduarit kritik dhe punës ekipore. Në Shqipëri, platforma si Google Drive dhe Microsoft Teams, janë përdorur gjerësisht për të mbështetur bashkëpunimin digjital midis studentëve dhe mësuesve, sidomos pas Pandemisë Covid-19.

Institucionet arsimore në Shqipëri kanë filluar të integrojnë në kurrikulat e tyre projekte bashkëpunuese online, klasa virtuale dhe trajnime online. Këto mjete kanë rritur aftësinë e studentëve për të bashkëvepruar me njëri-tjetrin, për të shkëmbyer ide dhe për të bashkëpunuar në detyra, pavarësisht nga vendndodhja e tyre fizike. Për shembull, universitetet kanë miratuar mjete video-konferencash për të organizuar seminare virtuale, trajnime dhe diskutime, duke u mundësuar studentëve të angazhohen me ekspertë dhe kolegë në një mjedis digjital dinamik. Edhe pse sot nxënësit dhe studentët janë rikthyer në auditorë me një praktikë të re, të përdorurit të platformave online për të komunikuar me pedagogët, regjistrimi në provime apo ndjekja online e trajnime të ndryshme të ofruara nga Departamente të ndryshme vazhdon të funksionojë më së miri.

4. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen

4.1. Ndarja digjitale dhe aksesin në teknologji

Duket se përdorimi i mjeteve digjitale në mësimdhënie është thelbësor duke qenë se ne jetojmë në një botë digjitale dhe është e nevojshme që edhe shkollat të bëhen pjesë e kësaj bote të re.

Një nga sfidat kryesore të zbuluara nga pandemia në Shqipëri ishte ndarja digjitale, veçanërisht në zonat rurale dhe të paprivileguara. Shumë mësuesve dhe pedagogëve u mungon ende aksesin në mjetet e nevojshme digjitale, të cilat përkeqësojnë pabarazinë në arsim. Ndërkohë që u ndërmorën iniciativa për të

ofruar pajisje dhe për të përmirësuar lidhjen, nevojiten investime të mëtejshme në infrastrukturë për të siguruar që të gjithë nxënësit dhe studentët të kenë akses të barabartë në mjetet digjitale në të ardhmen.

Shkrim-leximi digjital është i rëndësishëm për një sërë arsyesh – ai mund të përmirësojë mësimin, t'i ndihmojë studentët të dallojnë keqinformimin dhe ndër të tjera u jep atyre akses në një shumëllojshmëri të gjerë burimesh. Por më e rëndësishmja, studentët dhe nxënësit sot janë më të ekspozuar ndaj botës digjitale sesa gjeneratat e vjetra. UNICEF-i raporton se 70% e 15-24-vjeçarëve janë gjatë gjithë kohës në internet, kështu që ata po i zhvillojnë vetë aftësitë digjitale. Kjo për pasojë sjell që pasurimi i njohurive të tyre me literaturë digjitale të jetë pakët, përveçse në rastet kur bëhet me udhëzim të qëllimshëm për shkollimin e tyre.⁴

4.2. Edukimi dhe literatura digjitale

Pandemia nënvizoi rëndësinë e literaturës digjitale si për studentët ashtu edhe për të rriturit në Shqipëri. Ndërkohë që ka pasur përpjekje për të trajnuar mësuesit dhe studentët në përdorimin e mjeteve digjitale, një strategji afatgjatë për përmirësimin e literaturës digjitale në të gjitha nivelet e arsimit është thelbësore. Kjo përfshin integrimin e aftësive digjitale në kurrikul dhe ofrimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për edukatorët.

“Shkenca digjitale “ mund të përkufizohet si aftësia për të njohur, përdorur, menaxhuar administruar, analizuar dhe sintetizuar burimet dhe mjetet digjitale, për të krijuar informacione të reja dhe për të komunikuar me të tjerët në këtë mënyrë, përveç aftësisë për të përdorur teknologjitë e ndryshme të informacionit dhe komunikimit në jetën e përditshme dhe në proceset arsimore. Kjo i referohet një grupi të gjerë aftësish, duke përfshirë funksionet e të qenit në gjendje të aksesoni, prodhoni dhe shkëmbeni informacion të saktë në mjedis. Shkrim-leximi digjital është një mënyrë e veçantë dhe e ndryshme e të menduarit dhe jo vetëm që përfshin aftësinë për të marrë informacion përmes internetit, por edhe aftësinë për të zgjedhur dhe vlerësuar informacionin e gjetur. Ndërkohë që studiuesit vlerësojnë si aspektet pozitive ashtu edhe ato negative të kontributit të digjitalizimit në proceset e edukimit dhe trajnimit, të cilat janë bërë veçanërisht të rëndësishme për të ekzistuar në botën e sotme.

⁴ M.Evans (2020), A Teacher's Guide to Digital Literacy & Digital Literacy Skills in the Classroom, Universiteti I San Diegos

4.3. Ndikimi afatgjatë i transformimit digjital

Përdorimi i shpejtë i mjeteve digjitale gjatë pandemisë COVID-19 në Shqipëri ka potencialin të lërë një trashëgimi të qëndrueshme. Ndërsa bizneset dhe institucionet vazhdojnë të përqafojnë teknologjitë digjitale, ka një mundësi që Shqipëria të forcojë ekonominë e saj digjitale dhe të përmirësojë konkurrencën e saj globale. Mësimet e nxjerra gjatë pandemisë mund të drejtojnë politikat e ardhshme që synojnë nxitjen e inovacionit, mbështetjen e sipërmarrjes digjitale dhe zgjerimin e përfshirjes digjitale.

Revolucioni digjital ka mbërritur në vendin tonë dhe po e transformon arsimin në mënyra që vetëm pak vite më parë nuk mund ta imagjinoreshin. Pandemia ishte edhe si një zile zgjimi. Na tregoi rëndësinë e fleksibilitetit dhe të përshtatshmërisë në arsim. Shkollat dhe universitetet që kishin përqaftuar tashmë mjetet digjitale ishin të pajisura më mirë për të përballuar kalimin e shpejtë drejt mësimin në internet. Ndërsa ato që nuk kishin, iu desh të luftonin më shumë. Por përtej menaxhimit të krizës, transformimi digjital ka të bëjë me rritjen afatgjatë. Bëhet fjalë për përgatitjen e studentëve për të ardhmen e punës dhe për t'u dhënë pedagogëve mjetet që u nevojiten për të pasur sukses.

Ka disa Universitete siç është ai i Lilles në Francë të cilët ofrojnë prej vitesh një model të të mësuarit plotësisht në distancë me ndihmën e një infrastrukture të fuqishme digjitale në të cilën kane investuar gjatë viteve. Këto modele mund të hedhin bazat për një model mësimi hibrid që përmirëson fleksibilitetin dhe angazhimin e studentëve. Historia e tyre është një shembull i fuqishëm i rëndësisë së investimeve digjitale të menduara përpara.

Mund të themi: në një botë ku çdo gjë është bërë digjitale, arsimi nuk mund të përballojë të mbetet prapa.

Këtu qëndron rëndësia e vërtetë e transformimit digjital. Nuk ka të bëjë vetëm me atë që teknologjia mund të bëjë për ne; ka të bëjë me atë që na lejon të bëjmë më mirë. Për mësuesit, përkthehet në më shumë kohë të shpenzuar për mësimdhënie dhe mentorim dhe më pak për detyra administrative. Për studentët, përkthehet në një përvojë mësimore më të personalizuar, fleksibël dhe tërheqëse. Për institucionet arsimore, kjo do të thotë të qëndrojnë të rëndësishëm në një botë gjithnjë e më konkurruese dhe me ritme të shpejta.⁵

⁵ S. Sarma (2021), "Embracing Digital Transformation in Education – A Journey, Not a Destination"

4.4 Disa strategji për transformim digjital të suksesshëm

Transformimi digjital i suksesshëm është procesi në të cilin shkollat dhe universitetet, kanë ndryshuar dhe do të përmirësojnë mënyrën se si funksionojnë dhe ofrojnë shërbime duke integruar teknologji digjitale në të gjitha aspektet e saj. Ky proces mund të përfshijë ndryshime të thella në mënyrën se si Institucioni, në këtë rast shkolla dhe Universiteti, menaxhon situatat dhe aktivitetet dhe në të njëjtën kohë komunikon me nxënësit ose studentët. Në këtë artikull kemi menduar të zhvillojmë pesë prej këtyre strategjive kyçe.

- **Krijohet një vizion dhe plan i qartë:** E para është të pasurit e një ideje të qartë për atë ku dëshirojmë të mbërrijmë. Transformimi digjital mund të jetë një udhëtim i pasigurtë nëse nuk kemi një orientim të qartë, ndaj duhet të shtrohen pyetje thelbësore: a sjell rritje të rezultateve të studentëve, përmirësimi i efikasitetit operacional, apo ofrimi i mundësive më të mira për arsim? Qëllimi duhet të jetë i qartë dhe i matshëm. Po ashtu, përgatitja e një plani se si mund të arrijmë këto qëllime. Për shembull, Finlanda është një udhëheqëse në këtë drejtim, ku shkollat kanë zhvilluar një qasje të gjithanshme për të integruar teknologjinë në mësimdhënie dhe për t'i përgatitur studentët për të ardhmen digjitale.

- **Investohet në teknologjinë e duhur:** Teknologjia është kyçe për këtë transformim, por ajo duhet të jetë e përshtatshme për nevojat e institucioneve. Para se të bëhen investime, duhet të sigurohet që teknologjia që do të përdoret të përputhet me qëllimet dhe të ndihmojë në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënies. Universiteti i Queensland në Australi, për shembull, ka investuar në inteligjencën artificiale për të ofruar përvoja mësimore të personalizuara për studentët e tij, duke përmirësuar kështu angazhimin dhe rezultatet akademike.

- **Sigurohen trajnime dhe mbështetje të vazhdueshme:** Teknologjia do të jetë e efektshme vetëm nëse përdoret siç duhet. Një pengesë e madhe për suksesin e transformimit digjital është mungesa e trajnimeve dhe mbështetjes për stafin edukativ dhe administrativ. Ofrohet mundësi për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe sigurohet që stafi të ketë mjetet dhe besimin për të përdorur teknologjitë e reja. Për shembull, Shkolla e Ekonomisë në Londrës (LSE) ka krijuar programe trajnimi për edukatorët, duke kontribuar kështu në rritjen e angazhimit të studentëve dhe përmirësimin e rezultateve të të nxënies.

- **Nxitja e një kulture inovative:** Transformimi digjital kërkon një ndryshim të mentalitetit, përveç përdorimit të teknologjisë. Nxitja e stafit të

mendojë «përtej kutisë» dhe të përqafojë ndryshimin. Duhet krijuar një kulturë ku idetë e reja janë të mirëpritura dhe ku përmirësimi i vazhdueshëm është një normë. Singapori, për shembull, është i njohur për inkurajimin e inovacionit në shkollat e tij, duke përqaftuar metoda të reja mësimore si ajo e “mëso më pak, mëso më shumë” që ka fokus në zhvillimin e të menduarit kritik. Ndërsa ne Shqipëri, vlen për t’u theksuar se të bërit një shkollim online mbetet ende një «tabu» dhe shpesh gjykohet nga masa si një arsimim i paplotësuar.

• **Vlerësimi dhe monitorimi:** Transformimi digjital është një proces që kërkon vlerësim të vazhdueshëm. Përdorimi i të dhënave për të matur suksesin e iniciativave, pavarësisht nëse është përmirësimi i rezultateve të studentëve, rritja e efikasitetit operacional, apo angazhimi më i madh. Universiteti i Harvardit, për shembull, përdor analiza të të dhënave për të monitoruar dhe vlerësuar efektivitetin e platformave të tij digjitale, duke ndihmuar kështu në ruajtjen e reputacionit të tij si lider në arsim.

5. Përfundime

Pandemia e COVID-19 solli një periudhë të paprecedentë të ndryshimeve në mënyrën e funksionimit të shoqërisë shqiptare, duke nxitur një kalim të shpejtë dhe të detyruar drejt përdorimit të mjeteve digjitale në fusha të ndryshme, përfshirë arsimin, punën dhe shëndetësinë. Kjo periudhë sfidash ka nxjerrë në pah mundësitë dhe mangësitë që ekzistojnë në infrastrukturën digjitale të vendit. Në sektorin e arsimit, kalimi në mësimin online ka pasur një ndikim të dukshëm, duke e bërë të domosdoshëm përdorimin e platformave të teknologjisë për vazhdimin e procesit mësimor. Megjithatë, kanë lindur sfida të mëdha, përfshirë pabarazitë në aksesin në teknologji, mungesën e aftësive të mësuesve për të përdorur këto mjete dhe nevojën për investime të mëtejshme në infrastrukturë dhe zhvillimin profesional të edukatorëve.

Në përfundim, transformimi digjital që ka ndodhur gjatë pandemisë ka krijuar mundësi të reja për arsimin në Shqipëri, por ka vënë gjithashtu në pah nevojën për një strategji të qëndrueshme dhe të integruar për përmirësimin e literaturës digjitale dhe teknologjisë në mësimdhënie. Ky transformim ka potencialin të lërë një trashëgimi të qëndrueshme, duke ndihmuar në rritjen e konkurrencës globale të Shqipërisë dhe përmirësimin e efikasitetit të arsimit dhe zhvillimit të aftësive të studentëve për të përballuar kërkesat e një bote

gjithnjë e më të digjitalizuar. Megjithatë, ky proces kërkon një angazhim të qëndrueshëm dhe investime të mëtejshme në teknologji, trajnime dhe mbështetje për stafin edukativ dhe administrativ, për të siguruar një transformim digjital të suksesshëm dhe të qëndrueshëm në të gjitha nivelet e arsimit.

Për të përfunduar, transformimi digjital në arsim dhe në shoqërinë shqiptare është një hap i nevojshëm për të garantuar që Shqipëria të mbetet e përgatitur për sfidat dhe mundësitë e ardhshme që sjell teknologjia, duke ndihmuar në krijimin e një brezi të ri të studentëve të aftë për të përballuar një të ardhme digjitale.

BIBLIOGRAFIA

ASCAP, Sondazhi i mesimit online 1 & 2 - <https://www.ascap.edu.al/sondazhi-i-mesimit-online-2/>

Burimi: <https://tcg.uis.unesco.org/wp-content/uploads/sites/4/2021/08/Metadata-4.4.2.pdf>

DANIEL, S. J. (2020). *Education and the COVID-19 pandemic*.

ESHET, Y. (2002). *Digital literacy: A new terminology framework and its application to the design of meaningful technology-based learning environments*. në P. Barker, & S. Rebelsky (Eds.), *Educational Multimedia and Hypermedia* (pp. 493-498).

EVANS, M. (2020), *A Teacher's Guide to Digital Literacy & Digital Literacy Skills in the Classroom*, Universiteti i San Diegos

LANKSHEAR, C., & KNOBEL, M. (2015). *Digital Literacy and Digital Literacies: Policy, Pedagogy and Research Considerations for Education*. Nordic Journal of Digital Literacy, 8-20

SARMA, S. (2021), *Embracing Digital Transformation in Education – A Journey, Not a Destination*

EMOCIONALITETI NË GJUHËN E GAZETAVE SPORTIVE. STUDIM KRAHASUES MIDIS SHQIPES DHE GJERMANISHTES.

Doktorante Anxhela Belkovi

Departamenti i Gjuhës Gjermane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: anxhela.belkovi@unitir.edu.al

Prof. Asoc. Dr. Sonila Sadikaj

Departamenti i Gjuhës Gjermane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: sonila.sadikaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Emocionet janë pjesë përbërëse të sjelljes dhe të përjetimit të njeriut. Përcaktimi dhe manifestimi i konceptit emocion nëpërmjet mjeteve dhe mënyrave shprehëse i ka fillesat që prej studimeve të kahershme. Manifestimi i tyre tregohet në forma të ndryshme por rolin kyç e luan komunikimi verbal. Të analizohet dhe të shtjellohet gjuha e artikujve sportive në një studim krahasues midis dy gjuhëve në mënyrën e duhur, nuk është thjesht analiza nga një strukturë gjuhësore në një tjetër, por është ridhënie e veçorive kulturore-historike, të mëshiruara në lëndën gjuhësore, duke kaluar nga një traditë në një tjetër formë të komunikimit, të rrëfimit, të përçimit të ngarkesës emocionale dhe të shprehësisë. Në këtë artikull do të trajtoj, sesi reflektohet dhe shprehet përjetimi emocional në artikujt e gazetave sportive, nëpërmjet komunikimit gjuhësor. Do të trajtohet sesi formulimet emocionale shprehin më së miri përjetimin e fitores, humbjes, e lumturisë apo të mërziës dhe se, cilat janë mjetet shprehëse gjuhësore të emocioneve në fushën e sportit. Gjithashtu, është e rëndësishme të konstatojmë se si përshkruhet dhe emërtohet ndjenja pozitive apo negative nëpërmjet mjeteve gjuhësore. Si burim kryesor ky punim do të ketë artikujt të gazetave sportive në gjuhën shqipe dhe gjermane. Fjalët çelës: emocion, frazeologji, gjuhësia e emocioneve, gjuhësia konjitive, metafora, sporti, somatizma.

ABSTRACT

Emotions are an integral part of human behavior and experience. The definition and expression of emotions through various tools and methods have been explored since early studies. While emotions can manifest in many forms, verbal communication plays a central role. Analyzing and elaborating on the language of sports articles in a comparative study between two languages is not simply a transition from one linguistic structure to another; rather, it involves a re-interpretation of the cultural and historical

features embedded in language. This process reflects a shift from one tradition to another form of communication, narration, and the transmission of emotional charge and expressiveness.

This article examines how emotional experience is conveyed and expressed in sports newspaper articles through verbal communication. It explores how emotions such as victory, defeat, happiness, and sadness, are articulated, and what linguistic and expressive tools are employed to convey emotions in the field of sports. Additionally, the article seeks to identify how positive and negative emotions are described and labeled through linguistic means. The primary source for this study are sports newspaper articles in Albanian and German.

Keywords: cognitive linguistics, emotion, linguistics of emotion, metaphor, phraseology, sport, somatism.

Hyrje

Emocioni si pjesë përbërëse fiziologjike e çdo individi është themelor në përçimin e të menduarit apo të vepruarit në situata të ndryshme. Emocionet na udhëheqin në proceset e perceptimit, mendimit dhe veprimit tonë të përditshëm duke influencuar edhe ndërgjegjen tonë, duke prekur kështu të gjitha fushat e jetës njerëzore dhe duke ndikuar mënyrën se si e perceptojmë botën që na rrethon dhe se si e përjetojmë realitetin jashtëgjuhësor. Sipas Gebauer emocioni nuk është fenomen njëdimensional, por krijon një shumëllojshmëri të së brendshmes, së jashtmes, biologjikes, psikikes dhe të sociale, që e karakterizon secilin prej nesh.¹ Sporti në vetvete është emocion, edhe të dy së bashku qëndrojnë në një bosht, ku secili element lidhet me tjetrin, por pavarësisht kësaj njeriu ndjen gjithmonë nevojën e komunikimit të emocioneve të tij nga brenda-jashtë, pra ndjen domosdoshmërinë e shfaqjes së tyre me mjete verbale dhe joverbale. Teksa mendojmë për sportin, menjëherë na bie ndërmend se vetëm nëpërmjet gjestikulacionit apo veprimit fizik të sportistëve na është dhënë emocion. Por emocioni dhe shprehja e tij nëpërmjet gjuhës apo komunikimit verbal, duket se janë dy skaje larg njëra tjetrës. Vlen të thuhet se komunikimi verbal apo lidhja midis gjuhës dhe emocionit është në të vërtetë një nga fenomenet thelbësore për të kuptuar qënien njerëzore.

¹ Gebauer, Gunter; Holodyski, Manfred; Koelsch, Stefan; von Scheve, Christian (2017), Einleitung: Von der Emotion zur Sprache. In Gunter Gebauer, Manfred Holodyski, Stefan Koelsch, Christian von Scheve (Hrsg.), Von der Emotion zur Sprache. Wie wir lernen, über Gefühle zu sprechen (7–16). Velbrück Wissenschaft, f. 10

Ky studim realizohet nën dritën e njohurive të Gjuhësisë së Emocioneve, e cila është një fushë e re kërkimore–shkencore, e cila ka si objekt hulumtimin e emocioneve të shprehura nëpërmjet gjuhës dhe që kombinon njohuri nga gjuhësia, psikologjia, neuroshkenca dhe nga disiplina të tjera për të kuptuar më mirë lidhjen mes gjuhës dhe emocioneve.

Në këtë punim objektivi kryesor do të jetë: Me çfarë mjetesh gjuhësore (leksema, metafora, metonimi, krahasime apo simbole) u referohemi emocioneve në artikujt e gazetave sportive? Pra si i emërtojmë, përshkruajmë dhe shprehim emocionet në gjermanisht dhe shqip në këtë zhanër tekstesh? Si reflektohen përjetimet emocionale (në fushën sportive) dhe reagimet fizike/trupore si rrjedhojë e këtyre ndjesive në komunikimin gjuhësor? Dhe në këto dallime e ndryshime konsiston objektivi i radhës i këtij punimi, që është evidentimi i burimit të figurshmërisë dhe simbolikës së shprehjes verbale të emocioneve në artikujt e gazetave si për shqipen ashtu edhe për gjermanishten, duke marrë në konsideratë ndikimet specifike të kulturës së sportit, zhvillimit historik të secilit prej vendeve.

Gjuhësia e emocioneve në studimet e gjuhës shqipe dhe gjermane

Emocioni luan një rol shumë themelor në formulimin e një teksti të shkruar apo të folur, siç janë p.sh. fjalimet. Këndvështrime të ndryshme të gjuhëtarëve që prej kohës se antikitetit dëshmojnë, se është pothuajse e pamundur të shkruash një mendim, pa qenë i përfshirë emocionalisht. Emocioni arrihet të shprehet, kur folësi është vetë i pushtuar nga ai, sepse vetëm atëherë do të krijohet “ura lidhëse e ndjesisë” midis tij dhe publikut.²

Charles Darwin në librin e tij “Shprehja e emocioneve tek njeriu dhe kafshët” parashtrohet lidhjen e ngushtë të teorisë së evolucionit, etologjisë dhe të shprehjes së emocioneve, formulon se cilat janë emocionet bazë, ndjesitë dhe mënyrat e tyre të komunikimit jo verbal, ashtu dhe verbal.³ Nën gjurmët e tij kanë dhënë kontribut edhe shumë gjuhëtarë, por një nga pasuesit dhe mbrojtësit e tezës së Darwin-it është Paul Ekman. Sipas tij emocionet bazë janë: gëzimi,

² LUASBERG H.(1960). Handbuch der literarischen Rhetorik.Eine Grundlegung der Literaturwissenschaft.2Bde.München: Hueber

³ DARWIN Ch. (2000/1872) Der Ausdruck der Gemütsbewegungen bei dem Menschen und den Tieren. Kritische Edition, Einleitung, Nachwort und Kommentar von Paul Ekman. Frankfurt am Main, Eichborn.

acarimi, mërzia, neveria, frika dhe habia, por në qasjen e tij thekson se nuk janë të vetmet por 5 deri në 9 emocione bazë primare, të cilat janë krijuar dhe shprehjen në mënyrë universale kudo.⁴ Krahas emocionave primare, hulumtuesi Ekman në një studim të mëvonshëm ndan edhe 15 emocione sekondare, po aq të rëndësishme për shprehjen e përjetimeve të njeriut. Rezulton se teoritë njohëse të emocionit kanë pasur dhe kanë prioritet, edhe se nëpërmjet gjuhës dhe komunikimit të tyre nëpërmjet mënyrave të ndryshme: mimikë, gjestikulacion, komunikim joverbal dhe verbal, e bëjnë të mundur perceptimin e tyre si spontan dhe të pavullnetshëm, ashtu dhe të kontrolluar edhe të vullnetshëm.

Sistemi gjuhësor dhe sistemi konjitiv për një kohë të gjatë mendohej se ishin të pavarura, të pa ndikuara nga emocionet dhe kështu emocionaliteti ishte lënë jashtë fokusit të studimeve apo hulumtimeve gjuhësore dhe të shkencave konjitive. Tashmë, që prej fillimit të vitit 2000 mund të flitet për një gjuhësi të re, të ashtuquajturën “Gjuhësia e emocioneve”, e cila konsiderohet një fushë kërkimore-shkencore ndërdisiplinore, që ka si objekt hulumtimin e emocioneve të shprehura nëpërmjet gjuhës dhe që kombinon njohuri nga gjuhësia, psikologjia, neuroshkenca dhe nga disiplina të tjera për të kuptuar më mirë lidhjen mes gjuhës dhe emocioneve (Hartmann 2005). Për gjuhën shqipe mund të themi se ka studime krahasuese, por janë të pakta dhe deri tani nuk kanë arritur të trajtojnë të plotë të gjithë gamën e aspekteve të kësaj disipline. Ndër studimet krahasuese të shqipes me gjuhë të tjera nën këndvështrimin e gjuhësisë konjitive, mund të përmendim hulumtimet shkencore të disa autoreve shqiptare, si p.sh.: Sonila Sadikaj (2010) “*Metaphorische Konzepte in somatischen Phraseologismen des Deutschen und Albanischen. Eine kontrastive Untersuchung anhand von Herz- und Hand-Somatismen*”⁵; Milote Sadiku dhe Vjosa Hamiti (2021) “*Balkanphraseologie im Kontrast. Am Beispiel der Somatismen mit der Komponente KOPF im Albanischen, Bosnischen/ Kroatischen/Serbischen und Mazedonischen*”⁶ (Zeitschrift für Balkanologie, f. 57). Përsa i përket emocionalitetit si objekt hulumtimi në gjuhën e gazetave

⁴ EKMAN P. /SALISCH M. von Hg. (1988): *Gesichtsausdruck und Gefühl*. 20 Jahre Forschung von Paul Ekman, Paderborn: Junfermann

⁵ Ky studim përmes qasjes konjitive ka hulumtuar njësitë frazeologjike të shqipes dhe gjermanishtes në kuadrin e teorisë së metaforës konceptuale (e quajtur ndryshe edhe teoria konjitive e metaforës (cognitive metaphor theory).

⁶ Ky studim ka në fokus hulumtimin e emocioneve nëpërmjet frazemave somatike për gjuhën shqipe dhe gjuhët ballkanike.

sportive mund të përmendim studime të këtij lloji për gjuhën gjermane, si për shembull kontributin e Peter Braun (1998) me artikullin “*Anährungen an die Fußballsprache*”, Armin Burkhard (2006) “*Sprache und Fußball*”, Martin Mostyn (2012) me artikullin e tij “*Emotionalisierung in der deutschen und tschechischen Sportberichterstattung*.”

Siç shihet, raporti gjuhësi-emocion përsa i përket studimeve albanologjike apo studimeve krahasuese, ka qenë i vazhdueshëm por i pamjaftueshëm për nënfusha të caktuara. Për këtë qëllim ky artikull do t’i vijë në ndihmë akoma më shumë qasjes së shprehjeve të emocioneve, veçanërisht emocionit në gjuhën e gazetave sportive.

Metodologjia

Ky artikull bazohet mbi qasjen e metodologjisë kualitative, ku nga shembujt e marra nën shqyrtim do të përftohet, sesi mjetet gjuhësore e përcjellin dhe e reflektojnë emocionin në gjuhën e gazetave sportive. Përjetimet emocionale si *ftorja, humbja, entuziazmi dhe zhgënjimi* do të analizohen përsa i takon simbolikës dhe metaforcitetit që bartin, relacionit midis gjuhës dhe emocionit si dhe për sa i përket vlerës stilistikore. Si burim janë përzgjedhur shembuj të gazetave sportive në platformat digjitale dhe print për të dyja gjuhët, për gjuhën shqipe nga gazetatsportive Panorama Sport, Sportexpress, ndërsa për gjuhën gjermane nga gazetatat sportive Sportbild, Spiegel dhe Sport.de. Nga shembujt e marrë nën shqyrtim është kryer analiza përsa i përket figurshmërisë dhe simbolikës që shpreh metafora konceptuale, gjithashtu janë shtjelluar dhe analizuar frazemat somatike dhe roli i tyre në shprehinë e emocionalitetit në artikujt e gazetave sportive.

Emocionaliteti në gjuhën e rubrikave sportive

Aktivitetet sportive shoqërohen nga përjetime emocionale intensive, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo dhe të tërthortë në komunikimin e sportistëve, skuadrës, trajnerit si dhe gazetarëve sportiv. Nëpërmjet ndjesive pasqyrohen nga njëra anë ngjarjet origjinale, autentike dhe spontane, edhe nga ana tjetër nëpërmjet fjalës dhe gjuhës konkretizohen këto ndjesi duke e përshkruar ngjarjen apo veprimtarinë fizike me mjete të ndryshme stilistikore.

Ajo që del në pah si element bërthamë, teksa lexojmë në artikujt e ngjarjeve sportive, është përdorimi i fjalës emocion si bazë thelbësore e përshkrimit të ndjesive të ndryshme që mund të përjetojnë:

*“ÇELËSI – Ançeloti ka gjithçka të llogaritur për finalen e Champions-it. “Gjëja më e rëndësishme për këtë lloj ndeshjeje është të vendosësh ide të qarta në kokën e lojtarëve. Sa më e qartë të jetë, aq më pak nerva do të ketë ekipi. **Emocionet vijnë dhe secili i trajton ato sipas karakterit të tij. Do të ketë emocione, shqetësime, frikë... Por frika është një pjesë e rëndësishme për t’i bërë gjërat mirë këtë sezon: cilësia dhe sakrifica e ekipit kanë qenë mbresëlënëse”.***

(Panorama Sport online, 01.06.2024)

*„Pierre-Emerick Aubameyang (34) hat mit Olympique Marseille das Finale der Europa League verpasst. Nach der Rückspiel-Pleite gegen Atalanta Bergamo (1:1, 0:3) konnte der Ex-BVB-Star (2013 bis 2018) **seine Emotionen nicht zurückhalten.**“-(Shqip: Pierre Emerik Aubameyang humbi finalen e Europa League në ndeshjen me Olympique Marseille Pas disfatës në ndeshjen e kthimit me Atalanta Bergamo ish-ylli i BVB nuk mundi t’i përmbante emocionet e tij.“)*

(Sportbild Online, 10.05.2024)

Sikurse tregohen në shembujt e mësipërm të artikujve në gazetatat sportive në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën gjermane, ndikimi i emocioneve luan një rol të madh në hartimin e teksteve.

Frazemat somatike dhe roli i tyre në shprehjen e emocionalitetit

Shprehjet frazeologjike që përmbajnë së paku një komponent nga pjesët e trupit të njeriut, quhen somatizma. Figurshmëria dhe simbolika që bartin somatizmat, metaforizimi i tyre me pjesë të trupit luajnë një rol të rëndësishëm në konceptualizimin e botës, duke i konsideruar shumë të vjetra pothuajse në të gjitha gjuhët dhe vendet e botës dhe cilësuar si universalizma gjuhësore.⁷ Gjuhëtari Ibrahim⁸ në kumtesën e tij ka shpjeguar dhe konstatuar, se si gjuha e

⁷ KROHN, Karin (1994): Hand und Fuß. Eine kontrastive Analyse von Phraseologismen im Deutschen und Schwedischen. Acta Universitatis Gothoburgensis. Surte, f. 21

⁸ IBRAHIMI M (2011): Frazemat somatike bazuar në gjeste dhe mimik, si burim i frazeologjisë së Jani Thomai. Botim i posaçëm i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë

shkruar ashtu edhe ajo e folur shqipe shënon dhe përdor frazemat somatike, të cilat janë studiuar në veprat e gjuhëtarëve dhe autorëve të shqipes, dhe madje kanë zënë një vend të konsiderueshëm në fjalorin frazeologjik të shqipes. Duke qenë se në tërësinë e saj frazeologjia i përket gjuhës së gjallë, ka më shumë ngarkesë emocionale e figurshmëri. Shprehjet e figurshme të gjuhës janë përshkrime të lidhura me shoqërime emocionale, që kanë të bëjnë me historinë, jetën dhe kulturën e popullit. Në artikujt e gazetave sportive vihet re se emocioni dhe përjetimi i tij përshkruhet nëpërmjet frazemave somatike, të cilat përmbajnë emërtimet e organeve shqisore, me ndihmën e të cilave njeriu i njeh dhe shijon ato që e rrethojnë, si – këmba, dora, hunda, goja etj. Më poshtë do të analizohen disa fragmente të përdorimit të frazemave somatike shkëputur nga artikujt e gazetave sportive për të dyja gjuhët, shqip dhe gjermanisht.

*“Kjo ndeshje më pëlqeu sot nga çunat, ishte shumë pozitive **kanë dhënë zemrën në fushë**”*

(Trajneri i Laçit, Francesco Moriero, Panorama sport.al, 26.10.2024)

*“Milan / Kuqezinjtë **kanë treguar “dhembët” në “San Siro”, duke hedhur njërën këmbë në fazën e 1/8-ve të Europa League66**”*
(Sport Expres.com, 15.02.2024)

*“Gjatë ndeshjes me 100 km/h **njërën sy** e ka në situatën për penallti **dhe syrin tjetër** e ka në stol për të parë sjelljen time”*.

(Trajneri Murinjo, Sport Expres.com, 26.10.2024)

*“Skënderbeu-Bylisi, duel për mbijetesë deri në **“frymën e fundit”**”*

(Panorama Sport, fq.7, 26-27.04.2025)

Në njësitë frazeologjike mund të vërehet se frazemat somatike për të shprehur emocionin në fushën e sportit, janë të larmishme dhe bartin për çdo emocion simbolikën dhe figurshmërinë përkatëse. Në vijim do të shtjellojmë figurshmërinë e disa prej somatizmave, siç janë zemra, syri, këmba edhe fryma. *Kanë dhënë zemrën në fushë* na shpreh, sesi ekipi nuk dorëzohej dhe përpiquej deri në fund për t’ia arritur qëllimin. Zemra si organi kryesor për funksionimin e trupit simbolizon në këtë frazëmë se skuadra ishte e vendosur të arrinte qëllimin e vënë, me gjithë ç’ka ajo kishte.

Shprehja e dytë frazeologjike na shpreh sesi, organi shqisor *syri* simbolizon ndjesinë e pasigurisë dhe të ngjyrimin emocional të cilin e ka ndjerë.

Kanë treguar dhembët na shpalos në mënyrë figurative qëndrueshmërinë e skuadrës dhe gatishmërinë për ta mbrojtur rezultatin me gjithë forcën e tyre.

Dhëmbët simbolizojnë forcën, të qenurit i palëkundshëm.

Hedh një rën këmbë është një simbolikë, e cila na shpreh kuptimin pozitiv në fjalinë e dhënë, pasi të kaluarit në një nivel tjetër apo në rastin konkret të jesh pjesë e kategorisë në të cilën ke pasur synim të jesh.

Në shprehjen frazeologjike *njëri sy dhe tjetri sy*, sytë si pjesë e rëndësishme të trupit, mund të cilësohen si komponenti i parë i komunikimit joverbal, pasi nëpërmjet tyre mund të “flasim” apo të reagojmë në situata të caktuara. Bazuar në shembullin e dhënë, na paraqitet figurshmëria dhe simbolika sesi lojtari i skuadrës tregohet mosbesues ndaj trajnerit të tij, njëkohësisht i pavëmendshëm në lojë dhe si rrjedhojë në rezultatin final të ndeshjes.

Shprehja në titullin e artikullit “*deri në frymën e fundit*” dhe kuptimi i figurshëm i tij, na tregon se pavarësisht se *fryma* nuk është një organ, mund të cilësohet dhe krahasohet si motori i ekzistencës së trupit, pa të cilin nuk do të mund të funksiononte. Në shembullin e dhënë, na tregon sesi dy ekipet do të përpiqen me gjithë çfarë kanë të arrijnë qëllimin e tyre.

“*Zu wenig*”: *Khedira und Svensson legen Finger in die Wunde – Shumë pak; Khedira dhe Svensson e vënë gishtin në plagë.*

(Trajneri Bo Svensson von Union Berlin, Sport.de, 31.10.2024)

Europa-League-Sieger Atalanta Bergamo hat sich am massiven Abwehrriegel von Celtic Glasgow die Zähne ausgebissen. – Titullari “*Europa League*” i *Atalanta Bergamos* thyen dhëmbët nga mbrojtja e fortë e *Celtic Glasgow*.

(Sport.de, 23.10.2024)

Nürnberg-Trainer Klose *stellt* seiner alten Liebe Kaiserslautern *ein Bein* –Trajneri i Nürnberg-ut Klose i fut stërkëmbëshin dashurisë së vjetër Kaiserslauternit.

(Spiegel.de, 16.04.2025)

Toppmöller sagte: “dass wir ein gutes Verhältnis haben, *liegt auf der Hand*.” – Trajneri Topomöller u shpreh se është e dukshme që kanë një marrëdhënie të mirë.

(Trajneri Markus Toppmöller për futbollistin e ekipit, Sport.de, 25.04.2025)

Shembujt e mësipërm të gjuhës gjermane na evidentojnë somatizma, të cilat do ti analizojmë përsa i përket shprehjes frazeologjike dhe simbolikës që ato përfaqësojnë.

E vë gishtin në plagë është njësi frazeologjike, e cila gjen ekuivalencë të plotë dhe për gjuhën shqipe, na paraqet sesi dy lojtarët shprehin shqetësimin

e tyre për performancën e pakët, që ka dhënë skuadra, janë të vetëdijshëm për këtë fakt dhe ngjyrimi emocional është përftuar nga imazhi i *gishtit* mbi plagë, gjithashtu siç *plaga* simbolikisht është e ndjeshme dhe e mundimshme, ashtu ndihen lojtarët dhe e përkufizojnë lojën.

Shprehja tjetër idiomatike në gjermanisht përbëhet nga komponenti somatik *Zähne - dhëmbët* por si idiomë që është, e ka humbur kuptimin e saj të parë dhe na shpreh tërësisht një kuptim të ri. Në fjalinë e dhënë na tregon sesi Atalanta Bergamo ka hasur në qëndresën e fortë të ekipit kundërshtar, pra *ka thyer dhëmbët* e saja.

Shprehja *stellt ein Bein* do të thotë të mashtrosh dikë, në aspektin semantik nënkupton ta dëmtosh dikë. Ndërsa në gjuhën shqipe themi *i fut stërkëmbëshin (dikujt)*, pra kemi një ekuivalencë të pjesshme, duke qenë se shprehja nuk është direkt me komponentin somatik këmbë, por me funksionin që këmba ka, atë të shqelmit apo të goditjes.

Shembulli i fundit na paraqet një idiomë të gjuhës gjermane, por që nuk gjen ekuivalencë në gjuhën shqipe. Frazema somatike *liegt auf der Hand (qëndron, është në dorë)* përmban komponentin somatik *Hand-dorë*, simbolizon atë çka folësi do të tregojë, se një marrëdhënie midis dikujt tjetër është shumë e mirë dhe kjo del në pah qartësisht, pra është e dukshme për të gjithë.

Shprehja e emocionalitetit nëpërmjet metaforës konceptuale

Orientimi i përgjithshëm i studiuesve dhe gjuhëtarëve lidhur me metaforën deri në fund të shekullit XX ka qenë kryesisht nën përkufizimin se ajo është një figurë letrare e përdorur prej njerëzve “kreativë” dhe jo gjithkush e ka zotësinë që ta përdorë. Por metaforat nga ana tjetër janë realizuar duke e krahasuar dukshmërinë e gjërave konkrete në ndërlidhje me koncepte të padukshme. Semantikisht duken të natyrshme dhe nuk shkakton aspak hamendje qartësia kuptimore. Ato kanë fituar një shpeshtësi përdorimi e në njëfarë mënyre u ka humbur “shkëlqimi” poetik, sepse janë kthyer në një fenomen të përditshëm, përdoren dhe merren vesh konvencionalisht nga të gjithë folësit. Këtu vërehen potencialet semantike të metaforës.

Lëvizjet “dehëse” të Ernest Muçit, faqja zyrtare e Europa League mahnitet nga klasi i talentit shqiptar

(*Panorama Sport.al*, 23.01.2025)

Titulli i artikullit në gjuhën shqipe ka përzgjedhur një metaforë, e cila në këndvështrim të parë duket se ka një kuptim negativ, por në këtë shembull tregon tërësisht një qasje pozitive, duke na simbolizuar sesi lëvizjet e futbollistit apo fintet siç quhet në gjuhën e sportit, janë të jashtëzakonshme dhe mbresëlënëse.

“Barça überlebt die Hölle, Panikattacke in Dortmund” – Barça i mbijeton ferrit, atak paniku në Dortmund.

(*Sportbild.de, Dortmund-Barça, 16.04.2025*)

Në titullin e artikullit në gjuhën gjermane është shpalosur pikërisht një nga ndeshjet më të diskutuara, duke qenë se dy ekipet Barcelona dhe Dortmundi qëndrojnë në majat e kampionateve vendase. Rezultati humbës i Barcelonës dhe përjetimi i humbjes, çka është e pazakontë për të, është barazuar njëloj me ndjesinë e ferrit dhe në përshkrimin e ngjarjes është cilësuar si një atak paniku.

Kontribut të çmuar për ta kundruar metaforën si pjesë të përditshmërisë dhe të konjicionit kanë dhënë George Lakoff dhe Mark Johnson. Të dy gjuhëtarët e kanë sfiduar mendimin e ngulitur, mbizotërues për metaforat se ato janë thjesht karakteristikë e gjuhës letrare, duke i parë ato, jo si fenomene letrare, por si varësi të koncepteve që përdoren nga të gjithë folësit, pa dallim, si pjesë e eksperiencave dhe aktiviteteve të përditshme, e që nuk kërkojnë ndonjë talent të veçantë dhe janë pjesë e gjuhës së zakonshme. Duke e kundërshtuar përkufizimin tradicional, studiuesit e gjuhësisë konjitive e shohin përdorimin e metaforave si lidhje mes koncepteve që kanë diçka të përbashkët dhe përdorimi i tyre e lehtëson të kuptuarit më “të hollë” të fjalëve.⁹ Gjithashtu psikolinguistët kanë vërtetuar se në gjuhën figurative përfshihen të njëjtat operacione gjuhësore si në gjuhën e zakonshme.

Psikolinguistët Lakoff dhe Johnson e vështrojnë dhe e kategorizojnë metaforën si një sistem konceptual, sipas të cilit çdokush prej nesh e ka të njohur metaforën dhe udhëhiqet prej saj. Metafora nuk na udhëheq vetëm nga ana gjuhësore, por gjithashtu nëpërmjet saj e perceptojmë përditshmërinë tonë, gjatë të menduarit apo të vepruarit.¹⁰ Metaforën konceptuale, studiuesit e ndajnë në disa lloje: metaforë strukturore, orientuese dhe ontologjike. Nëpërmjet metaforës strukturore një koncept abstrakt perceptohet dhe strukturohet

⁹ LAKOFF G./JOHNSON M. (2014): *Leben in Metaphern. Konstruktion und Gebrauch von Sprachbildern*. Heidelberg, f.8

¹⁰ LAKOFF G./ JOHNSON M. (2014): *Leben in Metaphern. Konstruktion und Gebrauch von Sprachbildern*. Heidelberg. f. 11

nëpërmjet një koncepti tjetër të ngjashëm me të, por që ka natyrë konkrete, pra që haset me shpesh në të përditshme dhe është më i kuptueshëm për njeriun (p.sh. jeta perceptohet si rrugëtim, ose koha perceptohet si dhe përkthehet në para “Koha është flori”). Me metaforë të orientimit do të kuptojmë, sesi konceptet e drejtimit apo të orientimit, të vendosura përballë njëra tjetrës në një relacion simbolik, atë të vendndodhjes, na japin pikërisht gjendjen apo përjetimin emocional të cilin ndjejmë. Dikotomitë si p.sh: poshtë-lart, para-mbrapa, thellësi-sipërfaqe, qendër-periferi etj.¹¹ simbolizojnë gjendjen emocionale dhe se kur identifikimi bëhet sipas ngjashmërisë, pra kur predikati shënon një tipar të përbashkët për të dyja anët atëherë kemi metaforën. Në analizë do të trajtohen edhe dy koncepte të metaforës së orientimit; lartë – poshtë, ku të qenit i lumtur apo entuziast është lartë dhe të qenit i mërzitur ose pesimist është poshtë.

Po japim disa shembuj të metaforave konceptuale duke filluar me rastin e **metaforës strukturore**:

DEBATI/ PERBALLJA është LUFTË¹²

Sipas Lakoff dhe Johnson duke nisur që nga koha e luftimeve midis vendeve dhe nga koncepti “luftë” në kuptimin e parë të fjalës, truri i percepton dhe i shpreh me të njëjtat fjalë përshkrimet në fushat e ndryshme përkatëse, fjalë që i referohen konceptit “luftë” edhe në ditët e sotme. Pikërisht edhe në gjuhën e shkruar apo të folur në sport dhe artikujt sportiv, në komentimin e një loje futbollit shprehen fjalë, si: ndeshje, (kundërsulm) sulm, strategji, mundje, goditje, mbrojtje, gjuajtje. Do të thotë sa herë shihen dy ose më shumë palë kundërshtarë, truri e percepton ngjarjen si një luftë dhe i aktivizon të njëjtat fjalë si në përshkrimin e një beteje të vërtetë mes ushtrive.

“Jam përpjekur të përqendrohem për finalen, sepse ishte një **ndeshje** futboll që **donim ta fitonim**. E kemi përgatitur **ndeshjen** gjatë gjithë javës. Pjesa e parë nuk funksionoi mirë, por kjo nuk ka rëndësi. Ky ekip vazhdon gjithmonë përpara. U duhet të shënojnë gola për të na **mundur**, përndryshe ndodh e kundërta“, ka deklaruar Toni Kros.

(Sportexpress Online, Champion League BVB – Real Madrid, 01.06.2024)

“Partizani-Elbasani, **‘lufta’** për “Final 4” dhe milionat e Europës”

(Panorama Sport, fl.3, 26-27.04.2025)

¹¹ LAKOFF G./ JOHNSON M. (2014): Leben in Metaphern. Konstruktion und Gebrauch von Sprachbildern. Heidelberg, f.22

¹² Po aplikojmë këtu shkrimin me germa kapitale të emërtimeve të koncepteve metaforike në përputhje me traditën e deritanishme të studimeve të gjuhësisë konjitive.

“Skënderbeu –Bylisi, **duel për mbijetesë...**”

(Panorama SPORT, fq.7, 26-27.04.2025)

Në shembujt e mësipërme nga artikujt sportivë në gjuhën gjermane dhe shqipe del në pah, ajo që Lakoff dhe Johnson mbrojnë në hulumtimin e tyre, se nëpërmjet metaforave dhe figurshmërisë konceptualizohen dhe konkretizohen ndërhyrje gjuhësore si në gjuhën e zakonshme. Metaforat e përdorura më sipër kanë një ngarkesë dhe ngjyrim duke na sjellë kështu një paralelizëm, atë të fitores dhe humbjes së luftës historike dhe asaj të luftës në “fushë”.

Metafora orientuese:

I LUMTUR është LART

„Leipzig **grüßt von der Spitze**, der BVB implodiert“ – “Lajpcigu përshëndet nga lart, maja, ndërsa BVB shkatërrohet “

(Spiegel Sport.de, 26.10.2024)

Në shembullin e gjuhës gjermane të shkëputur nga artikujt e gazetave sportive, për të shprehur lumturinë apo të qenurit i lumtur dhe entuziast, është shprehur pikërisht nëpërmjet metaforave, të cila japin shprehinë dhe ngarkesën e duhur të emocionit. Ajo çka mund të konstatohet lehtë, është përdorimi i shprehjes *maja dhe lart*, të cilat identifikohen dhe asociohen me idenë, se kur je *lart* apo në *majë* ndihesh mirë, i lumtur dhe je i entuziazmuar sepse qëndron *mbi*.

“Për mua në qoftë se **duam të rrimë në maja**, çdo gjë duhet të shkojë më se miri.”

(Trajneri i Vllaznisë, Thomas Berdaric, 26.10.2024)

Edhe në shembullin e gjuhës shqipe vërehet përdorimi i shprehjes *të rrimë në maja*, e cila bart dy kuptime të rëndësishme, i pari nënkupton të jesh mbi të tjerët dhe së dyti, është arritur qëllimi dhe rrjedhimisht ndihet gëzimi apo lumturia si emocion.

“Duhet të **qëndrojmë me kokën lart** dhe të punojmë.”

(Ish-Futbollisti, Nevil Dede, 20.10.2024)

Në titullin e mësipërm vërehet sesi shprehja *të qëndrojmë me kokën lart* prek një aspekt shumë të rëndësishëm kulturor për gjuhën dhe vendin tonë. Ky aspekt lidhet me krenarinë, që kjo shprehje mbart në një kontekst të parë kuptimor, gjithashtu se duke qenë krenar ndihesh i lumtur dhe entuziast për

qëllimin apo rezultatin që do të arrish.

I MËRZITUR është POSHTË

“Shtyhet ndeshja Bolonja-Milan, presidenti Skaroni: **Kokulur** para një urdhri të prerë”

(Panorama Sport Online, President Skaroni, 27.10.2024)

Përsa i përket konceptit *poshtë*, nga të dyja gjuhët si në shqip ashtu dhe në gjermanisht shprehet nëpërmjet kompozitës, si p.sh: *kokulur* duke konceptualizuar ndjesinë e mërzisë, si pasojë e një urdhri të dhënë. Nëse vijojmë ta shtjellojmë më tej, do të shohim sesi pozicionimi *koka ulur* bart figurshmërinë dhe simbolikën e të ndjerit i mërzitur.

„Barça hat etwas geschafft, das nur wenigen Mannschaften gelingt: die Bayern dazu zu bringen, **die Arme zu senken**.“ – Barça arriti diçka, që shumë skuadra të tjera nuk e arrijnë dot: **të detyroj Bayern-in të uli krahët**.

(Sportbild, 24.10.2024)

Për gjuhën gjermane po analizojmë, sesi shprehja frazeologjike bart jo një, por nënkupton dhe një konotacion të dytë përsa i përket emocionit shprehës. Shprehja *ul krahët* do të simbolizojë të kundërtën e asaj që shprehim kur jeni të lumtur, pra themi ngre krahët nga lumturia, edhe për ta vijuar më tej mund të reagojmë me thirrje apo me lëvizje, *ngre krahët* nga lumturia. Në momentin që ndodh ose shohim diçka kur jemi me krah lart nga lumturia, direkt në mënyrë instiktive nga ndjesia e emocionit që po përjetojmë, atë të mërzisë, ulim krahët si shenjë pesimizmi apo trishtimi. Në shembullin e mësipërm, midis dy skuadrave, njëra në mënyrë të papritur triumfon, ndërkohë që tjetra deri para pak atij momenti ishte triumfuese dhe *krahë lart*, derisa kuptoi që po ndodhte e kundërta. Me shprehjen *ul krahët*, nëse do ta përkthejmë dhe e përshtatim sipas shqipes, do të thotë bëj armëpushim, e pranoj gjendjen që jam. Në tërësi të gjithë analizës konstatojmë me *krahët ulur* simbolika e metaforës dhe konceptualitetit të orientimit gjen përputhshmëri për të dyja gjuhët.

Përfundime

Në këtë artikull kemi shqyrtuar emocionalitetin e artikujve të gazetave sportive në platformat digjitale për të dyja gjuhët, atë të shqipes dhe të gjermanishtes. Nga sa më sipër, rezultoi për të dyja gjuhët se metafora është

një nga figurat më të përdorura për të shprehur dhe përshkruar më së miri emocionet. Duke analizuar dhe shtjelluar teorinë e gjuhëtarëve Lakoff dhe Johnsson, doli në pah se për të dyja gjuhët gjenden të përbashkëta në shprehinë e emocionalitetit në komunikimin verbal, pikërisht nëpërmjet metaforës konceptuale dhe specifikisht metaforës orientuese dhe asaj strukturore. Por nga ana tjetër, shumë shprehje nga ato që u shqyrtuan në gjuhën shqipe dhe gjermane gjejnë ekuivalencë të pjesshme, pasi vërehen ndryshime në aspektin kulturor që secila gjuhë përfaqëson. Ajo çka vihet re në shembujt e analizuar, është se kontekstet kulturore për gjuhët përkatëse shprehin emocione të njëjta apo të ngjashme, por me shprehje të ndryshme. Në gjuhën gjermane dalin në pah shprehje, ku përshkruhen emocione për të ruajtur gjithmonë suksesin e arrirë, ndërsa në gjuhën shqipe emocionet e përshkruara shprehin sesi të shkosh drejt rezultatit apo synimit. Kjo lidhet ngushtësisht me historinë sportive, që trashëgojnë vendet e të dyja gjuhëve, njëri ka vendosur themelet e suksesit sportiv prej shumë dekadash dhe tjetri në vijim, gjithmonë e më shumë po zhvillohet. Së fundmi, nga analiza e studimit krahasues u konstatua roli themelor i njësive frazeologjike për shprehjen e emocioneve në shqip dhe në gjermanisht, duke na vërtetuar se kryesisht frazemat somatike janë ato që i shprehin dhe i transmetojnë më së miri emocionet e ngjarjeve sportive të përshkruara në rubrikat përkatëse të gazetave.

BIBLIOGRAFIA

- DARWIN C. (2000/1872), *Der Ausdruck der Gemütsbewegungen bei dem Menschen und den Tieren. Kritische Edition, Einleitung, Nachwort und Kommentar von Paul Ekman*. Frankfurt am Main, Eichborn.
- EKMAN P. /SALISCH M. von Hg. (1988), *Gesichtsausdruck und Gefühl. 20 Jahre Forschung von Paul Ekman*, Paderborn:Junfermann

GEBAUER G, HOLODYSKI M, KOELSCH S von SCHEVE C (2017), Einleitung: *Von der Emotion zur Sprache*. In: Gunter Gebauer, Manfred Holodyski, Stefan Koelsch, Christian von Scheve (Hrsg.), *Von der Emotion zur Sprache. Wie wir lernen, über Gefühle zu sprechen*, Velbrück Wissenschaft. 10, f.7–16.

HARTMANN M. (2015), *Gefühle. Wie die Wissenschaftler sie erklären*. Frankfurt a.M: Campus

IBRAHIMI M. (2011), *Frazemat somatike bazuar në gjeste dhe mimikë, si burim i frazeologjisë së Jani Thomai*. Botim i posaçëm i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë

KROHN K. (1994), Hand und Fuß. Eine kontrastive Analyse von Phraseologismen im Deutschen und Schwedischen. Acta Universitatis Gothoburgensis. Surte.

LAKOFF G./JOHNSON M. (2014), *Leben in Metaphern. Konstruktion und Gebrauch von Sprachbildern*. Heidelberg.

LUASBERG H. (1960), *Handbuch der literarischen Rhetorik. Eine Grundlegung der Literaturwissenschaft*. 2Bde. München: Hueber

MEMA, V. (2025), “*Partizani-Elbasani, lufta për Final 4 dhe milionat e Euopës*”, Panorama Sport, 26-27 Prill, f.2-3

MOSTÝN M.(2010) *Fußball und Emotionen: Dargestellt an Internetkommentaren*. In: Acta Facultatis Philosophicae Universitatis Ostraviensis. Studia Germanistica. Nr. 7, f.49–68

SADIKAJ S.(2010), *Metaphorische Konzepte in somatischen Phraseologismen des Deutschen und Albanischen. Eine kontrastive Untersuchung anhand von Herz- und Hand-Somatismen*. Würzburg

SADIKU M, &HAMITI, V. (2021), *Balkanphraseologie im Kontrast. Am Beispiel der Somatismen mit der Komponente KOPF im Albanischen, Bosnischen/Kroatischen/Serbischen und Mazedonischen*. Zeitschrift für Balkanologie, f.57

SARO, LI. (2025), “*Skënderbeu-Bylisi, duel për mbijetesë deri në frymën e fundit*”, Panorama Sport, 26-27 Prill, f.6-7

[https://www.panorama.com.al/sport/trajneri-i-real-madrid-karlo-anceloti-jemi-kaq-afer-me-trofeun-sage-e-kemi-frike/\(01.06.2024\)](https://www.panorama.com.al/sport/trajneri-i-real-madrid-karlo-anceloti-jemi-kaq-afer-me-trofeun-sage-e-kemi-frike/(01.06.2024))

<https://sportbild.bild.de/fussball/internationaler-fussball/europa-league-ex-bvb-star-aubameyang-bricht-in-traenen-aus-663de85f1da8c1482bfaf87a> (10.05.2024)

https://www.panorama.com.al/sport/barazimi-ndaj-partizanit-trajneri-brdaric-pesojme-gola-te-thjeshte-gjithe-puna-shkon-dem-nese/?fbclid=IwY2xjawGpiO1leHRuA2FlbQIxMAABHBw7fDnDIdyKs5kv7GmK2kNLxah-FMnrwq0jR4ssTVrJRK2eMLcKGrL6DA_aem_yKh_PLtj5KJa44OMSV2PwA (26.10.2024)

https://sportekspres.com/te-rrime-me-koken-larte-humbja-me-skenderbeun-nevil-dede-eshte-vetem-nje-problem-psikologjik/?fbclid=IwY2xjawGplGpleHRuA2FlbQIxMAABHYjUzLr-nJmUyMZBP0qif0zGRwimkJIY_QstlpGd_tgjcEtldmIqo7qdgg_aem_CH7wgUKSkQPdjySg03YjUw (20.10.2024)

https://www.panorama.com.al/sport/trajneri-i-lacit-cunat-dhane-zemren-ne-fushe-ja-kush-eshte-mentaliteti-yne/?fbclid=IwY2xjawGpkjlleHRuA2FlbQIxMAABHaT9LBLcmr8CsOmE3pvZN4PnJMXXU6XaIYAe0UDmOZPtQdXXbfKU04y0Lg_aem_

EKw5bgW4VXNDkihNoITg6A (26.10.2024)

https://sportekspres.com/video-milani-tregon-dhembet-ne-europe-hedh-njeren-kembe-ne-fazen-tjeter/?fbclid=IwY2xjawGU6lZleHRuA2FlbQIxMAABHdKp1516B43cxRTFromsMKp-Ch6CZIJEWHkeDL-5QAXEyM5Y_w-XaeAbPQ_aem_Di0eJqk0P_R3VuSFCLY17Q (15.02.2024)

https://sportbild.bild.de/fussball/nationalmannschaft/dfb-tor-baumann-oder-nuebel-nagelsmann-verraet-wer-die-nase-vorn-hat-670e1b933e343a712d386519?fbclid=IwY2xjawGU6exleHRuA2FlbQIxMAABHbu0eMr0YhZA_igJ6b1w4MiMCbiU4TtXmdw52GeNR8a5dRDbvmpZaVi5gQ_aem_ZG40PZPP7tGQo_VQgZLgTw (15.10.2024)

https://www.panorama.com.al/sport/shtyhet-ndeshja-bolonja-milan-presidenti-skaroni-kokulur-para-nje-urdhri-te-prere/?fbclid=IwY2xjawGph7NleHRuA2FlbQIxMAABHbw7fDnDIdyKs5kv7GmK2kNLxah-FMNrwq0JR4ssTVrJRK2eMLcKGrL6DA_aem_yKh_PLtj5KJa44OMSV2PwA (27.10.2024)

https://sportbild.bild.de/fussball/champions-league/pressestimmen-zu-bayern-pleite-gegen-barca-raphinhas-gift-toetet-bayern-harry-pain-6719d47ba0e636753eda89c6?fbclid=IwY2xjawGtZjFleHRuA2FlbQIxMAAB-HZVtNCVhRQK3czImZ1xa7nZpWwLM2eHEfdvbXABMXZQYaLaaLjx8SC7P3Q_aem_9wmjcyzfr8_HD5zi0GXlw (24.10.2024)

https://www.spiegel.de/sport/fussball/bundesliga-rb-leipzig-erobert-tabellenspitze-der-bvb-implodiert-a-0fe8c36c-e70a-46fb-9b21-d3c9c915c31d?fbclid=IwY2xjawGU6alleHRuA2FlbQIxMAABHTEaU3sLle7GXY7PSIKgHdt9Ft_cuAZQFnNQcowZQNSL7Uazt5GNcclbXQ_aem_P3C6312TqOM3eom6kuhM9Q (26.10.2024)

https://www.sport.de/news/ne7207310/union-berlin--zu-wenig-khedira-und-svensson-legen-finger-in-die-wunde/?fbclid=IwY2xjawGU8vJleHRuA2FlbQIxMAABHcQoDjKpjkk4dOst1OKZHqQdipvQGUMxxcAfkNXXDveraaMxo1GFUt9aT0w_aem_eCnm41OSjTeWPkQWSSRUpw (31.10.2024)

<https://www.panorama.com.al/sport/video-levizjet-dehese-te-ernest-mucit-faqja-zyrtare-e-europa-league-mahnitet-nga-klasi-i-talentit-shqiptar/> (23.01.2025)

<https://www.spiegel.de/sport/fussball/2-bundesliga-1-fc-nuernberg-siegt-ueberraschend-gegen-fc-kaiserslautern-a-7b6897d7-8a6c-4852-a81f-4679e9fc6504> (12.04.2025)

<https://sportbild.bild.de/fussball/champions-league/presse-rechnet-mit-barca-ab-barca-ueberlebt-die-hoelle-panikattacke-in-dortmund-67ff3da03ceb7108c4933dc6> (16.04.2025)

<https://www.sport.de/news/ne7712555/eintracht-frankfurt-will-gegen-rb-leipzig-riesigen-schritt-machen/> (25.04.2025)

<https://www.panorama.com.al/sport/lexoni-faqen-e-pare-te-gazetes-panorama-sport-dhe-panorama-670/> (26.05.2025)

<https://www.panorama.com.al/sport/video-fitore-me-aro3me-titulli-napoli-i-le-targen-interit-lece-i-merr-1-pike-atalantes/> (27.04.2025)

LEGJISLACIONI EUROPIAN PËR TË DREJTAT GJUHËSORE TË PAKICAVE DHE KUADRI LIGJOR I ARSIMIT NË MINORITETIN ETNIK GREK PAS VITEVE 1990

Doktorante Donika Boboli

Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qyteterimit Grek
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore
Universiteti «Eqrem Çabej», Gjirokastrë
E-mail: dboboli@uogj.edu.al

Prof. Asoc. Dr. Eda Shehu

Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike
Dega e Gjuhës Ruse
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: eda.shehu@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim vështrohen të Drejtat Gjuhësore të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri, të cilat zënë një vend të rëndësishëm ndër të drejtat e minoriteteve dhe nuk mund të kuptohen jashtë legjislacionit ndërkombëtar dhe atij evropian. Gjuha si elementi themelor për një minoritet është jo vetëm mjet i shprehjes dhe i krijimit të kulturës së tij, por përbën dhe tiparin më të rëndësishëm, që e dallon një minoritet nga shumica ose nga pakicat e tjera. Përdorimi i gjuhës amtare nga anëtarët e minoritetit, veçanërisht në arsim, është një e drejtë elementare gjuhësore e njeriut, e cila garantohet me konventa ndërkombëtare, dhe tekste ligjore të organizatave ndërkombëtare. Punimi në fjalë nxjerrë në pah se ky aspekt është vendimtar për integrimin social dhe kulturor të këtyre pakicave etnike dhe mbetet i garantuar nga një kornizë e gjerë ligjore ndërkombëtare. Prandaj, është thelbësore që të vazhdojnë përpjekjet për të siguruar zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, në mënyrë që minoritetet të mund të ushtrojnë lirisht gjuhën dhe kulturën e tyre, duke ndikuar pozitivisht në bashkëjetesën shoqërore dhe në diversitetin kulturor të shoqërive moderne.

Fjalët çelës: e drejta evropiane, të drejtat gjuhësore, minoriteti etnik grek.

ABSTRACT

This paper examines the linguistic rights of the Greek ethnic minority in Albania, which occupy a significant place among minority rights and cannot be understood outside the context of international and European legislation. Language, as a fundamental element of any minority, is not only a means of expression and cultural creation but also the most defining feature that distinguishes a minority from the majority or other minority groups. The use of the mother tongue by members of a minority—especially

in education—is a fundamental linguistic human right, safeguarded by international conventions and legal instruments of international organizations. This study highlights the fact that this aspect is crucial for the social and cultural integration of these ethnic minorities and is protected by a broad international legal framework. Therefore, continued efforts are essential to ensure the practical implementation of these rights, so that minorities can freely exercise their language and culture, thus contributing positively to social coexistence and the cultural diversity of modern societies.

Keywords: European law, Greek Ethnic Minority, linguistic rights.

Hyrje

Të drejtat gjuhësore zënë një vend të rëndësishëm ndër të drejtat e minoriteteve dhe nuk mund të kuptohen jashtë legjislacionit ndërkombëtar dhe atij europian. Gjuha është elementi themelor për një minoritet. Ajo është jo vetëm mjet i shprehjes dhe i krijimit të kulturës së tij, por përbën dhe tiparin më të rëndësishëm, që e dallon këtë minoritet nga shumica, ose nga pakicat e tjera. Përdorimi i gjuhës amtare nga anëtarët e minoritetit, veçanërisht në arsim, është një e drejtë elementare gjuhësore e njeriut, e cila garantohet me konventa ndërkombëtare dhe normativë ligjore të organizatave ndërkombëtare. Liria e shprehjes gjuhësore është e lidhur me arsimin dhe kulturën, ku efektet e saj reflektohen në jetën e grupeve minoritare.

Të drejtat gjuhësore janë të lidhura me strategjitë politike, qëndrimet, ideologjitë dhe vendimet e qeverive. Këto të drejta janë kolektive forcohen dhe konsolidohen në varësi të klimës politike dhe sociale të kohës.

Të drejtat gjuhësore janë çështje politike që janë përdorur nga shumë institucione dhe shtete për të promovuar politikën dhe strategjitë e të fuqishmëve në një zonë të caktuar gjeografike. Në këtë logjikë, ato mund të përdoren si arsye për të mbrojtur një pakicë etnike ose gjuhësore, duke eliminuar ose kufizuar fuqinë politike të një grupi tjetër etnik (Tsitselikis, 1996). Si të drejta kolektive, këto të drejta u bënë objekt ligjor i mbrojtjes nga Lidhja e Kombeve në periudhën ndërmjet viteve 1920-1940, organizatë kjo, e krijuar për të mbrojtur dhe për të gjetur zgjidhje paqësore ndaj problemeve që lindnin, duke u zëvendësuar më vonë me të drejtat individuale të njeriut nën mbrojtjen e OKB-së (nga viti 1948 e deri më sot). Të drejtat gjuhësore si të drejta kolektive të mbrojtjes u rikthyen në vitet 1990 me promovimin e deklaratave, planeve dhe kartave nga organizatat ndërkombëtare (OKB, UNESCO, etj.), të cilat janë

nënshkruar edhe nga Shqipëria.

Kjo trajtesë është produkt i reflektimeve personale dhe përpjekjeve hulumtuese dhe synon të njohë lexuesin me çështje të zhvillimit të arsimit minoritar në periudha të ndryshme kohore, ku të nxjerrë në pah përpjekjet e minoritetit dhe komunitetit arsimor për arsimin në gjuhën amtare, si dhe strategji politike të zbatuara nga qeveritë shqiptare.

Metodologjia

Për studimin e kësaj teme, përsa i përket pjesës teorike u shfrytëzuan materiale nga literatura greke dhe shqiptare, u përdorën arkivat publike brenda dhe jashtë Shqipërisë, faqet e internetit, u morën si referencë materiale të organizatave, shoqatave ndërkombëtare, si dhe u morën në pyetje individë të ndryshëm. Gjatë kërkimit të burimeve arkivore dhe literaturës së botuar, u konstatuan informacione të rëndësishme të pashfrytëzuara deri më tani, të cilat i japin vlerë të veçantë punimit tonë. Në këtë trajtesë është përdorur *metoda e analizës së përmbajtjes*.

1. Legjislacioni shqiptar për të drejtat gjuhësore të pakicave

Shqipëria u anëtarësua në Lidhjen e Kombeve gjatë seancës së 28-të të Asamblesë së Përgjithshme më 17.12.1920. Me anëtarësimin e Shqipërisë lidhet edhe sigurimi i statusit ligjor i të drejtave të minoritetit grek dhe funksionimi i shkollave greke në Shqipëri. Me hyrjen në organizatën ndërkombëtare, Shqipëria, si të gjitha shtetet, duhej të miratonte dhe të nënshkruante një kuadër specifik angazhimesh për të drejtat e minoriteteve. Një deklaratë të tillë Shqipëria e nënshkroi më 02.10.1921. Ndër parimet që Asambleja e Përgjithshme e Lidhjes së Kombeve i kërkoi Shqipërisë ishte detyrimi për të garantuar fuqinë kushtetuese në traktatin për mbrojtjen e pakicave, për t'u dhënë shtetësi të gjithë personave që kanë lindur në vend, për të garantuar barazinë e të drejtave civile dhe politike, mbrojtjen e jetës, lirisë dhe adhurimit fetar të të gjithë qytetarëve pa përjashtim, përdorimin e lirë të gjuhës së pakicave, themelimin e lirë të institucioneve fetare dhe shkollave në gjuhën e pakicës dhe

rrjedhën proporcionale të burimeve kombëtare për zonat minoritare.¹

Përfshirja e Shqipërisë në bllokun komunist menjëherë pas Luftës bëri që çështja e të drejtave të pakicave dhe lirive themelore të njeriut të kalojnë në një fazë të errët.

Legjislacioni ndërkombëtar i pasluftës për të drejtat e minoriteteve fillon me Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila më 10.12.1948, nxori dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, me parimin kryesor: « *njohja e dinjitetit të lindur të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë*». Neni 2 i kësaj deklarate: « *Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë, pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër*» dhe neni 26.2., « *Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve*» janë më të rëndësishmet mbi të drejtat e minoritetit.²

Dy dekada më vonë më 16.12.1966 Shqipëria nënshkroi «Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike»³, i cili u hartua me synim respektimin e të drejtave qytetare dhe politike. Ky Pakt i dha rëndësi jo vetëm individit, i cili « *..... ka detyra ndaj të tjerëve dhe ndaj kolektivitetit të cilit i përket dhe se ai është përgjegjës për t'i nxitur dhe respektuar të drejtat e njohura në këtë Pakt*». Në lidhje me të drejtat gjuhësore të pakicave në nenin 27 thuhet: « *Në shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare ose gjuhësore, personat që u përkasin këtyre pakicave nuk duhet të privohen nga e drejta që të kenë, sëbashku me pjesëtarët e tjerë të grupit të vet, jetën e vet të veçantë kulturore, të predikojnë dhe të praktikojnë fenë e tyre ose të përdorin gjuhën e tyre*».

Në Kartën e Helsinkit të vitit 1975 si një nga dokumentet themelore për të drejtat e pakicave në parimin e shtatë të saj deklarohet se⁴« *Shtetet pjesëmarrëse në territorin e të cilëve ekzistojnë pakica kombëtare do të respektojnë të drejtën*

¹ MANDAE,(2010), Arsimi i Minoritetit Grek në Shqipëri gjatë Mesluftës,Selanik, faqe 18.

² https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf

³ <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>

⁴ <https://www.osce.org/files/f/documents/5/c/39501.pdf>

e personave, që u përkasin këtyre pakicave për të qenë të barabartë para ligjit, do t'u ofrojnë atyre mundësinë e plotë për të gëzuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në këtë mënyrë do të mbrojnë interesat e tyre legjitime në këtë fushë».

Vendosja e sistemit pluralist më vitin 1991 dhe shembja e regjimit komunist sollën një përmbysje në fushën e të drejtave të pakicave. Në hartimin e legjislacionit të saj Shqipëria demokratike zotohet për t'ju përmbajtur standardeve europiane për të drejtat e njeriut.

Një nga dokumentet themelore të OKB-së për të drejtat e njeriut, e cila u miratua nga Asambleja e Përgjithshme në dhjetor të vitit 1992 është «Deklarata mbi të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore»⁵. Në nenin 2.1 thuhet: «*Personat që u përkasin pakicave kombëtare, ose etnike, fetare dhe gjuhësore kanë të drejtë të gëzojnë kulturën e tyre, të shpallin dhe praktikojnë fenë e tyre dhe të përdorin gjuhën e tyre, privatisht dhe publikisht, lirisht dhe pa ndërhyrje, apo çfarëdo forme diskriminimi*».

Të drejtat që lidhen me diversitetin gjuhësor të folësve ndahen në dy kategori: së pari, të drejta që lidhen me *procesin arsimor* (e drejta për të krijuar shkolla, për të mësuar në gjuhën amtare), së dyti, të drejtat që lidhen me *përdorimin e gjuhës* (e drejta për përdorimin e lirë të gjuhës së pakicës në mënyrë private dhe publike, për ta përdorur atë gjatë transaksioneve me autoritetet dhe gjykatat, regjistrimin e emrave dhe toponimeve në gjuhën e pakicës, etj.). Këto zhvillime tregojnë rëndësinë që legjislacioni evropian i jep promovimit të dallimeve gjuhësore si një element themelor i kulturës evropiane⁶.

Një dokument i rëndësishëm evropian për të drejtat e pakicave është⁷ «Konventa – kuadër për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare» e Këshillit të Europës, që u nënshkrua nga Republika e Shqipërisë më datë 29. 06. 1995 dhe hyri në fuqi më datë 01.01.2000. Përbën konsideratën më bashkëkohore të të drejtave të pakicave kombëtare, duke pasur parasysh se në një shoqëri pluraliste dhe vërtet demokratike ajo duhet jo vetëm të respektojë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo personi që i përket një pakice kombëtare, por edhe të krijojë kushte që lejojnë shprehjen, ruajtjen dhe zhvillimin e këtij

⁵<https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-rights-persons-belonging-national-or-ethnic>

⁶ CICELIQIS K., (2001), Mbrojtja e gjuhëve të pakicave, Udhëzues Enciklopedik, marrë nga: language.gr/greekLang/studies/guide/thema_c5/index.html 27/10/2017.

⁷ <https://rm.coe.int/16800c1303>

identiteti. Në nenin 1 thuhet: “*Mbrojtja e pakicave kombëtare dhe e të drejtave dhe lirive të personave që u përkasin këtyre pakicave është pjesë përbërëse e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe, si e tillë, hyn në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar*”.

Të drejtat gjuhësore mishërohen plotësisht në «Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave», e cila u miratua nga Këshilli i Europës në Strasburg, më datë 05. 11. 1992 dhe hyri në fuqi në vitin 1995.

Qëllimi kryesor i Kartës është *mbrojtja e gjuhëve historike rajonale ose e pakicës në Evropë, disa prej të cilave janë në rrezik të zhdukjes së mundshme, duke kontribuar në ruajtjen dhe në zhvillimin e pasurisë dhe të traditave kulturore të Evropës*.

Lidhur me arsimin, në Nenin 8 (pika i), Karta parashikon që në territorin ku përdoren këto gjuhë, varësisht nga gjendja e secilës prej këtyre gjuhëve dhe pa e dëmtuar mësimin e gjuhës (gjuhëve) zyrtare të shtetit, palët angazhohen: a. i. *ta bëjnë të mundur arsimin parashkollor në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; c. i. ta mundësojnë arsimin e mesëm në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; e. i. ta bëjnë të mundur arsimin universitar dhe arsimin tjetër të lartë në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicës; g. të marrin masa për të siguruar të mësuarit e historisë dhe të kulturës e cila pasqyrohet nga gjuha rajonale ose e pakicës*. Gjithashtu, Karta përmban nene lidhur me përdorimin e gjuhës së pakicës në proceset gjyqësore (Neni 9), në administratë dhe shërbimet publike (Neni 10), në mjetet e komunikimit (Neni 11), në aktivitetet dhe objektet kulturore (Neni 12), në aktivitetet ekonomike dhe shoqërore (Neni 13), në shkëmbimet ndërkufitare (Neni 14) ⁸ etj.

Njohja formale e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, u sanksionua me ligjin nr. 96/2017 «Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë»⁹ në Nenin 3, pika 1, 2 parashikohet: *1. Pakicë kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar*

⁸ https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/AEuropean_Charter_for_Regional_or_Minority_Languages.pdf

⁹ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>

së bashku identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. 2. Në kuptimin e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

Kurse në Nenin 13, pika 1, 2 sanksionohet e drejta e arsimit në gjuhën e pakicës: 1. *Personat, që i përkasin një pakice kombëtare, gëzojnë të drejtën të mësojnë gjuhën e pakicës. 2. Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ato banojnë tradicionalisht, ose në numër thelbësor, nëse ka kërkesë të mjaftueshme u sigurohen mundësi për të mësuar, ose për të marrë mësim në gjuhën e pakicës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.*

2. Kuadri ligjor i arsimit në Minoritetin Etnik Grek pas viteve 1990

Rënia e regjimit diktatorial në vitin 1991, ishte vendimtare për historinë moderne të Shqipërisë, ku vendi hyri në një proces të gjatë demokratizimi dhe integrimi ndërkombëtar. Në hartimin e legjislacionit të saj Shqipëria zotohet t'u përmbahet standardeve europiane për të drejtat themelore të pakicave, fakt që mishërohet qysh në Dispozitat Kushtetuese të Prillit të vitit 1991, në Nenin 4 të saj¹⁰ «Republika e Shqipërisë njeh dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të pakicave kombëtare, të pranuara në dokumentet ndërkombëtare».

Me dispozitat Kushtetuese statusi i pakicave ngrihet në një shkallë më të lartë. Për herë të parë garantohen të drejtat themelore dhe liritë jo vetëm të individit, por edhe të pakicave etnike. Përsa u përket të drejtave gjuhësore, e reja e kësaj kushtetute është se u njihet fëmijëve minoritarë e drejta «të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare», që do të thotë se gjuha e tyre amtare do të përdoret edhe si mjet për përfitimin e njohurive të reja.¹¹

Në fillim të vitit shkollor 1991-1992, mësuesit e minoritetit grek ndërmorën një grevë pesëmbëdhjetë ditore me katër kërkesa kryesore:

1. Zhvillimi në shkollat e minoritetit të të gjitha mësimëve vetëm në gjuhën amtare;

¹⁰ Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991, për dispozitat kryesore kushtetuese.

¹¹ MEMUSHI R., Legjislacioni për gjuhët e pakicave, Kërkime Universitare, Universiteti i Gjirokastrës, 2001.

2. Hapja e shkollave greke në fshatrat me popullsi të përzier, të cilat u krijuan gjatë regjimit komunist;

3. Hapja e shkollave greke në qendrat urbane, ku jetonin anëtarë të minoritetit etnik grek dhe plotësimi i kushteve;

4. Mësimdhënia e Historisë dhe Gjeografisë së Greqisë në shkollat minoritare;

Në shtator të vitit 1991 doli udhëzimi i parë, i cili në thelb përbënte përpjekjen e parë për të rregulluar statusin e funksionimit të arsimit të minoritetit. Sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.17, datë 27.09.1991, gjuha greke njihet si gjuha e mësimdhënies, në shkollat e minoritetit, në të gjitha klasat e ciklit tetëvjeçar për të gjitha lëndët e parashikuara, si dhe në programin arsimor të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, ndërsa shqipja do të mësohej si gjuhë e huaj. Në kopshtet shtetërore u deklarua përdorimi i gjuhës amtare të fëmijëve. Fshatrat me popullsi të përzier që ishin krijuar gjatë sistemit komunist në zonat minoritare kishin të drejtë të hapnin shkollë në gjuhën amtare.

Ky dekret sanksionoi gjuhën amtare të minoritetit në arsimin parashkollor dhe atë të detyrueshëm dhe krijoi një klimë optimizmi në minoritetin grek për mësimdhënien e greqishtes në shkollat e mesme dhe ciklet e larta arsimore, krahas funksionimit të Akademisë Pedagogjike të Gjirokastrës, ku u ndërmor hapi i parë për përmirësimin e situatës në krahasim me të kaluarën. Në qendrat e mëdha urbane, ku kishte një numër të konsiderueshëm nxënësish me origjinë greke dy kërkesat e tjera për funksionimin e shkollave greke, nuk u pranuan. Gjithashtu, nuk u lejua në to, as mësimdhënia e Historisë dhe Gjeografisë së Greqisë.

Gjatë vitit shkollor 1991-1992, shkollat greke funksiononin në Sarandë, Gjirokastrë, Ksamil dhe Delvinë, pas përpjekjeve të vazhdueshme të Këshillit të Prefekturave, i vetmi organ kompetent për funksionimin e një shkolle në përputhje me legjislacionin. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 2618, datë 12.10.1992, drejtuar Kryesisë së Këshillit të rrethit Sarandë (të cilin e konsideronte përgjegjës për shtrembërim të udhëzimit nr. 17, datë 27.09.1991), u mbyllën shkollat në gjuhën greke në Ksamil dhe në qytetin e Sarandës me justifikimin, se nuk u përkasin zonave të mirëfillta minoritare. Këshilli i Prefekturës dhe Shoqata e Prindërve të nxënësve protestuan për mbylljen e shkollave. Gjithashtu, Ministria e Arsimit me vendimin nr. 4609/1, datë 17.09.1993, refuzoi hapjen e shkollës greke në qytetin e Gjirokastrës pas kërkesës të banorëve të qytetit. Gjatë kësaj periudhe, përgjegjësia ekskluzive për hapjen e shkollave i kaloi nga pushtetit vendor, që sipas ligjit të vitit 1981 ishte Këshilli i Qarkut, me vendim të KM nr.

500, datë 25.10.1993, Ministrisë së Arsimit.

Në mars të vitit 1993, Shqipëria miraton ligjin për të drejtat e pakicave kombëtare, në nenin 26 përmendet: «*Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të ushtrojnë pa asnjë lloj diskriminimi dhe në barazi para ligjit të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ato kanë të drejtë të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë lirisht identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar, gjuhësor, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe identitetit të tyre*».¹²

Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit nr. 19, datë 13.09.1993, i cili zëvendësoi udhëzimin nr.17, revokoi shumicën e reformave statutores të vitit 1991 dhe kufizoi mësimin e gjuhës greke vetëm në katër klasat e para të shkollës së ciklit tetëvjeçar. Ky udhëzim caktoi edhe raportin midis lëndëve që zhvillohen në gjuhën shqipe (40%) me ato në gjuhën amtare (60%) për klasat 5-8 (cikli i dytë). Në klasat 9-12 (cikli i tretë) mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe gjuha greke mësohet në klasën e 9-të dhe të 10-të dy orë në javë.

Sipas këtij udhëzimi, «*Hapja e klasave ose e shkollave të reja në gjuhën e pakicave kombëtare në kuadrin e sistemit publik shkollor, në zonat e pakicave (kur ka një përqindje të konsiderueshme të personave të pakicave kombëtare) bëhet me vendim të Ministrisë së Arsimit, mbi bazën e propozimit të Këshillit të rrethit përkatës*». Udhëzimi 19-të shkaktoi një tronditje të madhe në minoritetin grek dhe tek të gjithë mësuesit grekofonë që vendosën të mos marrin pjesë në mësim, duke shprehur protestën e tyre.

Në fillim të vitit shkollor 1994-1995, Ministria e Arsimit dërgoi në shkollat greke një vendim të Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22.08.1994¹³, bazuar në nenin 26 të ligjit “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, duke marrë parasysh parimet dhe standardet e parashikuara nga Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale, ose të Pakicave, e cila është miratuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg më datë 05.11.1992. Sipas këtij udhëzimi, për të mundur pjesëmarrje të barabartë dhe aktive në të gjithë jetën ekonomike, sociale, politike dhe kulturore të Shqipërisë, të rinjtë që u përkasin minoriteteve duhet të njohin gjuhën shqipe dhe për këtë qëllim shteti krijoi kushtet e nevojshme. Në njësitë shkollore ekzistuese, ku mësohej edhe gjuha amtare e këtyre pakicave, ata kishin të drejtën për të dhënë mësim, apo të mësonin gjuhën amtare. Në

¹² Ligji nr.7692, datë 31.03.1993.

¹³ Vendim i KM nr. 396, datë 22.08.1994, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 17, faqe 783.

kuadër të programit shkollor nxënësve minoritarë iu krijua mundësia për të studiuar historinë, traditat dhe kulturën e tyre.

Anëtarët e minoritetit protestuan ashpër kundër këtij vendimi, pasi ai nuk zgjidhi problemin e funksionimit të shkollave të Delvinës, Sarandës, Metohitit, Ksamilit, Bistricës dhe Gjirokastrës, të cilat u hapën në bazë të legjislacionit aktual gjatë viteve 1991, 1992, 1993. Përmes një memorandumit ata kërkuar heqjen e së drejtës për arsimim në gjuhën amtare vetëm në të ashtuquajturat zona minoritare, analogjinë me baza shkencore mes lëndëve që do të mësoheshin në gjuhën shqipe dhe gjuhën amtare, si dhe mos heqjen nga pushteti vendor të kompetencave që i përkisnin arsimit.

Në qarkoren e Ministrisë së Arsimit nr. 14, datë 03.09.1994, *«Për arsimin 8-vjeçar në gjuhën amtare të minoriteteve»*, u ripërcaktua kuadri ligjor për arsimin e minoritetit. Kjo qarkore rivendosi mësimin e të gjitha lëndëve në gjuhën greke në ciklin e dytë (5-8), me përjashtim të fizikës, matematikës, historisë dhe gjeografisë së Shqipërisë. E drejta për të mësuar gjuhën greke jepet në çdo shkollë në qoftë se të paktën 32 nxënës dëshirojnë ta mësojnë atë. Ky numër më vonë u reduktua në 20.

Kontributi më i rëndësishëm ishte konsolidimi i arsimit grek në klasat 5-8, përveç disa lëndëve të mësimdhënies në gjuhën shqipe. Me vendimin nr. 548, datë 26.08.1996, të Këshillit të Ministrave, koha e mësimin të gjuhës greke në shkollat e mesme (klasat 10-12), u rrit nga dy orë, në katër orë në javë. Kurrikula e formalizuar me këtë udhëzim u zbatua në vitin akademik 1994 – 1995. Ky raport zbatohet edhe sot.

Në *«Ligjin për sistemin arsimor parauniversitar»*, nr.7952, datë 21.06.1995, Neni 10.1, i cili u shpall *«Personave që u përkasin pakicave kombëtare u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre brenda kuadrit të planeve dhe programeve mësimore»*. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 08.05.1996,¹⁴ lejon funksionimin e klasave greke në shkollat e qendrave të mëdha urbane, nëse aplikojnë të paktën 20 prindër. Kjo çoi në hapjen e shkollave greke në qytetet e Gjirokastrës, Sarandës dhe Delvinës.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 493, datë 18.09.1995, *“Për fillimin e mësimin të gjuhës greke në disa shkolla të mesme”*, ku lejohet mësimi i gjuhës greke në shkollat e mesme, me dy orë në javë në klasat e 9-ta dhe 10-ta.

Në Reformën Arsimore të vitit 2005, cikli i studimit 8-vjeçar bëhet 9-vjeçar,

¹⁴ Vendim i KM nr. 502, datë 05.08.1996, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 21, faqe 790.

në fund të reformës së vitit 2009, gjuha greke mësohej deri në klasën e nëntë dhe nuk mësohej fare në shkollën e mesme. Me vendim të Ministrisë së Arsimit nr. 6045, datë 14.10.2009, “*Për mësimin e gjuhës greke si lëndë me zgjedhje të detyruar*” gjuha dhe letërsia greke tani mësohet dy orë në javë në tre vitet e shkollës së mesme.

Si përfundim, liria e shprehjes gjuhësore, e lidhur ngushtë me arsimin dhe kulturën, përbën një shtyllë kryesore të jetës së grupeve minoritare. Hulumtimi i kryer ka nxjerrë në pah se ky aspekt është vendimtar për integrimin social dhe kulturor të këtyre pakicave etnike, ndërsa mbetet i garantuar nga një kornizë e gjerë ligjore ndërkombëtare. Prandaj, është thelbësore që të vazhdojnë përpjekjet për të siguruar zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, në mënyrë që minoritetet të mund të ushtrojnë lirisht gjuhën dhe kulturën e tyre, duke ndikuar pozitivisht në bashkëjetesën shoqërore dhe në diversitetin kulturor të shoqërive moderne.

BIBLIOGRAFIA

- MEMUSHI R., (2001), *Legjislacioni për gjuhët e pakicave*, Kërkime Universitare, Universiteti i Gjirokastrës.
- TSITSELIQIS K. (1996). *Regjimi ndërkombëtar dhe evropian për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore të pakicave dhe rendi juridik grek*, Athinë: Sakkoula.
- TSITSELIQIS K., (2001), *Mbrojtja e gjuhëve të pakicave*, Udhëzues Enciklopedik, Marrë nga: language.gr/greekLang/studies/guide/theme_c5/index.html 27/10/2017.
- MANDA E, (2010), *Arsimi i Minoritetit Grek në Shqipëri gjatë Mesluftës*, Selanik, faqe 18.
- https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf
- <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>
- <https://www.osce.org/files/f/documents/5/c/39501.pdf>
- <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/declaration-rights-persons-belonging-national-or-ethnic>
- <https://rm.coe.int/16800c1303>
- https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/AEuropean_Charter_for_Regional_or_Minority_Languages.pdf
- <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>

HUAZIMET NGA ITALISHTJA NË GJUHËN E GAZETAVE: LEKSIKU DHE SINTAKSA

Dr. Elda Katorri

Departamenti i Gjuhës Italiane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: elda.katorri@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Gjuha shqipe dhe gjuha italiane, bëjnë pjesë që të dyja në familjen e madhe indoevropiane të gjuhëve ku njëra është degë më vete ndërsa tjetra rrjedh si vijimësi e trungut neolatin. Ato kanë sisteme gjuhësore krejt të dallueshme, si për nga struktura morfologjike ashtu edhe ajo sintaksore, fonetike, leksikore. Pavarësisht nga dallimet, si dy gjuhë indoevropiane që janë, është e kuptueshme që të kenë edhe mjaft pika kontakti, ngjashmërie, në të gjitha nivelet e gjuhës. Kjo për shkak të faktorëve të ndryshëm ekonomikë, gjeografikë, kulturorë, politikë etj. Në punimin tonë mëtojmë të analizojmë, me anë të shembujve të marrë nga gazetat e përditshme italiane dhe shqiptare, se si gjuha e shtypit të shkruar shqiptar ka huazuar nga gjuha italiane aspekte të sintaksës e sidomos leksikut të saj duke i shpërfaqur ato në larminë e regjistrave gjuhësorë sipas qëllimit të kumtin që synon të përcjellë.

Fjalë çelës: aspekte leksikore, aspekte sintaksore, gjuha e gazetave, huazime, kalke gjuhësore.

ABSTRACT

The Albanian and the Italian languages both belong to the large Indo-European language family. While the Albanian constitutes a separate branch, Italian represents a continuation of the Neo-Latin lineage. These languages have completely distinct linguistic systems, differing in morphological structure, as well as syntactic, phonetic, and lexical aspects. Despite these differences, as members of the same language family, it is understandable that they also share many points of contact and similarities across various linguistic levels. This is due to various economic, geographical, cultural, political factors, etc. In this paper, we aim to analyze - through examples drawn from Italian and Albanian daily newspapers - how the language of the Albanian written press has borrowed elements of syntax and, in particular, lexical items from Italian. These borrowings are reflected in a variety of linguistic registers depending on the communicative intent of the message.

Keywords: borrowings, linguistic calques, lexical aspects, newspaper language, syntactic aspects.

Hyrje

Gjuha shqipe dhe gjuha italiane, si pjesë të familjes së madhe indoevropiane të gjuhëve, përpos dallimeve morfosintaksore që shfaqin kanë edhe pika kontakti e ngjashmërie mes tyre. Kjo ngjashmëri, e mundësuar nga fenomeni i të huazuarit, si rrjedhojë e një sërë faktorësh jashtëgjuhësorë që lidhen jo thjesht me afërsinë gjeografike, por edhe me shkëmbimet tregtare e financiare, me marrëdhëniet politike, historike dhe kulturore mes dy vendeve, kanë bërë që shqipja të ndikohet jo pak nga italishtja.

Fillimi i viteve '90 shënoi një *boom* të vërtetë të ndikimit italian mbi shqipen ku repertori i leksikut italian "*vërshoi pa doganë*" në shtratin e kësaj të fundit. Në këmbim, emigrantët tanë vërshuan në Itali.

Në këtë periudhë shkëmbimet ekonomike, tregtare, financiare dhe kulturore midis dy vendeve u bymyen. Këtë rrjedhë ndoqën edhe bashkëpunimet dhe marrëveshjet gjeo-politike ku Shqipëria dhe Italia e panë veten partnere kryesore. Televizioni dhe radioja italiane u futën në çdo familje shqiptare dhe mbryjtën gjuhësisht shumë shqiptarë të brezit të viteve '90 ndërkohë që universitetet italiane i mikpritën dhe u hapën dyert këtyre të fundit.

Megjithatë, të gjithë faktorët jashtëgjuhësorë që kanë ndikuar në afrimin e italishtes me shqipen, përveç të mirave kulturore, pasurore, njerëzore, kanë sjellë me vete edhe "*efekte anësore*", apo "*efekte anësore gjuhësore*". Ka ndodhur rëndom që shqipfolësit, për shkak të pranisë së fuqishme, të vazhdueshme dhe të thellë të italishtes në të përditshmen e tyre, të devijojnë prej standardit. Arsyet? Një farë *snobizmi, padije, mosdëshirë, vetëdije apo kulturë e munguar gjuhësore*.

Kjo gjë është ndjerë shumë kryesisht në shtypin e shkruar, ku gazetarë a pseudo të tillë kanë shfaqur e shfaqin simptoma të padijes a padashjes së përkujdesjes për lëvrimin e saktë të gjuhës mëmë. Korsa e standardit është lënë gjithnjë e më tepër në harresë duke iu drejtuar huazimeve edhe atëherë kur nuk është nevoja siç do të thoshte i madhi Fishta.

Metodologjia

Në punimin tonë mëtojmë të analizojmë, me anë të shembujve të marrë nga gazetat e përditshme italiane dhe shqiptare, se si gjuha e shtypit të shkruar shqiptar ka huazuar nga gjuha italiane aspekte të sintaksës e sidomos leksikut të saj duke i shpërfaqur ato në larminë e regjistrave gjuhësorë sipas qëllimit të kumtin që synon të përcjellë. Punimi ynë synon të paraqesë, me anë të metodës përshkruese/krahasuese dhe të shembujve konkretë, se si gjuha e gazetave i ka përftuar këto huazime dhe cilat janë llojet e huazimeve që hasen më shpesh në shqipen e shtypit të shkruar. Shembujt e përdorur për të realizuar këtë punim janë vjelë nga një korpus i larmishëm i shtypit të shkruar shqiptar. Ndër gazetat e marra në shqyrtim mund të radhisim: *Gazeta Shqiptare*, *“Shqip”*, *“Shqiptarja.com”*, *“Dita”*, *“Tirana Observer”*, *“Panorama”*, *“Sot”*, *“Tema”* etj. si në versionin e printuar, ashtu edhe në versionin on-line, në harkun kohor 2010-2015.

Huazimet si shfaqje e drejtpërdrejtë e ndikimit të një gjuhe tek tjetra

Po të perifrazonim një shprehje frazeologjike të gurrës së shqipes do të thoshin se *“nuk është e udhës të mbahet gjuha me miell hua”*, sidomos kur mielli yt del e tepron për të mburjtur kuptime, koncepte, terminologji a gjithçka tjetër që i lipset nevojës sonë për komunikim.

Profesor Harapi¹ pyet: *“A ka gjë më të mbrapshtë që ta vret shpirtin, më keq se ta ndiesh italishten, frëngjishten, gjermanishten, shqip? Me fjalë, fraza e forma të huaja të përkthyer e të shqiptarizuara me përdhuni e pa fare shije, mbahemi se po flasim lart, po shkruajmë bukur...[...]. Kurrë falë mos u qoftë disave, të cilët, pa kërkuar aspak a e kemi atë fjalë në visarin e gjuhës sonë, fusin fjalë të huaja pa dhimbje, prej gjuhës në të cilën lexojnë, sajojnë fjalë të përbëra apo edhe fjalë të rrjedhura, që me të vërtetë nuk janë fjalë, por përbindësja kundruar në natyrën e në estetikën e gjuhës”*.

Megjithatë, në një shoqëri të hapur politikisht dhe ekonomikisht, siç është shoqëria shqiptare sot, është e pashmangshme trysnia e gjuhëve të vendeve të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht, me të cilat jemi në kontakt. Kjo trysni

¹ Shih: Murati Q. (2001), *Kokrra urtësie për gjuhën*, Tetovë Çabej, f. 22.

është e pashmangshme në fazat e para të hapjes ndaj botës². Fjalët dhe strukturat e huaja vërshojnë nga të gjitha anët, aq sa të krijohet përshtypja se po ia marrim frymën gjuhës.

Shpeshherë gjuha përcaktohet si organizëm i gjallë i cili, vazhdimisht, shndërrohet, zhvillohet, pasurohet. Ky organizëm jep hua gjymtyrë të veta, domethënë jep hua fonema, fjalë apo struktura sintaksore që ia ndryshojnë faqen gjuhës pritëse. Zakonisht ndryshimet dhe lëvizjet në gjuhë ndjekin një ritëm të ngadalshëm. Preket fillimisht tulla (leksiku) e mandej nis e gërryhet themeli (sintaksa). Ky ritëm ndryshimi nuk është njëtrajtësisht i ndryshueshëm, por përshpejtohet dhe bëhet më i dukshëm sidomos gjatë periudhave të kthesave të mëdha shoqërore, politike dhe ekonomike. Kështu ndodhi me ne, kështu ndodhi me shqipen pas viteve '90. Interesat e "*huasë gjuhësore*" që morëm nga italishtja po i shlyejmë ende.

Në fund të fundit gjuhët janë ashtu si njerëzit, u ngjajnë atyre, krijojnë marrëdhënie, zënë miq, marrin dhe japin nga njëra-tjetra. Ato e pasurojnë njëra-tjetrën dhe bëjnë kompromise në kuptimin që "gjuha dhuruese"³, pra ajo që e jep hua termin apo fjalën, është kaq zemërgjerë saqë nuk pret më që ti t'ia kthesh mbrapsht, përkundrazi, është shumë e kënaqur që t'ia falë atë një gjuhe tjetër pasi kjo i siguron prestigj dhe vijimësi.

Pra "*huazimi gjuhësor*" ("il prestito"), ndryshe nga huazimi i një objekti a sendi, të cilin pas një farë kohe i zoti kërkon që t'ia kthesh mbrapsht, nuk ka pretendime të tilla ndaj "borxhliut". Në gjuhë fjala apo struktura që jepet apo merret nuk i kthehet më asnjëherë të zotit, gjuhës së origjinës në rastin tonë sepse ato janë mjaft bujare me njëra-tjetrën. Megjithatë, kjo bujari nuk është krejt "pa zarrar" për gjuhën huamarrëse. Huazimi është një fenomen gjuhësor jo dhe aq i lehtë për t'u trajtuar i cili vihet re kryesisht gjatë kontaktit mes dy kulturash, mes dy gjuhësh.

Po t'i referohemi Bloomfield-it, ai dallonte dy lloje huazimesh: huazimin

² Rrokaj, Sh. (2004), *Disa parime teorike lidhur me dukurinë e huazimit*, – Akte të Seminarit të 3-të: "*Rreth huazimeve në shqipen standarde*", Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Hyaja, Shtëpia Botuese Pegi.

³ D'Achille, P. (2003), *L'italiano contemporaneo*, Bologna, Il Mulino.

e drejtpërdrejtë apo intim dhe huazimin e tërthortë.⁴ Të parin ai e lidhte me përdorimin e dy gjuhëve nga një bashkësi e njëjtë nga pikëpamja topografike dhe politike, ndërsa atë të tërthortin e lidhte me përdorimin e dy gjuhëve nga dy kombe që nuk janë një politikisht.

Cilësimi i një fjale si huazim është qëndrim etimologjik⁵ - shprehet profesor Lloshi – detyrë e leksikografëve, ndërsa gjurmimi i rrugëve të depërtimit dhe hyrje në kontakt të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, përmes gjuhës dhe përcaktimi i faktorëve jashtëgjuhësor i takon më shumë sociologëve a historianëve. Ne përdoruesve nuk na mbetet tjetër veçse t'i përdorim, “me karar” (me masë). *Mendojmë se akti i përdorimit është ai që e vulos praninë e huazimit ndërkohë që jetëgjatësinë e tij e përcakton qëndresa ndaj standardit dhe bashkëjetesa me të.*

Shpeshherë gjuhëtarët janë në dilemë se cilin fenomen, fjalë apo risi duhet ta konsiderojnë të tillë dhe kur kjo risi fiton statusin e të “integruarit”. Ne mendojmë se formalizimi në fjalor është një ndër kriteret bazë. Sa i përket statusit të sipërpërmendur, vetë fjala “italianizëm” ka hyrë zyrtarisht të bëjë pjesë në gjuhën shqipe vetëm në vitin 2002 (FSHS)⁶, pavarësisht se shfaqej shumë vite më parë në fjalorin Leka-Simoni⁷ (1986).

Llojet e huazimeve

Thamë që huazimet janë një fenomen i domosdoshëm në kushtet kur shoqëritë, kulturat, traditat, zakonet, gjuhët e kanë të pamundur “*të mos takohen*” e “*të mos japin e marrin*” me njëra-tjetrën. Në kushtet e një vakumi terminologjik e përkufizues, të gjendur përballë një risie, gjuhës i lind nevoja *objektive* për të marrë hua gjatë fjalës apo termin të cilin nuk e ka në inventarin e visarit të vet.

Ndryshe nga të parat, nevojat *subjektive*, i quajmë edhe *huazime luksi*, pasi folësit e njëres gjuhë “zgjedhin me dashje”, me apo pa arsye, të përdorin fjalë a konstrukte të huaja që i rrinë shqipes si mish i huaj.

⁴ Bloomfield, L. (1935), *Languages*, Allen and Unwin, London.

⁵ Lloshi, Xh., *Lloshi, Xh. (2001), Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, f.113.

⁶ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, (2002), *Fjalori shqipes së sotme*, Botimet Toena, Tiranë.

⁷ Leka, F. Simoni, Z. (1986), *Fjalor italisht-shqip*, Shtëpia Botuese ‘8 Nëntori’, Tiranë.

Në të gjitha gjuhët e botës, zhvillimi i përgjithshëm tekniko-shkencor dhe marrëdhëniet me botën, sjellin me vete edhe prurje të reja gjuhësore. Kjo dëshmohej, sipas Jean-Louis Duchet⁸, në futjen e më pas përhapjen e termave shkencorë dhe teknikë ndërkombëtarë, që në ditët tona është proces i shpejtë dhe i kushtëzuar nga komunikimi masiv. Mediat bëhen zëdhënës të këtyre termave duke i bërë jehonë jo vetëm zbulimit, por gjithashtu edhe emërtimit që e shoqëron objektin, dukurinë.

Pra, në rast se fjala e huaj mbulon një nevojë të lindur, së cilës gjuha jote nuk i përgjigjet, atëherë fjalët e marra hua bëjnë pjesë tek huazimet *dobiprurëse*⁹. Këto janë huazime *denotative si p.sh.* fjala *kompjuter* (computer), *globalizëm* (globalizzazione), *balotazh* (ballottaggio), *shteti i së drejtës* (stato del diritto) që kanë depërtuar në shqipen e sotme si pasojë e vakumit të saj për të emërtuar ato dukuri, koncepte, organizma a objekte që u përgjigjen nevojave të reja pas ndërrimit të sistemeve. Në këtë rast kemi të bëjmë me *ndërkombëtarizmat*¹⁰ të cilat, në kushtet e sotme gjeo-politike dhe zhvillimeve ekonomike, që e shohin Shqipërinë të projektuar drejt BE-së, janë rrjedhojë logjike e ndikimit ekonomik, politik, shkencor, kulturor të vendeve anëtare të saj, sidomos atyre më afër gjeografikisht siç është edhe rasti i Italisë.

Ja disa shembuj:

- “[...]Po ecet me ritmet e *globalizmit* [...]” (“*Shekulli*”, 27.11.2009. f.4)
- “Zgjedhjet në Maqedoni shkojnë në *balotazh*[...]” (“*Shqip*”, 14. 04.2014, f.3)
- “Fule: Më vjen keq nga *bojkoti* i PD. Mungon *shteti i së drejtës*” (“*Shqip*”, 27.03.2013, f.2)

Në kuadër të huazimeve të luksit (huazimet e panevojshme) mund të rendisim ato:

□ ***Përdorime të çastit të vetë (sh)përdoruesve:***

⁸ Zhan-Lui Dyshe. (1998), *Politika gjuhësore dhen dryshimet në gjuhë*, në ‘Gjuha letrare dhe epoka jonë’, Tiranë, fq. 209-212.

⁹ Lilo. R (2012), *Mbi huazimet frënge në gjuhën shqipe*, në Konferencën Shkencore “Kontakte gjuhësore dhe kulturore mes shqipes dhe gjuhëve të huaja në 100 vjet (1912 – 2012), Geer, Tiranë, f. 21.

Shih: Sobrero, A. (1993), *Lingue speciali* in Id. (a cura di), *Introduzione all’italiano contemporaneo. La variazione e gli usi*, Roma-Bari, Laterza, quarta ed., 1999, f. 237-277.

¹⁰ Thomai, J. (2002), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet TOENA, Tiranë. f.256.

Kështu kemi përdorimin e fjalëve *atakoj* (it. attaccare) në vend të *sulmoj apo konvertoj* (convertire) në vend të *shndërroj, transformoj*.

Në gjuhë ka fjalë të ndryshme që kanë pak a shumë kuptime të njëjta, sipsh.: makinë dhe autoveturë, mama dhe nënë. Këto fjalë janë sinonime, sepse në thelb duan të thonë të njëjtën gjë. Përveç kësaj, fjalët e leksikut mund të kenë marrëdhënie hierarkike me njëra-tjetrën, ku kuptimi i njëres mund të përfshihet në poliseminë e tjetrës p.sh.: lule dhe mimoza. Në rastin e dytë kemi një ngushtim kuptimi. Përgjithësisht, shembujt e vjelë nga shtypi i përditshëm janë huazime të panevojshme. Ato nuk sjellin zgjerim kuptimi.

□ “Është i njëjti që pakkush në sallën e Kuvendit guxon ta *atakojë* drejtpërdrejtë [...]”

(“*Shqiptarja.com*”, 26.03. 2013, f.3)

□ “Çdo cip, me sipërfaqe 1 x 1 cm mund të *konvertojë* dhe të prodhojë mesatarisht 200-250 wat energji gjatë një dite tipike 8 orëshe me diell[...]”

(“*Shqiptarja.com*”, 21.04.2015, f.3)

□ **Modizmat**¹¹, janë shprehje të modave gjuhësore që shfaqen si risi e çastit. Pra, ato janë fjalë me “*afat skadence*” të cilat zgjasin sa edhe vetë interesi për fenomenin që e nxiti. Janë të përkohshme. Sipas Lilos, një nga shembujt tipikë të “modizmit” në shqipen bashkëkohore është fjala *kleptoman* (it. *cleptomane*) ose *kleprokrat*, nxitur nga përfaqësues të klasës politike, opozitës në rastin e dytë.

□ **Huazimet-aluzione**¹². Këtu aluzioni mbështetet te metafora apo metonimi të fuqishme që i referohen, ngjarjeve të bujshme, personazheve apo fenomeneve nga kontekste politike a letrare të para si fenomene.

□ “**Portreti zgjedhor pa autorizim: Ilir Meta, Konti i LSI...**” (“*Shqiptarja.com*”, 26.03. 2013, f.2)

□ “*Qershori i tretë i Berishës [...]*” (“*Shqiptarja.com*”, 23.03.2103)

□ (*Imam Gjurulldia.....*), (“*Dita*”, 26.10.2013, f.1.)

□ (*Lamtumirë ARMO.....*), (“*Dita*”, 04.08.2013, f.1.)

□ (*Doshigjeji dje, Frokgeji sot..., po nesër?*) (“*Panorama*”, 05.04.2015. f.6)

¹¹ Lilo. R., *vep.cit.* f. 22.

¹² Po aty.

□ **Huazime që përdoren me nxitjen e sistemit fjalformues**¹³ hasen shpesh, sidomos në shtypin e përditshëm. Ato janë kryesisht huazime ndajshitesash fjalëformuese: parashtesa dhe prapashtesa që shquhen në përgjithësi në krijimet individuale dhe rastësore.

- “Hidroberishizmi [...] Ndaj i them këtij zotërie të hidroberishizmit[...]),
- (“Shqiptarja.com”, 29.08.2012, f.7)
- “Gandizmi” qeverisë si domosdoshmëri për të mposhtur të keqen [...]”
- (“Tema” on-line, 25.09.2014)
- “Supermashtimi në SHBA, hiqeshin si invalidë pas sulmit të 11 shtatorit”
- (“Shqiptarja.com”, 09.01.2014, f.6)
- “Korça dhe kinema-mania”¹⁴
- “Fishekzjarromania”¹⁵

Një lloj tjetër huazimi janë edhe **kalket**¹⁶ të cilat janë përkthim fjalë për fjalë nga njëra gjuhë në tjetrën. Ato mund të klasifikohen në kalke formale apo strukturore dhe kalke semantike. Thënë ndryshe ato ndahen në dy llojesh:

a) Kalke homonimike, të cilat paraqesin ngjashmëri në nivel shënjesish (*procesor / processore, kamarier / cameriere, ceremoni / cerimonia, metodë / metodo* etj.

- “Fillojnë metodën” (“Shqip”, 1.7.2015, f. 23)
- “Baily, gjatë *ceremonisë* së akreditimit, tha se [...]” (“Sot”, 13.2.2015, f. 13)

b) Kalke sinonimike të cilat paraqesin ngjashmëri në nivel të shënjuarish, pra, në kuptim (*fundjavë/fine settimana, grattacielo/qiellgërvishës, mani pulite/duar të pastra, datore di lavoro/punëdhënës, kafe e gjatë/shkurtër/caffèlungo/ristretto, bëj mjekun/jam mjek* etj.)

- “Kushedi sa herë mund t’ju ketë shkuar në mendje pyetja nëse ia vlen vërtet të martoheni me “*gjysmën e ëmbël*”! (*dolcemetà*)” (“Shqip”, 20.4.2015, f.15)
- “po diskutohet nga *europarlamentarët*” (*europarlamentari*) (“Shqip”, 20.4.2015, f.22)

Pra, siç pamë më lart huazimet i kemi disa llojesh: *huazime morfologjike* ose ato që prekin sistemin parashtesor e atë prapashtesor të fjalëformimit, *huazime*

¹³ Lilo. R., vep.cit. f. 23.

¹⁴ <http://www.monitor.al/>, konsultuar më 22.05.2015.

¹⁵ <http://www.monitor.al/>, konsultuar më 22.05.2015.

¹⁶ D’Achille, P. (2003), *L’italiano contemporaneo*, Bologna, Il Mulino, f.71-72.

sintaksore ose ato që prekin strukturën e ndërtimit të gjuhës, *huazime leksikore* e *fonetike* që prekin fjalët e fonemat, *huazime të drejtpërdrejta* e të *tërthorta*, *gojore* apo *shkrimore*, *strukturore* etj. Që të gjitha dukuritë e sipërpërmendura kanë të bëjnë me fenomenin e asimilimit, asimilimin e plotë apo atë të pjesshëm.

Fatmirësisht, gjuha shqipe është mjaft elastike. Ajo ka aftësinë të asimilojë fjalën e huaj dhe t’ia përshtatë atë strukturës a sistemit të vet. Sot, pikërisht për këtë arsye, pothuajse të gjitha huazimet e vjetra latine ose greke, janë larguar aq shumë nga trajtat e tyre të gjuhëve nga janë marrë, saqë është e vështirë të vendoset menjëherë lidhja me ato gjuhë pa gërmuar historinë e tyre. Në fakt nuk ka fjalë të huaj në shqipe, që të mos pësojë ndryshime fonetike e të mos marrë mbaresat e trajtat e gjinisë, rasës, mënyrës, kohës, vetës dhe numrit¹⁷.

Përfundime

Ligjërimi gazetaresk shqiptar ka huazuar dhe është ndikuar jo pak nga ai italian. Kjo shihet në rrafshin e huazimeve në pikëpamjen morfologjike, leksikore e sintaksore. Për shkaqe brendagjuhësore dhe jashtëgjuhësore shtypi shqiptar i ka marrë “hua” shtypit italian shumë fjalë apo konstrukte të cilën nuk “ia ka kthyer më mbrapsht”. Edhe nga pikëpamja grafike apo emërtuese shqipja ka huazuar shumë nga italishtja. Është rasti i *Gazetës Shqiptare* që vjen si zgjatim i *Gazzetta del Mezzogiorno* apo *Gazeta e Sportit* si imitim i *Gazzetta dello Sport*.

Ndër shkaqet e shumta të këtij ndikimi të gjuhës italiane edhe në shtypin tonë mund të përmendim afërsinë gjeografike, shkëmbimet ekonomike e tregtare, trashëgiminë kulturore dhe shpesh pakujdesinë e gazetarëve, politikanëve dhe njerëzve publikë të cilët po aq publikisht tregojnë pak apo aspak kujdes për gjuhën shqipe dhe të shkruarit bukur. Përdorimet apo shpërdorimet që këta të fundit i bëjnë gjuhës, shmangia nga norma letrare apo qoftë edhe një farë snobizmi që i karakterizon pothuajse të gjithë ata që dalin në ekranet e televizioneve, të atyre që zënë faqet e para të gazetave, gazetarë e politikanë, është përcaktues për gjendjen e shtrembërimit të gjuhës shqipe dhe devijimin nga standardi.

¹⁷ Miço Samara, *Norma leksikore, pastrimi e pasurimi*, ‘Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë’, nr. 7, ShBLSh, Tiranë, 1981, fq. 42.

BIBLIOGRAFIA DHE SITOGRAFIA

- Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1997), *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Tiranë.
- BLOOMFIELD, L. (1935), *Languages*, Allen and Unwin, London.
- CIRILLO, S. NERI, G. (2009), *Dal nostro inviato. 50 anni di giornalismo italiano*, Bulzoni editore, Roma.
- D'ACHILLE, P. (1990), *Sintassi del parlato e tradizione scritta della lingua italiana. Analisi di testi dalle Origini al secolo XVIII*, Roma, Bonacci.
- D'ACHILLE, P. (2003), *L'italiano contemporaneo*, Il Mulino, Bologna.
- DARDANO, M. (1973), *Il linguaggio dei giornali italiani*, Laterza, Roma-Bari.
- GOUTHIER, D. IOLI, E., Gouthier, D. Ioli, E. (2007), *Fjalët e Ajnshtajnit. Gjuha e shkencës midis përpikërisë dhe poezisë*, Dituria, Tiranë.
- LILO. R (2012), *Mbi huazimet frënge në gjuhën shqipe*, në Konferencën Shkencore “Kontakte gjuhësore dhe kulturore mes shqipes dhe gjuhëve të huaja në 100 vjet (1912 – 2012), Geer, Tiranë, f. 21.
- MURATI Q. (2001), *Kokrra urtësie për gjuhën*, Tetovë Çabej, f. 22.
- SAMARA, M. (1981), *Norma leksikore, pastrimi e pasurimi*, ‘Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë’, nr. 7, ShBLSh, Tiranë, fq. 42.
- RROKAJ, Sh. (2004), *Disa parime teorike lidhur me dukurinë e huazimit*, – Akte të Seminarit të 3-të: “Rreth huazimeve në shqipen standarde”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Shtëpia Botuese Pegi.
- SOBRERO, A. (1993), *Lingue speciali* in Id. (a cura di), *Introduzione all’italiano contemporaneo. La variazione e gli usi*, Roma-Bari, Laterza, quarta ed., 1999, f. 237-277.
- THOMAI, J. (2002), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet TOENA, Tiranë. f.256. Tiranë.
- ZHAN-LUIDYSHE. (1998), *Politika gjuhësore dhe ndryshimet në gjuhë*, në ‘Gjuha letrare dhe epoka jonë’, Tiranë, fq. 209-212.
- <http://shqiptarja.com/home.php>
- <http://www.gazetadita.al/>
- <http://www.panorama.com.al/>
- <http://gazeta-shqip.com/lajme/>
- <https://www.tiranaobserver.al/>
- <https://www.gazetatema.net/>
- <https://sot.com.al/>

RËNDËSIA E STUDIMIT TË LATINISHTES NË DITËT E SOTME

Prof. Asoc. Dr. Leonard Xhamani

Departamenti i Gjuhës Italiane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: leonard.xhamani@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Studimi i gjuhës latine nga studentët e degëve filologjike është mjaft i rëndësishëm. Shpesh, studentët që vijnë të studiojnë në fakultetin tonë, na pyesin: Pse gjuhë latine në ditët e sotme? Nga përvoja 20-vjeçare në mësimdhënien e kësaj gjuhe mund të themi se procesi i mësimi të latinishtes është ashtu si i gjuhëve tjera, me veçoritë e saj. Por, duhet një punë e vazhdueshme për të arritur përvetësimin e saj, ashtu siç është e domosdoshme edhe njohja e sistemit gramatikor të gjuhës sonë amtare. Duke mësuar latinishten, studentët nxiten vetvetiu të bëjnë analiza krahasuese jo vetëm me shqipen, por edhe me gjuhë të tjera: të shohin pikat e takimit me italishten, frëngjishte, anglishten, etj. Studimet shkencore kanë treguar se mësimi i latinishtes rrit aftësitë logjike dhe arsyetuese të studentëve, duke i ndihmuar edhe në lëndë të tjera. Latinishtja klasike ka qenë dhe mbetet si një çelës i domosdoshëm për të hapur thesaret e letërsisë, të filozofisë, të drejtësisë, të shkencës, të matematikës, të fizikës, të kimisë e të shkencave të tjera të natyrës, që njerëzit arrijnë t'i zbulojnë e t'i zhvillojnë në shekuj. Fjalët çelës: analizë krahasuese, gjuhë shkencore, mësimdhënie, ndikimi i latinishtes.

ABSTRACT

The study of Latin is of great importance for students in the field of philology. One of the most common questions new students ask upon entering our faculty is: Why study Latin today? Based on 20 years of experience in teaching this language, we can affirm that learning Latin follows a process similar to that of other languages, with its own characteristics. However, consistent work is essential for mastering it, and a solid understanding of the grammatical system of one's native language is also crucial. By learning Latin, students are naturally encouraged to make comparative analyses—not only with Albanian, but also with other languages such as Italian, French, English, etc. Research has shown that studying Latin enhances students' logical thinking and reasoning skills, which in turn benefits their performance in other subjects. Classical Latin has long been, and continues to be, an indispensable key to unlocking the treasures of literature, philosophy, law, science, mathematics, physics, chemistry and other natural sciences that humanity has developed over the centuries. Keywords: comparative analysis, scientific language, teaching, the influence of Latin.

Hyrje

Kur studiojmë një gjuhë të huaj, mësojmë rreth kulturës dhe zakoneve të popujve të tjerë, bëhemi më tolerantë dhe, gjë që është e rëndësishme për një specialist të ardhshëm, formojmë dhe zhvillojmë kompetencën e përgjithshme kulturore. Studimi i gjuhës latine na lejon të vërejmë një numër të madh fjalësh dhe konceptesh me origjinë antike.¹ Kultura antike hyn në mënyrë harmonike në shumë kultura të tjera. Mitologjia e lashtë, filozofia, letërsia, mjekësia, etj, janë themeli mbi të cilin ndërtohet shkenca moderne dhe botëkuptimi i një personi të arsimuar. Latinizmat janë të pranishëm në shumë gjuhë, mjekësia bazohet në terminologjinë latino-greke, aforizmat latine zbukurojnë fjalimet e politikanëve, gazetarëve dhe shkrimtarëve. Latinishtja është një nga gjuhët më të vjetra të shkruara të sistemit indo-evropian. Dëshmia e parë e shkruar e gjuhës latine daton në shekullin e VII para Krishtit. Me rritjen e ndikimit politik të Romës dhe pushtimin gradual të rajoneve të tjera të Italisë, zona e përdorimit të gjuhës latine gjithashtu zgjerohet. Nga shekulli I para Krishtit, gjuha latine në thelb përfundon procesin e formimit të saj, duke arritur në shkallën më të lartë të zhvillimit. Vepra e shkrimtarëve të mëdhenj romakë daton në këtë kohë: Ciceroni, Cezari, Lukreci, Katuli, Virgjili, Horaci, Ovidi, të cilët i dhanë kulturës botërore modele të poezisë dhe prozës letrare. Kjo periudhë në zhvillimin e gjuhës latine quhet klasike. Gradualisht, Roma bëhet një fuqi botërore, duke pushtuar të gjitha vendet e Mesdheut në jug dhe një pjesë të konsiderueshme të Evropës në veri. Latinishtja bëhet gjuhë ndërkombëtare, duke zëvendësuar dialektet lokale. Më vonë, për gati pesë shekuj, gjuha latine ishte e zakonshme për shumë popuj të Perandorisë së madhe Romake. Me rënien e Perandorisë Romake të Perëndimit, gjuha latine vazhdoi të ekzistojë për një kohë të gjatë, si në formën e saj letrare, ashtu edhe në atë të folur. Ajo mbeti në Evropë gjuhë e shkollës, e fesë, e shkencës, jo vetëm në antikitetin e vonë, por pothuajse gjatë gjithë historisë mijëra vjeçare të Mesjetës.

Të gjitha gjuhët e gjalla ndryshojnë me kalimin e kohës, dhe latinishtja nuk bën përjashtim. Tashmë gjatë antikitetit, por aq më tepër pas rënies së Perandorisë Romake, latinishtja u transformua ngadalë dhe me kalimin e kohës

¹ Beninca, P., Conti, R. P. (2003). *Didattica delle lingue classiche e linguistica teorica. Università e Scuola.*

prej saj lindën gjuhët neolatine ose romane. Këto janë gjëra të njohura, por shpesh harrohet se si gjatë Mesjetës dhe Rilindjes, latinishtja, pavarësisht se ishte bërë një gjuhë e vdekur, pra pa folës amtarë, vazhdoi të ishte një gjuhë e folur, e dëgjuar, e lexuar dhe e shkruar. Në shekujt XVII-XVIII, latinishtja ruan plotësisht rolin e saj si gjuhë ndërkombëtare e shkencës. Veprat e filozofëve francezë Descartes dhe Gassendi, filozofit holandez Spinoza, shkencëtarëve anglezë Bacon, Hobbes, Locke dhe filozofit dhe matematikanit gjerman Leibniz janë shkruar në latinisht.

Për gati njëzet shekuj, gjuha latine u shërbeu popujve të Evropës si mjet komunikimi, me ndihmën e saj ata njohën kulturën romake dhe, në një masë të madhe, kulturën greke. Ajo pati një ndikim të madh në gjuhët e popujve evropianë, si në fushën e gramatikës, ashtu edhe në fushën e leksikologjisë. Italishtja është gjuha neolatine që është ruajtur më afër formës origjinale latine. Shumë fjalë italiane kanë mbetur siç ishin në latinisht, ndërsa një pjesë kanë pësuar ndryshime të vogla fonetike. Ndikimi i latinishtes shihet edhe në gjuhën angleze, e cila sot quhet “Lingua franca”. Gjuhëtari i njohur, Tullio De Mauro, e ka quajtur anglishten “një nga gjuhët më të latinizuara dhe më romane nga gjuhët jo-romane”.

Pse gjuhë latine në ditët e sotme?

Kjo pyetje dëgjohet shpesh nga studentët që vijnë të studiojnë në fakultetin tonë. Çfarë është latinishtja dhe pse ta studiojmë? A na shërben? A është e vështirë? Etj. Ata edhe druhen nëse do të mund ta përballojnë një lëndë të tillë. Nga përvoja 20-vjeçare në mësimdhënie, mund të themi se procesi i mësimi të latinishtes është ashtu si i gjuhëve tjera, me veçoritë e saj. Por, duhet një punë e vazhdueshme për të arritur përvetësimin e saj, ashtu siç është e domosdoshme edhe njohja e sistemit gramatikor të gjuhës sonë amtare. Duke mësuar latinishten, studentët nxiten vetvetiu të bëjnë analiza krahasuese jo vetëm me shqipen, por edhe me gjuhë të tjera: të shohin pikat e takimit me italishten, frëngjishten, anglishten, etj. Përvoja na tregon se ata që e kanë mësuar mirë latinishten, kanë pasur një bazë mjaft të mirë edhe për gjuhët e tjera.

Në ditët e sotme, latinishten e konsiderojnë “gjuhë të vështirë”, “gjuhë të mërzitshme, të lodhshme”, “gjuhë të vdekur”, etj. Nisur nga kjo e fundit, latinishtja nuk ka nevojë të rikthehet sepse nuk ka vdekur: nuk flitet më, por

mund të lexohet, përkthehet, kuptohet, analizohet, etj. Sigurisht, që nuk është disiplina ose gjuha më e pëlqyer nga studentët, sepse për shumicën duket një njohuri e vjetruar, e padobishme në ditët e sotme dhe në tregun e punës. Një debat i tillë konkret është edhe në universitetet perëndimore, ku, pavarësisht se disa mendojnë se është e padobishme, ajo është e parashikuar në rregulloret e këtyre universiteteve. Madje, kjo kulturë nuk është braktisur kurrë në Evropë. Në gjimnazet e Gjermanisë, Italisë, Britanisë së Madhe, Francës, etj, latinishtja dhe në disa vende greqishtja e vjetër janë lëndë të detyrueshme². Në këtë situatë, gjuha latine perceptohet pothuajse si një gjuhë ndërkombëtare. Përveç mësimit të rregullave gramatikore, latinishtja lulëzon në Perëndim edhe në fusha të tjera të jetës. Umberto Eco, në librin e tij *Il costume di casa, Evidenze e misteri dell'ideologia italiana*³, shkruante: “Jam shumë i lumtur që kam mësuar latinishten, edhe pse jam i pakënaqur me mënyrën e dhimbshme me të cilën më është imponuar” .

Si një nga mbështetësit e latinishtes, kemi plot argumente në favor të kësaj gjuhe: Nëse nuk do të dinim latinisht, nuk do të dinim të kuptonim Buzukun. Siç thotë edhe studiuesi Enver Sulaj⁴: “Të mësuarit e latinishtes është edhe një detyrim moral për të kaluarën tonë, është një përgjegjësi për të ardhmen. E shtruar në formë hipoteze, mund të thuhet se po të mos e njihje Gjon Nikollë Kazazi⁵ latinishten, nuk do të hynte në Arkivin e Vatikanit e të gjente aty “Mesharin”, librin e parë (të njohur deri më tani) në shqip. Po të mos dinte latinisht Marin Barleti, ne s’do të kishim sot librin e parë për heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin – Skënderbeun, njohja e të cilit nuk do të arrinte aty ku është sot.” Me anë të latinishtes hyjmë në botën krijuese të dijetarëve

² Balbo, A., Ricucci M. (2014), *Prospettive per l'insegnamento del latino. La didattica della lingua latina fra teoria e buone pratiche*, Torino.

³ Eco, U., (1973), *Il costume di casa. Evidenze e misteri dell'ideologia italiana*, Milano, Bompiani, fq. 78.

⁴ Sulaj, E., Gjuha latine – sfidë e këndshme apo ballafaqim i vështirë? Prizrenpress.

⁵ Gjon Nikollë Kazazi ishte prift jezuit shqiptar nga Gjakova, Kosovë, i cili jetoi gjatë viteve 1702-1752. Kazazi është i pari studiues shqiptar, që bëri hulumtime në Arkivin Sekret të Vatikanit gjatë vitit 1744. Që prej këtij viti deri në vitet '90 të shekullit XX, nuk ka pasur studiues të tjerë shqiptarë në këtë arkiv.

humanistë shqiptarë, si: Barleti, Maruli⁶, Gazulli⁷, Bogdani etj., por edhe të tjerëve më vonë që ndoqën modele shkrimore në këtë gjuhë. Duke mësuar latinishten, studentët kanë mundësi të shohin ndikimin e saj të thellë në gjuhën tonë dhe në gjuhë të tjera.

Pa latinishten nuk do të kuptonim gati 2000 vjet histori që shënuan lindjen, jetën dhe rënien e Perandorisë Romake. Gjuha latine është gjuha amtare e italishtes dhe nga e cila lindën një pjesë e mirë e gjuhëve të sotme moderne, sidomos e gjuhëve romane.⁸ Me anë të saj mund të shpjegosh se si kanë ndryshuar fjalët me kalimin e kohës. Mund të japësh argumente si ka ndikuar në sistemin tonë gjuhësor, duke bërë krahasime në rrafshin morfologjik e sintaksor, mund të flasim për huazimet, etj. Pa përmendur pastaj artin, kulturën, historinë, etj., të cilat i paraprinë të gjithë kulturës perëndimore. Madje, edhe sot e kësaj dite konsiderohet si gjuha e shkencës. Studimet shkencore kanë treguar se mësimi i latinishtes rrit aftësitë logjike dhe arsytuese të studentëve, duke i ndihmuar edhe në lëndë të tjera. Nga ana tjetër, ka edhe nga ata që mendojnë se duke hequr latinishten, mund të zhvillohet një disiplinë tjetër që është më e kohës dhe fare mirë e ashtuquajtura gjuhë shkencore mund të zëvendësohet sot nga anglishtja. Por, pavarësisht argumenteve deri diku bindëse, ato nuk janë plotësisht të vërteta. Latinishtja akoma mbetet gjuha zyrtare e shtetit të Vatikanit dhe është e lidhur ngushtë me shkencën, sidomos me atë të mjekësisë. Shkrimet e mjekëve dhe shkencëtarëve të parë janë shkruar latinisht dhe kanë ardhur deri në ditët e sotme. Mjekët edhe sot thonë: *sëmundje kardiovaskulare, bajame të hipertrofizuara, gastritis, hepatitis, meningitis, angina pectoris*, etj. Një pjesë e termave është zëvendësuar nga anglishtja si gjuhë ndërkombëtare, por latinishtja mbetet guri i themelit të gjuhës shkencore. Një mjek që ka marrë një arsim klasik në çdo vend të botës, do të kuptojë lehtësisht recetat e kolegëve të tij të huaj. Ai mund të lexojë një revistë mjekësore në gjuhën angleze dhe të kuptojë në terma të përgjithshëm se për çfarë bëhet fjalë në artikull, sepse në anglisht pothuajse e gjithë terminologjia mjekësore është e latinizuar. Të

⁶ Poet latin i Rilindjes evropiane për të cilin është thënë se ka prejardhje arvanitase.

⁷ Gjini Gazulli (1400 - Raguzë, 19 shkurt 1465) ka qenë frat dominikan, humanist dhe diplomat i republikës së Raguzës me prejardhje arbërore.

⁸ Varvaro. A., (2014), *Il latino e la formazione delle lingue romanze*, Il Mulino, Bologna, Itali.

gjithë termat e rinj biologjikë dhe mjekësorë⁹ janë krijuar sipas rregullave të gramatikës latine dhe shkruhen me shkronja latine, pavarësisht gjuhës nga kanë ardhur.

Jemi të vetëdijshëm që vitet e fundit interesi për gjuhët klasike në përgjithësi ka rënë. Kjo edhe për shkak të ritmeve të shpejta të teknologjisë. Nëse në vitet 1980 shkencat kompjuterike ishin një “hobi”, latinishtja ishte një nga lëndët kryesore në universitete. Dhe u deshën gati 30 vjet që këto pozicione të ndryshojnë në favor të teknologjisë. Por, kjo nuk do të thotë që ta braktisim këtë gjuhë, pasi duam apo nuk duam, latinizmat janë pjesë e komunikimit tonë. Ato i gjejmë kudo. Po përmendim disa: *institut, dishepull, agent, asistent, laborant, student, audiencë, audio dhe video, donator, forum, koleg, numizmat, kolokium, kursor, sanatorium, akuarium, altar, celebror, seminar, leksion* etj, etj. Fjalët e urta dhe thëniet latine e gjallërojnë fjalimet e gazetarëve dhe politikanëve: *Carpe diem; Veni, vidi, vici; Errare humanum est, perseverare diabolicum; Amici, fures temporis; Mens sana in corpora sano; Repetitio est mater studiorum; Verba volant, scripta manent*, etj. Një pjesë e aforizmave latine janë bërë prej kohësh shprehje, të cilat qarkullojnë në një rreth të ngushtë njerëzish. Ato përdoren në letërsinë shkencore dhe artistike, në të folurit publik. Aktualisht, rëndësia e gjuhës latine nuk është aq e madhe, megjithatë, ajo luan një rol të rëndësishëm në sistemin arsimor. Gjuha latine është e nevojshme për një gjuhëtar, historian, avokat. Për të gjithë specialistët, studimi i kësaj gjuhe ndihmon në zotërimin e kulturës filologjike të nevojshme në punën kërkimore, kontribuon në zotërimin e suksesshëm të gjuhëve të huaja. Sipas Profesor Eqrem Çabej¹⁰, latinishtja është gjuha që ka lënë gjurmë të thella në shqipen e sotme. “Ndikimi i saj shtrihet kryesisht në leksik, po nuk mungon dhe në formim të fjalëve. Në leksik ai ndihet, sidomos në këto sfera të jetës: pjesët e trupit, shtëpi, kafshë shtëpiake, vegla, armë e luftë, emra afërie, emërtime të kohës, jeta kishtarë, jeta shoqërore e tregtia, bujqësi e pemë, blegtoaria, punimi i verës e i vajit, etj.”. Kjo gjuhë ka qenë dhe mbetet si një çelës i domosdoshëm për të hapur thesaret e letërsisë, të filozofisë, të drejtësisë, të shkencës, të matematikës, të fizikës e të shkencave të tjera të natyrës, që njerëzit arritën t’i zbulojnë e t’i zhvillojnë në shekuj. Për mendimin tonë, latinishtja duhet të mbetet në universitet shkencore, vërtet

⁹ Xhamani. L. (2012). *Vërejtje rreth leksikut terminologjik në fushën e mjekësisë*, në Buletini i Shkencave Mjekësore, V. 43, fq. 214-218, Tiranë.

¹⁰ ÇABEJ, E. (1976), *Studime gjuhësore III*, fq. 54-55, Prishtinë

duhet vlerësuar, duke pasur parasysh rolin që ka në mjedisin shkencor dhe duke qenë se është gjuha amtare e disa prej gjuhëve më të folura në botë.

Si përfundim, mendojmë se studimi i kësaj gjuhe në degët filologjike është i domosdoshëm, pasi filologët apo historianët e ardhshëm studimet e tyre do t'i kenë të thelluara. Duke hequr dorë nga kjo gjuhë, nuk do të bënim gjë tjetër, veçse do të linim përgjysmë një rrugë të nisur nga studiuesit dhe mësuesit tanë si: Pashko Gjeçi, Gjon Shllaku, Henrik Lacaj, Eqrem Çabej e të tjerë më pas, të cilët kanë dhënë një kontribut mjaft të madh për studimet tona filologjike. Ashtu si romakët që ngrinin lart virtytet e paraardhësve të tyre (Mos Maiorum) dhe këtë ua përcillnin brezave të ardhshëm, të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe ne me trashëgiminë që na lanë. Asnjëherë nuk duhet anashkuar detyrimi që kemi ndaj tyre, pavarësisht periudhës së vështirë historike që po kalojmë, ku teknologjia na “ka zënë sytë të gjithëve”. Është përgjegjësi e jona që studimet në fushën filologjike të mos jenë të cunguara. Një qasje metodike bashkëkohore e mësimeve, mbështetur në tekste përkatëse, është një bazë e mirë për një sukses dhe nxënie sa më të lehtë të kësaj gjuhe.

BIBLIOGRAFIA

- BALBO, A., RICUCCI M. (2014), *Prospettive per l'insegnamento del latino. La didattica della lingua latina fra teoria e buone pratiche*, Torino.
- BENINCA, P., CONTI, R. P. (2003). *Didattica delle lingue classiche e linguistica teorica. Università e Scuola*.
- ÇABEJ, E. (1976), *Studime gjuhësore III*, fq. 54-55, Prishtinë
- DIONIGI, I., (2017), *Ragazzi, internet non basta, per conoscere il mondo ci vuole il latino*.
- ECO, U., (1973), *Il costume di casa. Evidenze e misteri dell'ideologia italiana*, Milano, Bompiani.

GRAMSCI, A. (1937), *Perché studiare latino e greco*, Quaderni dal carcere, 4, XIII, 55.

PAÇO, E., (2012). *Latin Lesson Lectio Aulae*. Mediterranean Journal of Social Sciences, fq. 253.

SULAJ, E., Gjuha latine – sfidë e këndshme apo ballafaqim i vështirë? Prizren press.

Shqipja dhe Gjuhët e Ballkanit (2011), Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor në Prishtinë

VARVARO. A., (2014), *Il latino e la formazione delle lingue romanze*, Il Mulino, Bologna, Itali.

XHAMANI. L. (2012). *Vërejtje rreth leksikut terminologjik në fushën e mjekësisë*, në Buletini i Shkencave Mjekësore, V. 43, fq. 214-218, Tiranë.



LETTERATURA, DIDATTICA, TRADUZIONE

Ky vëllim, i botuar në janar 2024, përmbledh kontributet e paraqitura në Konferencën XIV Ndërkombëtare të Studimeve Italiane “*Letërsia, Mësimdhënia, Përkthimi*” që u zhvillua në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë (Shqipëri) më 17 maj 2023. Ideja për të organizuar këtë konferencë lindi nga dëshira për të bashkuar kërkues dhe studiues të ndryshëm, në një ditë diskutimi dhe reflektimi mbi temat kryesore mbi të cilat u përqendruan tri projektet kërkimore të Departamentit të Gjuhës Italiane (në dy vitet akademike 2022-2024).

Projekti “*Letërsia Italiane dhe Feja në shekujt XIX-XX*”, me koordinatore Prof. Dr. Irena Lama, kishte në fokus studimin e raportit të ngushtë e të pazgjydhshëm mes Letërsisë italiane dhe fesë në dy shekujve të fundit. Hulumtimi u përqendrua te shkrimtarë klasikë italianë, si dhe tek veprat e tyre letrare me rëndësi për letërsinë italiane dhe botërore. Në kërkimet e bëra u evidentuan vepra të cilat, edhe në ditët e sotme, nxisin dialogun ndërkulturor në proceset e edukimit, u trajtuan aspektet estetike dhe fetare të tyre, si dhe raporti i këtyre produkteve njerëzore me kohë-hapësirë krejtësisht të ndryshme. Autorët e analizuar janë autorë që kanë ushtruar ndikimin e tyre përgjatë historisë së letërsisë italiane dhe asaj botërore, si: *Luigi Pirandello, Grazia Deledda, Federico Tozzi, Elsa Morante, Giacomo Leopardi, Giovannino Guareschi, Ugo Fleres, Edmondo De Amicis, Giovanni Pascoli, Contessa Lara, Marchesa Colombi, Diego Agnelli* dhe veprat përkatëse.

Në kuadër të këtij projekti, ashtu siç edhe evidentohet lehtësisht nga kumtesat e botuara, u bë një studim i thelluar i veprave të shkruara nga autorët e sipërpërmendur italianë, veprat e të cilëve tregojnë raportin e ngushtë mes letërsisë italiane dhe fesë; u njohën çështjet kryesore estetike, politike, fetare dhe sociale të veprave përkatëse që kanë ndikuar dhe kontribuar në formësimin e letërsisë dhe kulturës italiane të të gjitha kohërave në përgjithësi dhe të dy shekujve të fundit në veçanti; u bë studimi i shkrimtarëve italianë dhe mënyrës se si ata shprehin idetë që janë të rëndësishme për ta, një mënyrë për të kuptuar të tjerët në përgjithësi dhe për të përmirësuar aftësinë e studiuesit për të ndërvepruar brenda komunitetit në veçanti; u rritën njohuritë mbi letërsinë dhe kulturën italiane sipas qasjeve të ndryshme; u zhvilluan kompetencat komunikative shumëgjuhësore e ndërkulturore përmes studimit të letërsisë italiane; u njohën studime të kritikës letrare shqiptare e të letërsisë italiane rreth kësaj tematike; u bënë reflektime rreth qasjes ndërkulturore për përdorimin e

letërsisë italiane me këtë tematikë në mësimin e gjuhës italiane etj.

Projekti i fushës së didaktikës *“Përftimi i kompetencave lidhur me aftësinë e të dëgjuarit dhe të folurit në një këndvështrim didaktik dhe vlerësues me qëllim zhvillimin e artit të komunikimit në gjuhën italiane”*, i koordinuar nga Prof. Asoc.Dr. Aida Gjinali, u përqendrua në identifikimin në terren të problemeve që ndeshen në lidhje me një aspekt shumë të rëndësishëm, në të mësuarin e një gjuhe të huaj dhe të gjuhës italiane në rastin tonë, dëgjimin. Kjo aftësi është e lidhur ngushtë me të kuptuarit dhe të folurit. Në hulumtimin e tyre, pjesëmarrësit në këtë projekt, përveç identifikimit të problemeve të hasura në terren, u përpoqën gjithashtu të identifikonin çështjet kritike individuale dhe të bënin propozime konkrete për përmirësimin e këtyre aftësive përmes ndërtimit të modeleve të ndryshme mësimore dhe ofrimit të teknikave të përdorura në glotodidaktikën globale për zhvillimin e këtyre aftësive. Projekti u përqendrua në aftësitë receptive, siç është aftësia e prodhimit me gojë, duke e testuar atë përmes materialeve të ndryshme, si: video, audio, etj., në kontrast me aftësinë e shkrimit dhe komunikimin joverbal. Në kuadër të këtij projekti, u hartuan pyetësorë për studentë, mësues dhe profesorë universiteti, të administruar në të gjitha shkollat e mesme në Shqipëri, si dhe në Fakultetin e Gjuhëve në Huaja. Pyetësorët shërbyen për të mbledhur rezultate konkrete që thelluan analizën e nevojshme dhe zgjidhjet e propozuara për problemet e hasura. Për më tepër, qëllimi i këtij projekti ishte të vëzhgonte dhe të analizonte rolin që luajnë materialet audiovizuale dhe multimediale në përmirësimin e aftësive të dëgjimit të studentëve, perceptimin e tyre për përdorimin e këtyre materialeve në mësimdhënien e gjuhës së huaj, si dhe dobinë që ato sjellin në procesin e përvetësimit të gjuhës së huaj. Rezultatet e projektit kanë nxjerrë në pah se sa shumë elementë të gjuhës mund të përvetësohen nëpërmjet përdorimit të materialeve audiovizuale për zhvillimin e aftësive të dëgjimit, siç janë: aspekti motivues i të nxënit, paraqitja e modelit gjuhësor të ndërthurur në kontekstin komunikues, mundësia e analizimit njëkohësisht të elementëve që lidhen me tingullin dhe të gjithë elementëve grafikë, si dhe ato të të parit, duke privilegjuar përvetësimin e aftësive ndërkulturore, lidhjen e mundshme midis tingullit dhe imazhit, ndikimin në kujtesën dhe të nxënit, si dhe përdorimin e materialeve autentike gjuhësore që aktualizojnë realitetin e gjuhës së studiuar.

Projekti kërkimor *“Përthimi i letërsisë italiane për fëmijë në gjuhën shqipe”*, i koordinuar nga Prof.Asoc.Dr. Mirela Papa, synonte të kontribuonte

në një fushë kërkimore, atë të përkthimit të teksteve për fëmijë, e cila është ende pak e studiuar. Objektivi i tij kryesor ishte të analizonte, me një qasje krahasuese në nivelin gjuhësor dhe kulturor, një korpus tekstesh nga autorë të ndryshëm italianë të përkthyer në shqip, me qëllim identifikimin e një sërë problematikave që hasen në përkthimin për fëmijë dhe të jepte sugjerime e rekomandime për zgjidhjen e tyre. Përkthimi i letërsisë për fëmijë shtrun të njëjtat problematika si përkthimi i letërsisë për të rritur. Për nga rëndësia e dialogjeve, gjuhës së folur dhe vetë gjuhës fëmimore i afrohet përkthimit të pjesëve teatrore. Për nga rëndësia e imazheve, ilustrimeve, etj. prek probleme të përkthimit kinematografik dhe paraqet sfida të papritura për përkthyesin. Gjuha e librave për fëmijë paraqitet si një sistem i thjeshtë dhe linear, që synon lehtësimin e të kuptuarit. Sintaksa është e thjeshtë dhe leksiku imiton gjuhën e përditshme të fëmijës, duke e afëruar tekstin e shkruar me gjuhën e folur. Gjatë studimit të bërë në kuadrin e projektit u evidentuan elementet kryesore që duhen marrë parasysh gjatë përkthimit të letërsisë për fëmijë, të tilla si: figurat e ndryshme retorike, lojërat e fjalëve, spontaniteti gjuhësor, ilustrimet që shoqërojnë tekstet (të cilat janë pjesë përbërëse e rrëfimit, sepse përcjellin informacion shtesë që plotëson atë të dhënë përmes fjalëve), si dhe përdorimi i veçantë i emrave të përveçëm, të cilët, të mbujtur me një domethënie të fuqishme, karakterizojnë protagonistët dhe krijojnë funksionin zbavitës, i cili është edhe ai më i rëndësishmi i letërsisë për fëmijë, sepse fëmijët para së gjithash lexojnë për t'u argëtuar.

Rezultatet e studimit mund të përdoren nga studentët e grupeve të Përkthimit dhe Interpretimit të ciklit të parë Bachelor dhe Master, si dhe studentët e ciklit të tretë të studimeve të Doktoratës që kanë punime në këtë fushë, të cilët mund t'i përdorin punimet kërkimore si referenca bibliografike. Përfitues të mundshëm të rezultateve studimore, përveç studentëve mund të jenë edhe studiuesit e rinj të cilët merren me studime të përkthimit, si dhe përkthyesit e rinj, të cilët duan të mbudhen në rrugën e bukur, por të vështirë të përkthimit për fëmijë.

Vlen të përmendet veçanërisht pjesëmarrja në këto projekte dhe kontributi i dhënë jo vetëm nga studentët e doktoratës të Departamentit të Italishtes, por edhe nga disa studentë të ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe Masterit të Përkthimit dhe Interpretimit.

Çdo botim i këtij vëllimi mund të ngjallë interesin shkencor dhe profesional të atyre që janë të apasionuar pas letërsisë, mësimdhënies dhe përkthimit nga gjuha italiane.



DEPARTAMENTI GJUHËS FRËNGE

(1) 9 Shkurt 2024- Grupi mësimor-kërkimor i letërsisë në **Departamentin e Gjuhës Franceze**, organizoi aktivitetin e radhës, në kuadrin e projektit “Çështja identitare në letërsinë franceze e frankofone.” Prof. Asoc. Dr. Lorena Dedja mbajti ligjëratën me titull *Du juif maudit à l’arabe du coin, les personnages de Schmitt dans « Monsieur Ibrahim et les fleurs du Coran » - à la recherche du « moi profond »*, ku trajtoi format e ndryshme të identitetit nga ai i përkatësisë kombëtare deri te përkatësia familjare, fetare, profesionale, etj. Ligjërata u ndoq me interes nga kolegët dhe studentët e Departamentit të Gjuhës Franceze. Lakimi i çështjes identitare u pasurua me diskutimet mbi stereotipet e paragjykimet si pengesa eventuale që ngrihen mes Unit dhe Tjetrit duke vështirësuar e shpesh tjetërsuar komunikimin.



DEPARTAMENTI GJUHËS GREKE

Ditë Botërore e Gjuhës Greke

Në kuadër të festimeve të Ditës Botërore të Gjuhës Greke, në datën 09.02.2024, Prof. Dr. Georgios P. Tsomis, Profesor pranë Departamentit të Filologjisë Greke, Universiteti Democritus i Thrakës, mbajti një leksion të hapur me temë “Drama Antike Greke, Ndikimi dhe Mbijetesa.

Bursa për studentët e Departamentit të Gjuhës Greke

Departamenti i Gjuhës Greke është krenar për mbështetjen që studentët e tij marrin nga partnerë të rëndësishëm për t'i ndihmuar të arrijnë qëllimet e tyre akademike pasi Për të shtatin vit radhazi, zyra e avokatisë në Shqipëri, Egna Law Firm, me qendër në Athinë dhe seli në kryeqytete të ndryshme të Ballkanit si: Prishtinë, Shkup, Sofje e Bukuresht mundëson bursa për studentë të dalluar të gjuhës greke të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJH).



DEPARTAMENTI GJUHËS GJERMANE

(1) 23 Prill 2024, Dita Botërore e Librit, Franz Kafka- Aktivitet i grupit mësimor-kërkimor **“Letërsi dhe Qytetërim i gjuhës gjermane”**.

Në Ditën Botërore të Librit, më datën 23 prill 2024, në sallën “Europa” të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJH), u zhvillua aktiviteti në kujtim të shkrimtarit të shquar Franz Kafka mbi veprat e tij më të njohura “Letra Milenës” dhe “Letër Babait”.

Sfidat aktuale të përkthimit të letërsisë në përgjithësi dhe të veprave të Kafka-s në veçanti u trajtuan nga përkthyesit Prof. Asoc. Dr. Marsela Likaj dhe Dr. Edvin Cami, të cilët shpalosën përvojën e tyre dhe diskutuan rreth rëndësisë së përkthimit në transmetimin e mesazheve të autorëve të mëdhenj tek lexuesit e gjuhëve të ndryshme, duke na kujtuar kështu se autorët e mëdhenj bëhen të dashur për lexuesit edhe përmes përkthimit.

Aktiviteti u pasurua edhe më tej me prezantime të mbushura me informacione të rëndësishme rreth jetës dhe veprës së shkrimtarit të famshëm nga studentët e Departamentit të Gjuhës Gjermane dhe nxënësit e projektit gjerman të gjimnazit “Sami Frashëri”, të cilët ofruan një analizë të thellë, si edhe një interpretim të një pjese të veprës së tij më të njohur “Metamorfoza”.

(2) 12 Prill 2024

Në vijim të aktiviteteve të parashikuara të grupit mësimor-kërkimor “Letërsi dhe Qytetërim i Gjuhës Gjermane” dhe **Departamentit të Gjuhës Gjermane**, u organizua një takim letrar me shkrimtarin e njohur zviceran, fitues të shumë çmimeve, z. Peter Stamm.

Për një periudhë prej rreth dy orësh, pjesëmarrësit kishin mundësinë të dëgjonin dhe të diskutonin me z. Peter Stamm në lidhje me dy romanet e tij, “Agnes” dhe “Shpërfillja e ëmbël e botës”, të përkthyer në gjuhën shqipe nga Anna Kove dhe botuar nga shtëpia botuese “Aleph”.

Moderimi i takimit u bë nga Marsela Likaj (anëtare e grupit mësimor-kërkimor dhe përgjegjëse e departamentit të gjuhës gjermane), e cila përmbodhi pikat kyçe të dy veprave për të fokusuar vëmendjen e pjesëmarrësve në thelbin e veprave të autorit. Studiuësja Anila Mullahi mbajti një diskurs qëmtues mbi veprën e autorit.



**LABORATORIO DI
TRADUZIONE LETTERARIA**
dall'albanese all'italiano

a cura di
GIUSEPPINA TURANO



 **15, 16, 17 aprile 2024**

 **09:30 - 12:30**

 **Facoltà di Lingue Straniere, UT
Aula EUROPA**



DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE

LABORATORIO DI TRADUZIONE 15 – 17 prill 2024

Grupi i Përkthimit dhe i Interpretimit të Departamentit të Gjuhës Italiane, organizoi me mbështetjen e Institutit Italian të Kulturës, në datat 15-17 prill 2024, ora 09:30 – 12:30, një modul praktik 3-ditor mbi përkthimin letrar nga gjuha shqipe në gjuhën italiane.

Ky modul praktik u zhvillua nga prof. Giuseppina Turano, pedagoge e gjuhës dhe e letërsisë shqipe pranë Universitetit Ca' Foscari të Venecias, autore e monografive dhe artikujve që hulumtojnë strukturat morfosintaksore të shqipes dhe dialektet italo-shqiptare, si edhe e studimeve krahasuese të dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë në hapësirën italo-shqiptare.

Në seancat e parashikuara morën pjesë 20 studentë të përzgjedhur të Departamentit të Gjuhës Italiane (Bachelor + Master).

Në përfundim të këtij moduli secilit prej studentëve iu caktua për përkthim një tregim i shkëputur nga libri “Antologji e tregimit shqiptar” (shekulli XXI). Tregimet e përkthyer do të botohen në një volum të vetëm me mbështetjen e Institutit Italian të Kulturës.



UNIVERSITÀ DI FOGGIA
FACOLTÀ DI LETTERE E LINGUE
DIPARTIMENTO DI ITALIANO
GRUPPO DI RICERCA IN LETTERATURA E COMUNICAZIONE

GIORNATA BUZZATIANA

19 APRILE 2024 | 10:30 - 16:00 | AULA 309, FGJH, UT

LECTIO MAGISTRALIS

10:30 - 12:30
BUZZATI E IL FANTASTICO
PROF. SSA. ROSSELLA PALMIERI (UNIVERSITÀ DI FOGGIA)

WORKSHOP


"SCRIVI CON NOI"
(SCRIVERE IL FINALE DI UN RACCONTO)

12:30 - 14:00
LA RICEZIONE ALBANESE DI BUZZATI (1901-2024)
• STOR GERONI, SERRA KOLAJ (1901-2004)
• MARIN KOVAČI (2006-2013)
• SARA PRENDI (2013-2018)
• DINA PATERNESE (2018-2024)

LA GIACCA STREGATA: SCRIVERE IL FINALE DEL RACCONTO DI BUZZATI
• PROF. DR. IRINA LAMA
PREMIAZIONE DEI VINCITORI DEL CONCORSO LETTERARIO "SCRIVI CON NOI"

LECTIO MAGISTRALIS

14:00 - 16:00
PAURÉ BUZZATIANE: RACCONTI, TEATRO, MUSICA
PROF. SSA. ROSSELLA PALMIERI (UNIVERSITÀ DI FOGGIA)





GIORNATA BUZZATIANA 19 prill 2024

1. LECTIO MAGISTRALIS nga prof. Rossella Palmieri (Università di Foggia, Italia)

-Buzzati e il fantastico

-Paure buzzatiane: racconti, teatro, musica

2. Workshop & Konkursi “SCRIVI CON NOI”

Giornata Buzzatiana u organizua në datën 19 prill 2024 nga grupi mësimor kërkimor *Letërsi dhe Komunikim* i Departamentit të Gjuhës Italiane me pjesëmarrjen e studentëve të tre cikleve të studimit, pedagogëve të DGJI dhe Prof. Rossella Palmieri (Università di Foggia) e cila mbajti dy *Lectio Magistralis* mbi autorin italian Dino Buzzati me studentët e tre cikleve.

Pjesë e aktivitetit ishte Workshopi “Scrivi con noi” (scrivere il finale di un racconto) gjatë të cilit mbas një prezantimi nga studentët e ciklit të parë e të tretë mbi receptimin e autorit italian në gjuhën shqipe u shpallën fituesit e konkursit “Scrivi con noi” [1. Giulia Resnjaku; 2. Anxhela Çela; 3. Marin Kovaçi; 4. Erisjona Troksi.] dhe u lexuan tre finalet më të bukura.

Studentëve të viteve të treta të programit të studimit “Gjuhë letërsi dhe qytetërim italian” iu dha tregimi *La giacca stregata* e shkrimtarit Dino Buzzati i cili është një tregim me finale të hapur. Detyra e çdo studenti ishte vazhdimi i tregimit aty ku e ka lënë Buzzati dhe të shkruajturit e një finale origjinale. Në konkurs morën pjesë 46 studentë. Dy komisione (komisioni i përbërë nga studentët e ciklit të dytë Master në Mësuesi dhe komisioni i përbërë nga doktorantët dhe pedagogët e grupit mësimor kërkimor *Letërsi - Komunikim* të DGJI), në bazë të një skede vlerësimi, korrigjuan në mënyrë anonime finalet e shkruara nga studentët. Fituesit u shpallën në fund të Workshop-it.

Synimi i konkursit ishte njohja dhe studimi i thelluar i strukturës së tregimit në përgjithësi dhe i tregimeve të autorit italian Dino Buzzati në veçanti, studimi i thelluar dhe perfeksionimi i gjuhës italiane nga ana e studentëve të ciklit të parë, zhvillimi i aftësisë së vlerësimit nga ana e studentëve të ciklit të dytë e të tretë.



WORKSHOP DIDATTICO 11 prill 2024

Në datën 11 Prill 2024, ora 14.30, Salla 309, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Prof. Graziano Serragiotto, Profesor i Didaktikës së Gjuhëve Moderne në Universitetin CàFoscari të Venecias, zhvilloi një Workshop për studentët e Masterit Mësuesi e pedagogë të Departamentit të gjuhës Italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

Workshopi “Metodologia CLIL e la progettazione dei moduli”, një nismë kjo e grupit didaktik të departamentit të gjuhës italiane, i cili u organizua edhe falë mbështetjes së Institutit Italian të Kulturës, kishte si qëllim prezantimin e metodologjinë CLIL e cila i referohet të mësuarit të përmbajtjes lëndore përmes një gjuhe të huaj, në këtë rast në gjuhën italiane.

Pas prezantimit të disa aspekteve teorike lidhur me metodologjinë CLIL, u vunë në pah avantazhet e përdorimit të saj dhe u theksuan disa veçori duke nënvizuar aspektet praktike në realizimin e një moduli.



DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

Qershor 2024 - Tetor 2024

Departamenti i Gjuhës Angleze në kuadër të projektit “EMI në universitetet shqiptare: nga pilotimi në zbatim” me mbështetje të Institutit Shqiptar të Medias dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë realizoi me sukses projektin:

“Integrimi i kompetencave të EMI-t në Programin e Studimit Bachelor në Gjuhë Angleze (Profili: Gjuhë Angleze, Përkthim dhe Interpretim, Studime Britanike dhe Amerikane)”

Ky projekt kishte për qëllim integrimin e edukimit për median dhe informacionin në programet mësimore me qëllim nxitjen e të menduarit dhe të analizuarit kritik të materialeve të marra nga burime të ndryshme të informacionit, zhvillimin e aftësive kërkuese dhe analizuese të cilat ndihmojnë në vlerësimin dhe verifikimin e burimeve të informacionit.

Realizimi i këtij projekt solli një përvojë të re dhe përmirësim të dukshëm të programeve të lëndëve Analizë Teksti, Studime Britanike dhe Amerikane, Përkthim dhe Interpretim, Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, të cilat do të sjellin një rritje cilësore të mesimdhënies në programin e studimit Bachelor “Gjuhë Angleze”.

